



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

---

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë, më . 09.2021

Miratohet

**KRYETAR**

Raport Auditimi Performance

*“Efektiviteti dhe efienca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike  
në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës”*

**ARBEN SHEHU**



**Yllka Pulashi**

**Drejtor i Departamentit**

**Publik:** Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin 154/2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, specifikisht nenin 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë; E-mail: klsh@klsh.org.al

Auditimi është kryer në bazë të shkresës informuese nr. 201, datë 04.02.2021 dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, 202/7 datë 29.04.2021.

Auditimi me temë “*Efektiviteti dhe efienca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës*”, ka mbuluar periudhën 2018-2020 dhe është fokusuar në Bashkinë Tiranë me institucionin e varësisë Agjencinë “Tirana Parking”, si dhe Bashkia Korçë. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat me protokoll nr. 201/8 dhe nr. 201/9 datë 05.08.2021, iu përcoll Projekt-Raporti i Auditimit subjekteve të audituara.

Në përputhje me Ligjin 154/2014, në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimit priti observacionet nga subjektet nën auditim. Në përfundim të afatit, subjektet nën auditim nuk përcollën observacione.

Ky Raport është hartuar në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës e konkretisht: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI, Standardet e Auditimit të Performancës 3000-3899, Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës, si dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në konsultë të vazhdueshme me stafin e institucioneve, subjekte auditimi, intervistat, përvojën më të mirë audituese në këtë fushe, etj.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. Anesti Gjikalaj, Përgjegjës grupi
2. Megi Kurushi, Anëtare
3. Almida Kafia (Hoxha), Anëtare

Procesi auditues u mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme nga Drejtori i Departamentit.

## PËRMBAJTJA

<b>1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT .....</b>	<b>4</b>
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës .....	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
<b>2. SUBJEKTI NËN AUDITIM.....</b>	<b>6</b>
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim .....	6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim .....	12
2.3 Rëndësia e produkteve të subjekteve .....	13
2.4 Pesha në buxhet dhe PBB .....	15
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	20
2.6 Skema e analizës së programit .....	22
2.7 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore.....	23
<b>3. DETAJET E AUDIMIT .....</b>	<b>23</b>
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit .....	23
3.2 Objektivi i auditimit .....	24
<b>4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE .....</b>	<b>26</b>
<b>5. PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>80</b>
<b>6. SHTOJCAT .....</b>	<b>84-110</b>

# 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

## 1.1 Konteksti i problemit social

*“Sa më shumë e ndarë dhe e ndërthurur është qendra e qytetit me vende parkimi dhe garazhe, aq më e mërzhitshme dhe më e vdekur bëhet, dhe nuk ka asgjë më të pakëndshme se një qendër qyteti e vdekur”*

*“Siguria Sociale është një premtim që nuk mund dhe nuk duhet thyer”*

-Jane Jacobs (1962, 19)

Praktikat më të mira, të cilësuara në vijim të trajtimit, kanë treguar se menaxhimi efektiv i parkimit ka provuar të jetë i dobishëm në lehtësimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane në qytete. Sipas një studimi të kryer nga Donald Shoup në 2005, *“makinat janë në lëvizje mesatarisht 1 orë në ditë, dhe 23 orët e tjera qëndrojnë të parkuara diku”*.<sup>1</sup> Me zhvillimin gjithmonë e më dinamik të qyteteve, numri i makinave të zotëruara nga qytetarët ka pësuar rritje, çka e bënë gjithmonë e më të domosdoshëm menaxhimin efektiv të parkimeve në qytete. *“Tirana ka pasur një raport rreth 105 makina për 1,000 banorë, por me ndryshimet e reja administrative territoriale raporti shkon në rreth 200 makina për 1,000 banorë, që është vetëm pak më pak se mesatarja Evropiane (300/1000 banorë) dhe pritet që të rritet me shpejtësi vitet e ardhshme.”*<sup>2</sup> Sikurse përcaktohet në Strategjinë e Bashkisë Tiranë 2018-2022, me rritjen e numrit të makinave dhe përdorimin e vazhdueshëm të tyre në Tiranë, shfaqet si nevojë thelbësore rritja e kapacitetit të parkimit në Tiranë. *“Problemet e parkimit të tej mbushur të automjeteve vërehen kudo në Zonën Qendrore të Biznesit në Tiranë”*<sup>3</sup>.

Nga ana tjetër, si një qytet gjithë e më shumë në zhvillim, Korça përballet me të njëjtin problematik lidhur me parkimin në qytet. Studimi më i vonë i kryer për parkimin në qytetin e Korçës është ai i vitit 2013. Referuar këtij studimit Korça është një qendër ekonomike dhe kulturore mjaft e zhvilluar, *ndër vite trendi i numrit të qytetarëve të cilët zotërojnë një autoveturë, apo numri i subjekteve që zhvillojnë aktivitete ekonomike është në rritje.*<sup>4</sup>

*“Pothuajse çdo udhëtim me makinë përfundon në një vend parkimi. Prandaj, menaxhimi i hapësirave të parkimit nënkupton menaxhimin e kërkesës për përdorimin e makinës dhe rëndimin e trafikut. Në këto kushte, menaxhimi efektiv i parkimit në qytetin e Tiranës dhe Korçës merr një rëndësi të veçantë.”*<sup>5</sup> Referuar studimeve të shumta, avantazhet e menaxhimit të duhur të parkimeve nuk kufizohen vetëm në gjetjen e vend parkimit lehtësisht. Komisioni Evropian, në dokumentin më të fundit të publikuar mbi menaxhimin e qëndrueshëm të parkimeve në qytet liston 16 avantazhe,<sup>6</sup> në vijim grupi i auditimit paraqet më kryesoret prej tyre:

1. Menaxhimi i parkimit kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të lëvizshmërisë urbane dhe për këtë arsye rrit dhe cilësinë e jetës në qytet’
2. Menaxhimi i parkimit çon në zvogëlimin e kohës së nevojshme për gjetjen e një vendi parkimi duke, reduktuar kështu trafikun në qytet;

<sup>1</sup> *“Parking and sustainable urban mobility planning: Hoë to make parking policies more strategic, effective and sustainable”*, Komisioni Evropian, qërshor 2019, fq. 6.

<sup>2</sup> Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, 2017, fq. 93.

<sup>3</sup> Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, 2017, fq. 95.

<sup>4</sup> Studimi i fizibilitetit për parkimin në qytetin e Korçës, 2013, fq.5.

<sup>5</sup> Arsyet dhe parimet të duhura të menaxhimit të parkimeve, CIVITAS, PARK4SUMP, janar 2020, fq.6

<sup>6</sup> *Parking and sustainable urban mobility planning: Hoë to make parking policies more strategic, effective and sustainable”*, Komisioni Evropian, qërshor 2019, fq. 8.

3. Studimet kanë treguar se kosto e menaxhimit të parkimeve ka një nivel të lartë provueshmërie nga qytetarë. Njerëzit zakonisht ankohen përpara se parkimi të menaxhohet në mënyrë aktive, por kundërshtimi fillestar bie kur ata kuptojnë ndikimet e saj pozitive;
4. Menaxhimi i parkimit mbështet ekonominë lokale;
5. Menaxhimi i parkimit kontribuon në sigurinë rrugore;
6. Standardet e parkimit të zgjedhura me kujdes ndikojnë pozitivisht vlerën e pasurive të paluajtshme;
7. Menaxhimi i parkimeve, rrit të ardhurat e bashkive, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e investimeve në qytete; etj.

Me gjithë avantazhet e mëdha të menaxhimit të parkimeve, studimet tërheqin vëmendjen se për të arritur këtë qëllim është shumë i rëndësishme përcaktimi i normave të sakta, çmimeve të studiuara të parkimit dhe gjobave të duhura, për të siguruar sukses në këtë drejtim.

Duke marr parasysh problemet me të cilat qytetet e Tiranës dhe Korçës përballen lidhur me parkimin, si dhe avantazhet e shumta të menaxhimit të parkimeve, trajtuar më lartë, Kontrolli i Lartë i Shtetit ndërmori auditimi *“Efektiviteti dhe eficientia e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës”*

## **1.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficientisë dhe efektivitetit, si dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në planin e ri strategjik 2018-2022, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficientisë dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Në linjë me rekomandimet e Progres Raportit 2020 dhe Strategjinë Institucionale 2018-2022 miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 228, datë 31.12.2017 *“Për miratimin e dokumentit të politikave të burimeve njerëzore të KLSH-së”*, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit. Në kuadër të Strategjisë Institucionale 2018-2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit ndërmarrin auditimin e performancës me temë *“Eficientia dhe efektiviteti i parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit”*. Menaxhimi i Parkimeve është një çështje komplekse e cila ka një impakt të drejtpërdrejtë mbi transportin urban, rajonal, cilësinë e mjedisit, përdorimin e hapësirës publike, promovimin e biznesit, etj, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin socialo-ekonomik të qytetit.

Në përfundim të këtij auditimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit synon të jap një pamje të qartë për publikun dhe palët e interesit mbi menaxhimin e parkimeve në qytetin e Tiranës dhe të Korçës, si dhe të japë rekomandimet e nevojshme me qëllim menaxhimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të parkimeve, duke ruajtur dhe respektuar hapësirat publike dhe mjedisin. \

### **1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë**

Kontrolli i Lartë i Shtetit po kryen për herë të parë një auditim performance mbi menaxhimin e parkimeve në qytetin e Tiranës dhe Korçës. Për këtë arsye, rezultatet e këtij auditimin marrin një rëndësi të veçantë, për përmirësimin e menaxhimit të parkimeve në këto qytete.

## **2. SUBJEKTI NËN AUDITIM**

### **2.1 Hyrje në subjektet nën auditim**

#### **➤ *Bashkia Tiranë***

Subjekt i këtij auditimi do të jetë Bashkia Tiranë, së bashku me njësitë e saj të varësisë. Nga të dhënat e siguruar gjatë fazës së hartimit të programit, ky auditim do të fokusohet kryesisht, por jo vetëm (në varësi të informacioneve të cilat do të gjenerohen gjatë fazës së terrenit), tek strukturat e mëposhtme:

#### **- *Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor:***

Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor është përgjegjëse për miradministrimin e çështjeve që lidhen me hartimin dhe zbatimin e masterplanit të integruar të transportit të qëndrueshëm në qytetin e Tiranës, duke luajtur rolin kryesor si planifikues dhe rregullator për sigurimin e një sistemi eficient të transportit publik, të sigurt, të aksesueshëm dhe të shpejtë, analizues dhe planifikues i një mobiliteti të qëndrueshëm në përputhje me planet rregullatore duke mundësuar lëvizshmërinë për çdo përdorues. Gjithashtu, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse ku vepron, si dhe për programet, veprimtaritë dhe proceset, të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës.

#### **- *Detyrat dhe përgjegjësitë:***

1. Menaxhon planet strategjike në përputhje me objektivat kryesore të punës duke synuar realizimin në kohë të tyre me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve në të gjithë territorin e Tiranës;
2. Siguron dhe mban përgjegjësi, që menaxhimi i kontratave për ekzekutim dhe zbatim të investimeve të cilat duhet të realizohen në kohë, brenda buxhetit të miratuar dhe me cilësinë e parashikuar në kushtet e kontratës;
3. Drejton punën me Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Vendor për lirimin e shesheve të ndërtimit dhe reflekton azhurnimet e ndryshme në dosjet e objekteve;
4. Vlerëson, propozon dhe mban përgjegjësi në lidhje me ndryshimet që kërkohen gjatë zbatimit të projekteve në objektet e infrastrukturës;
5. Siguron përgatitjen e dosjes përkatëse dhe depozitimin në Sekretarinë Teknike, për t'u diskutuar dhe miratuar në Këshillin Teknik;
6. Orienton ndarjen e detyrave që lidhen me menaxhimin dhe financimin e të gjitha kontratave të infrastrukturës, përfshirë raportimin periodik, teknik dhe financiar mbi ecurinë e zbatimit dhe realizimit të tyre;
7. Verifikon dhe kontrollon punën e kontraktorëve, në lidhje me afatet e përcaktuara edhe cilësinë e punës, bashkëpunon me ta, si dhe propozon masa konform ligjit dhe kontratës në rastet kur vëren shkelje të kontratës dhe kushteve të saj, mban përgjegjësi për sigurimin e zgjidhjes së problemeve të evidentuara sipas kushteve të kontratës;
8. Identifikon mundësitë e ideimit dhe organizimit të punëve publike, duke u mbështetur në strategjitë, politikat për zhvillim dhe nevojat që paraqiten.

#### **- *Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimin të Prioriteteve:***

Misioni: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve është përgjegjëse për hartimin e planeve strategjike afat-mesme dhe afat-gjata të Bashkisë Tiranë dhe sigurimin e jetësimit të projekteve prioritare, duke përcaktuar hapat e nevojshme që duhen ndërmarrë dhe kalendarit të zhvillimit të projekteve dhe mbikëqyrjen e realizimit të këtyre projekteve hap pas hapi deri në përfundimin e tyre. Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse ku vepron, si dhe për programet, veprimtaritë dhe proceset, të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës.

*Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:*

1. Koordinohet me strukturat e tjera të Bashkisë, për përcaktimin e objektivave strategjike dhe monitoron realizimin e tyre;
2. Mbështet drejtoritë e tjera të Bashkisë Tiranë me analiza, studime specifike dhe ekspertizë për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe dokumenteve strategjike;
3. Koordinon hartimin e planit vjetor të punës së Bashkisë dhe përcakton prioritetet e çdo viti;
4. Udhëheq punën për hartimin e studimeve dhe analizave në fusha specifike për të siguruar një zhvillim sa më të qëndrueshëm të Kryeqytetit;
5. Përcakton kalendarin e zhvillimit të projekteve si edhe mbikëqyrjen e realizimit të këtyre projekteve hap pas hapi deri në përfundimin e tyre;
6. Ndjek zbatimin e strategjive, politikave dhe planet e fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi;
7. Koordinon analizën periodike (çdo vit) të indikatorëve socio-ekonomike për të matur impaktin e politikave të ndjekura apo për të propozuar politika të reja;
8. Vlerëson dhe propozon politika, plane veprimi, strategji sektoriale dhe projekte të caktuara për drejtoritë e tjera të Bashkisë Tiranë për përmbushjen e objektivave të Institucionit.

- ***Drejtoria e Planifikimit të Territorit:***

Misioni: Drejtoria e Planifikimit të Territorit është përgjegjëse për miradministrimin e çështjeve që lidhen me lehtësimin e realizimit të objektivave dhe interesave për zhvillim, nëpërmjet identifikimit të potencialeve dhe planifikimit të qëndrueshëm të territorit, implementimin, monitorimin dhe përditësimin e planit të përgjithshëm vendor dhe planeve të ndryshme sektoriale dhe ndërsektoriale, hartimin e termave të referencës për instrumentet e planifikimit, përcaktimi i linjave guidë për zërthimin e mëtejshëm të instrumenteve duke zhvilluar dhe përmirësuar në vazhdimësi procedurat për sigurimin e cilësisë në hartimin e planeve të detajuara vendore dhe projekteve në përputhje me standardet evropiane. Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit të Territorit është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse ku vepron, si dhe për programet, veprimtaritë dhe proceset, të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës.

*Detyrat dhe përgjegjësitë:*

1. Bashkëpunon në hartimin dhe rishikimin e dokumenteve të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi Kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit;
2. Planifikon dhe nxit zhvillimin e qëndrueshëm të territorit nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore;
3. Bashkëpunon për përgatitjen e vendimmarrjes të Kryetarit të Bashkisë lidhur me aplikimet për leje zhvillimi në territorin administrativ të Bashkisë;

4. Koordinon në bashkëpunim me drejtori të tjera dhe konsulentë nga jashtë Bashkisë, nisma për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve vendore të planifikimit;
5. Koordinon, në bashkëpunim me drejtori të tjera dhe konsulent nga jashtë Bashkisë, nisma për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve në nivel vendor;
6. Përcjell dhe asiston në prezantime të dokumenteve vendore të planifikimit pranë AKPT-së, për të verifikuar përputhshmërinë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe normat teknike të planifikimit;
7. Harton termat e referencës për instrumentet e planifikimit, përcakton linjat guidë për zbërthimin e mëtejshëm të instrumenteve;
8. Siguron cilësi në hartimin e planeve të detajuara vendore, nëpërmjet realizimit të një diskutimi dhe bashkërendimi me çdo autoritet të planifikimit dhe palë të interesuar, përpara fillimit dhe shkresor i cili ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet në mënyrë të pavarur nga autoritetet e planifikimit;
9. Përditëson gjendjen në terren dhe harton gentplane të ndryshme për leje zhvillimi.

- **Tirana Parking**

Tirana Parking është krijuar me Urdhër të Bashkisë Tiranë nr. 21554/1, datë 16.12.2015 si një institucion i cili synon të ketë një rol ekzekutiv në lidhje me zbatimin e politikave të parkimit të hartuara nga Bashkia Tiranë. Në po të njëjtin Urdhër të sipërcituar specifikohet se Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor harton politika të parkimit.

Organizimi dhe funksionimi i TP-së rregullohet me Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 22678/1 datë 30.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Tirana Parking. Vendimi i Këshillit Bashkiak<sup>7</sup> përcakton statusin e TP-së si institucion publik shtetëror në varësi të Bashkisë Tiranë, i krijuar me qëllim administrimin e shërbimit publik me pagesë të BT, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim, drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i TP.

TP në përputhje me legjislacionin në fuqi ka për mision t’ju ofroj qytetarëve të Tiranës lehtësimin e parkimit të mjeteve të tyre, nëpërmjet menaxhimit efikas të zonave të destinuara për Parkim Publik, orientimin e qytetarëve mbi “Parkimin Publik me Pagesë” dhe krijimin e sa më shumë hapësirave publike për parkim. *Objektiva ndaj të cilave TP është e angazhuar të realizojë:*

- Të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim dhe të vjelë të ardhurat e gjeneruar prej tij;
- Të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
- Të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
- Të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit;
- Të konstatojë dhe të vendosë gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimi përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit;
- Të arkëtojë gjobat e vëna në kuadër të konstatimit të një kundërvajtje administrative për shkelje që kanë të bëjnë me parkimin;
- Të kryej çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtime e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat

---


<sup>7</sup>Vendim nr. 48 datë 11.11.2015 “Për krijimin e Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, i ndryshuar

që i ngakohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë;

- T'i propozojë Bashkisë së Tiranës përmirësimin e politikave të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë.

Struktura e TP është miratuar me Urdhërin. Nr.Prot., 4560/2 datë 06.02.2018 për "Riorganizimin e Strukturës së Institucionit "Tirana Parking", njësi në varësi të Bashkisë Tiranë".

Skema 1: Struktura e miratuar e Tirana Parking



Burimi: Tirana Parking

Përpunoi: Grupi i auditimit

Skema 2: Skema e menaxhimit të parkimeve në Bashkinë Tiranë



Burimi: Tirana Parking  
Përpunoi: Grupi i auditimit

➤ **Bashkia Korçë**

Subjekt i këtij auditimi do të jetë edhe Bashkia Korçë. Prej vitit 2013 deri në vitin 2019, menaxhimi i parkimeve në Bashkinë Korçë është realizuar nëpërmjet një partneriteti publik privat. Prej shtatorit të vitit 2019 e në vijim, administrimi i parkimeve në këtë qytet është realizuar nga vet Bashkia Korçë. Nga të dhënat e siguruar gjatë fazës së hartimit të programit, ky auditim do të fokusohet kryesisht, por jo vetëm, tek strukturat e mëposhtme:

- **Zyra e shërbimeve të parkimeve:**

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Korçë, nr. 22, datë 16.01.2020 është miratuar struktura e re e Bashkisë Korçë, në përbërje të të cilës është *Zyra e Shërbimit të Parkimeve*.

Referuar kontratës së punës me nr. 753/1 prot., datë 09.09.2019 të lidhur midis Bashkisë Korçë dhe mbikëqyrësit të zyrës së shërbimit me pagesë, *detyrat dhe përgjegjësitë e këtij të fundit* janë:

- Mbikëqyr punonjësit e parkimit me pagesë;
- Raporton tek eprorët mbi vazhdimësinë e zyrës;
- Dorëzon në arkë çdo ditë arkëtimet e mbledhura nga punonjësit e parkimit me pagesë;
- Monitoron mbarëvajtjen e zyrës;
- Merr në dorëzim biletat e parkimit;
- Kontrollon respektimin e orarit të punës nga punonjësit e parkimit me pagesë.

Referuar kontratave të punës me nr. 766/1 prot., datë 10.09.2019 të lidhura midis Bashkisë Korçë dhe punonjësve të parkimit me pagesë, *detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre të fundit* janë:

- Respekton urdhëratë, udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të mbikëqyrësit të zyrës;
- Zbaton detyrat e dhëna nga mbikëqyrësit;
- Dorëzon tek mbikëqyrësi në fund të ditës arkëtimet e mbledhura;
- Jep biletat e parkimit me pagesë tek qytetarët.


Skema 3: Struktura e pjesshme e Bashkisë Korçë



Burimi: Bashkia Korçë  
Përpunoi: Grupi i auditimi

Skema 4: Menaxhimi i parkimeve në Bashkinë Korçë

**Zyra e Shërbimit të Pagesave në Bashkinë Korçë:**  
 - Menaxhon shërbimin e parkingut me pagesë.  
 - Monitoron kryerjen dhe mbledhjen e pagesave, etj.



Burimi: Bashkia Korçë  
 Përpunoi: Grupi i auditimi

## 2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”;
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet Rrugore” me ndryshime;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
- Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” me ndryshime;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime.

- VKM nr 153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”
- VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”
- VKM nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, me ndryshimet.
- VKM nr.229, datë 23.04.2004 “Për Miratimin e Ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me vendimin Nr.832, datë 15.09.2013.
- VKB nr.48, datë 11.11.2015 “ Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”
- VKB nr.49, datë 11.11.2015 “Miratimin e Kriteve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim, si dhe Tarifave të Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës”,
- VKB nr.36, datë 29.03.2018 “Për disa ndryshime në VKB nr.48 datë 11.11.2015“ Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë” dhe në VKB nr.49, datë 11.11.2015 “Miratimin e Kriteve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim, si dhe Tarifave të Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës”;
- VKB nr.158, datë 26.12.2019 Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”;
- Rregullore e Brendshme e TP, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 22678/1 datë 30.05.2019 “Për miratimin e Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Institucionit Tirana Parking”, Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë.

Rregullore për Organizimin Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Korçë me nr. 648 prot., datë 17.10.2018.

### **2.3 Rëndësia e produkteve të subjekteve**

Praktikat e mira të konsultuara nga grupi i auditimit dhe të cituara në këtë program, tregojnë se menaxhimi i parkimit është çelësi për menaxhimin e lëvizshmërisë urbane. Pothuajse çdo udhëtim me makinë përfundon në një vend parkimi. Prandaj, menaxhimi i hapësirave të parkimit nënkupton menaxhimin e kërkesës për përdorimin e makinës dhe rëndimin e trafikut.

*Bashkia Tiranë:*

- Harton dhe miraton *dokumentet strategjike* për zhvillimin e qytetit, pjesë e të cilave është edhe menaxhimi i parkimeve;
- Harton dhe miraton *Raportet e Monitorimit* të Dokumenteve Strategjike dhe të Veprimit; etj.

*Tirana Parking kryen aktivitetet dhe ofron shërbimet e mëposhtme:*


- Administrimin shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë për qytetarët, në përputhje me zonat e përcaktuara;
- Tirana Parking ofron dhe shërbimin e parkimit për rezidentët pa pagesë, si dhe i pajisë ata me kartën e rezidentit;
- Ofron shërbimin e parkimit me pagesë për bizneset, nëpërmjet kontratave që lidhë me ta;
- Mirëmban sheshet e parkimit;

- Instalon dhe mirëmban pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
- Instalon dhe mirëmban sinjalistikën rrugore të parkimit; etj.

*Bashkia Korçë:*

- Harton dhe miraton kuadrin rregullator për menaxhimin e parkimeve të qytetit;
- Ofron shërbimin e parkimit me pagesë për qytetarët;
- Ofron shërbimin e parkimit me pagesë për rezidentët;
- Ofron shërbimin e parkimit me pagesë për bizneset;
- Administron biletat e parkimit;
- Instalon dhe mirëmban sinjalistikën rrugore të parkimit; etj.

Për qytetin e Tiranës, Zonat e Administrimit të Parkimit (ZAP) paraqiten në hartën e mëposhtme:



*Burimi: Tirana Parking*<sup>8</sup>

**Zona 1.**

Me kufij: Vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Perëndimore, bulevardin “ZOG 1” në anën Lindore dhe kordonin hyrës me rrugët “Lazi Miho”, “Konferenca e Pezës” duke vazhduar përgjatë bulevardit “Gjergj Fishta” në anën jugore, deri në ndërprerjen me bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.

**Zona 2.**

Me kufij zonën përgjatë bulevardit “ZOG 1” në pjesën perëndimore, vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Lindore dhe zgjatimin e bulevardit “Zhanë D'Ark” deri në vijën kufizuese në anën Jugore.

**Zona 3.**

<sup>8</sup>VKB nr.49, datë 11.11.2015, Aneksi nr.2

Me kufij segmentin e bulevardin “Dëshmorët e Kombit” në anën perëndimore, bulevardi “Bajram Curri” dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijën kufizuese në anën veriore dhe vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Jug/Lindore.

#### **Zona 4.**

Me kufij kordonin hyrës përgjatë rrugës “Konferenca e Pezës” në anën veriore, bulevardin vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në anën lindore, zonën përgjatë segmentit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” në pjesën Lindore dhe vijën kufizuese të Tiranës në pjesën jugore të saj.

### **2.4 Pesha në buxhet dhe PBB**

Tirana Parking është institucion publik varësi e Bashkisë Tiranë i cili ofron dhe realizon shërbimet e parkimit publik me pagesë ose pa pagesë, mbi dhe nëntokë në përputhje me zonat e përcaktuara në VKB-në nr. 49, datë 11.11.2015 “Krijimin e Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”, VKB-në nr.36 datë 29.03.2018 “Për disa ndryshime në VKB-në nr.48, datë 11.11.2015 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë” dhe në VKB-në nr.49 datë 11.11.2015 “Për miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia Tiranë”. Në nenin 44, pika 2 të VKB 158 datë 26.12.2019 përcaktohet se të ardhurat e gjeneruar nga Tirana Parking kalojnë 100% në Bashkinë e Tiranës.

*Tabela 1: Të ardhurat dhe shpenzimet e TP për periudhën 2018 - 2020*

*Në lekë*

Emërtimi/Vitet	2018	2019	2020
<b>TË ARDHURAT</b>			
Të ardhurat nga parkimi me kontratë	148,116,792	149,972,698	149,079,620
Të ardhurat nga parkimi me bileta	306,672,040	319,428,990	250,936,040
Të ardhura nga qera	3,985,800	3,985,800	3,679,200
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>458,774,632</b>	<b>473,387,488</b>	<b>403,694,860</b>
<b>SHPENZIMET</b>			
Shpenzime page	77,929,294	79,225,573	78,949,423
Sigurime	12,497,668	13,196,615	13,158,410
Shpenzime operative	79,411,810	79,479,440	66,426,911
Shpenzime administrative		37,500	95,000
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>169,838,772</b>	<b>171,939,128</b>	<b>158,629,744</b>
<b>SUFICIT</b>	<b>288,935,860</b>	<b>301,488,360</b>	<b>245,065,116</b>

*Burimi:* Tirana Parking

*Përpunoi:* Grupi auditimit

Siç shihet edhe në tabelën e mësipërme ku janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e Tirana Parking, vihet re se gjeneron një pjesë të konsiderueshme të ardhurash për efekt të buxhetit të Bashkisë Tiranë.

Konstatohet se, të ardhurat kanë ardhur në trend rritës nga viti 2018 në vitin 2019 me 14,612,856 lekë. Për vitin 2020 vihet re ndjeshëm impakti i pandemisë së shkaktuar nga Covid – 19 i cili ka

bërë që të ardhurat e gjeneruara të jenë më të ulta por sërish duke gjeneruar në total suficit me vlerën 245,065,116 lekë.

Duke analizuar burimet e mbledhjes së parave për parkimet në tre vjet, përsa i përket të ardhurave nga “parkimet me rezervim” rezulton se: Individët, kompanitë apo shërbimet taksi mund ta rezervojnë vendin përgjatë gjithë vitit ose në pjesë të caktuara të tij duke parkuar vetëm ata.

Kemi trajtuar një prej paketave më të pëlqyera nga publiku dhe rezultojë se, kontrata e abonimit për 1 vit (nga e hëna në të premte), me 12 orë në ditë sipas të dhënave zyrtare kushtonte 221,760 lekë në vit.

Nëse llogarisim të ardhurat që do mblidheshin në ditë nga parkimi me pagesë, ku një orë kushton 100 lekë, në vit do të mblidheshin më shumë të ardhura, pra 438,000 lekë.

Por nga ana e TP mbahet në konsideratë fakti se, qëllimi i tarifës nuk është vetëm që të gjenerojë të ardhura, por edhe që të përmirësojë parkimin, duke i dhënë mundësi të gjithëve ta shfrytëzojnë parkimin e jo vetëm një pjese individësh.

Përsa më sipër duhet analizuar kosto përfitimi që vijnë nga këto lloj parkimesh përpara biznesit, të cilat në disa raste i vështirësojnë mundësinë edhe rezidentit të gjejë parkim qoftë edhe me pagesë.

*Tabela 2: Plan fakt për të ardhurat e realizuara për periudhën 2018– 2020*

Vitet	2018		
	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>TË ARDHURAT 2018</b>			
Të ardhurat nga parkimi me kontratë	126,000,000	148,116,792	118
Të ardhurat nga parkimi me bileta	324,000,000	306,672,040	95
Të ardhura nga qera	3,985,800	3,985,800	100
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>453,985,800</b>	<b>458,774,632</b>	<b>101</b>

Vitet	2019		
	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>TË ARDHURAT 2019</b>			
Të ardhurat nga parkimi me kontratë	140,000,000	149,972,698	107
Të ardhurat nga parkimi me bileta	430,000,000	319,428,990	74
Të ardhura nga qera	3,680,000	3,985,800	108
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>573,680,000</b>	<b>473,387,488</b>	<b>83</b>

Vitet	2020		
	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>TË ARDHURAT 2020</b>			
Të ardhurat nga parkimi me kontratë	154,000,000	149,079,620	97
Të ardhurat nga parkimi me bileta	463,200,000	250,936,040	54
Të ardhura nga qira	3,985,800	3,679,200	92
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>621,185,800</b>	<b>403,694,860</b>	<b>65</b>

*Burimi:* Tirana Parking

*Përpunoi:* Grupi auditimit

Sikundër vërehet në tabelat e mësipërme trendi i realizimit të të ardhurave plan fakt është në nivel të konsiderueshëm, konkretisht për vitin 2018 trendi i realizimit është 101%, për vitin 2019 trendi ka rënie në 83% i cili ka ardhur si rrjedhojë e realizimit më të ulët nga të ardhurat e parkimit me bileta. Në vitin 2020, realizimi është më i ulët si rrjedhojë e kufizimeve të vendosura e për shkak të pandemisë dhe evidentohet pasi niveli më i ulët është reflektuar drejtpërdrejtë tek të ardhurat nga parkimi me bileta.

*Tabela 3:* Peshë në buxhetin total të Bashkisë Tiranë


Emërtimi	2018		% krahasuar totalit të të ardhurave	2019		% krahasuar totalit të të ardhurave	2020		% krahasuar totalit të të ardhurave
	Plan	Fakt		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
<b>Totali i të ardhura e parkimit te automjeteve e Tirana Parking</b>	<b>453,985,800</b>	<b>458,774,632</b>	<b>3.4%</b>	<b>573,680,000</b>	<b>473,387,488</b>	<b>3.3%</b>	<b>621,185,800</b>	<b>403,694,860</b>	<b>2.8</b>
Parkim me kontratë	126,000,000	148,116,792	1%	140,000,000	149,972,698	1%	154,000,000	149,079,620	1%
Parkim me bileta	324,000,000	306,672,040	2%	430,000,000	319,428,990	2%	463,200,000	250,936,040	2%
Qera	3,985,800	3,985,800	0,03%	3,680,000	3,985,800	0,03%		3,679,200	0,03%
<b>Totali i të ardhurave të BT</b>	<b>12,977,250,000</b>	<b>13,540,110,513</b>	<b>100</b>	<b>13,359,030,000</b>	<b>14,388,627,462</b>	<b>100</b>	<b>14,864,692,000</b>	<b>14,534,420,053</b>	<b>100</b>

*Burimi:* Tirana Parking

*Përpunoi:* Grupi auditimit

Nëse shohim peshën që zë financimi nga parkimet në buxhetin e përgjithshëm të Bashkisë Tiranë, kjo vlerë ka ruajtur të njëjtin trend në vlerë absolute me një total prej afërsisht 3% për të tre vitet ku peshën më të lartë e ka parkimi me bileta.

*Grafiku 1:* Struktura e të ardhurave për Bashkinë Tiranë




*Burimi:* Tirana Parking

*Përpunoi:* Grupi auditimit

Paraqitur edhe në formë grafike, sikundër vërehet pesha më e madhe në të ardhurat e krijuara, e përkthyer në përqindje i takon të ardhurave të krijuara nga parkimi me bileta. Konkretisht 68% nga parkimi me bileta, 31% zënë të ardhurat nga parkimi me kontratë dhe vetëm 1% të të ardhurave rezultojnë prej të ardhurave nga qiraja.

Grafiku 2: Krahasimi i të ardhurave kryesore për Bashkinë Tiranë 2018-2020



Burimi: Tirana Parking  
Përpunoi: Grupi auditimit

Sikundër vërehet në grafikun e mësipërm trendi i realizimit të të ardhurave faktike është në nivel rritës, konkretisht nivel rritës për vitet 2018-2019 me 14,606,856 mijë lekë, për vitin 2020 trendi ka një rënie të lehtë shkaktuar nga pandemia dhe kufizimet e vendosura për shkak të saj.

Tabela 4: Të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkisë Korçë për parkimet për periudhën 2018 – 2020

Emërtimi/Vitet	2018	2019	2020
<b>Të Ardhurat</b>			
Të ardhurat nga parkimi	20,666,333	18,707,966	13,915,718
<b>Totali i të ardhurave nga parkimi</b>	<b>20,666,333</b>	<b>18,707,966</b>	<b>13,915,718</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime page		1,155,310	5,695,086
Sigurime		192,937	951,079
Shpenzime operative			74,400
Shpenzime administrative			
Shpenzime për bileta parkimi	1,140,000	907,200	1,128,960
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>1,140,000</b>	<b>2,255,447</b>	<b>7,849,525</b>
<b>SUFICIT</b>	<b>19,526,333</b>	<b>16,452,519</b>	<b>6,066,193</b>

Burimi: Bashkia Korçë  
Përpunoi: Grupi auditimit

Duke qenë se, deri në shtator të vitit 2019, parkimet publike me pagesë në qytetin e Korçës janë menaxhuar nëpërmjet një PPP. Nga shtatorit i vitit 2019, e në vijim menaxhimi i parkimeve në qytetin e Korçës është bërë nga vet Bashkia. Për vitin 2018, nuk ka patur shpenzime page për punonjës të punësuar në zyrën e parkimeve në këtë bashki, pasi administrohej nëpërmjet një PPP. Konstatohet se, të ardhurat kanë ardhur në trend rënës nga viti 2018 në vitin 2020 me 6,750,615 lekë. Për vitin 2020 vihet re ndjeshëm impakti i pandemisë së shkaktuar nga Covid – 19 i cili ka bërë që të ardhurat e gjeneruara të jenë më të ulta por sërish duke gjeneruar në total suficit me vlerën 6,066,193 lekë.

Tabela 5: Plan fakt për të ardhurat e realizuara për periudhën 2018– 2020, për Bashkinë Korçë

Vitet		2018	
	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>TË ARDHURAT 2018</b>			
Të ardhurat nga parkimi	24,000,000	20,666,333	86
<b>Totali i të ardhurave nga parkimi</b>	<b>24,000,000</b>	<b>20,666,333</b>	<b>86</b>

Vitet		2019	
	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>TË ARDHURAT 2019</b>			
Të ardhurat nga parkimi	22,900,000	18,707,966	82
<b>Totali i të ardhurave nga parkimi</b>	<b>22,900,000</b>	<b>18,707,966</b>	<b>82</b>

Vitet		2020	
	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>TË ARDHURAT 2020</b>			
Të ardhurat nga parkimi	19,252,500	13,915,718	72
<b>Totali i të ardhurave nga parkimi</b>	<b>19,252,500</b>	<b>13,915,718</b>	<b>72</b>

Burimi: Bashkia Korçë

Përpunoi: Grupi auditimit

Sikundër vërehet në tabelat e mësipërme trendi i realizimit të të ardhurave plan fakt është në nivel rënës, konkretisht për vitin 2018 trendi i realizimit është 86%, për vitin 2019 trendi ka rënie në 82%.

Në vitin 2020, realizimi është edhe më i ulët si rrjedhojë e kufizimeve të vendosura e për shkak të pandemisë dhe evidentohet pasi niveli më i ulët është reflektuar drejtpërdrejtë tek të ardhurat nga parkimi.

Tabela 6: Pesha në buxhetin total të Bashkisë Korçë

Emërtimi	2018		% krahasuar totalit të të ardhurave	2019		% krahasuar totalit të të ardhurave	2020		% krahasuar totalit të të ardhurave
	Plan	Fakt		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>24,000,000</b>	<b>20,666,333</b>	<b>3.3%</b>	<b>22,900,000</b>	<b>18,707,966</b>	<b>2.8%</b>	<b>19,252,500</b>	<b>13,915,718</b>	<b>2.5%</b>

<b>parkimit te automjeteve</b>									
Parkim me koncesion	24,000,000	20,666,333	3.3%	22,900,000	18,707,966	2.8%	19,252,500	13,915,718	2.5%
<b>Totali i të ardhurave të BK</b>	<b>981,653,057</b>	<b>639,556,399</b>	<b>100%</b>	<b>1,072,804,586</b>	<b>666,250,407</b>	<b>100%</b>	<b>967,170,329</b>	<b>565,955,441</b>	<b>100%</b>

Burimi: Bashkia Korçë  
Përpunoi: Grupi auditimit

Grafiku 3: Të ardhurat nga parkimi në Bashkinë Korçë, 2018-2020



Burimi: Bashkia Korçë  
Përpunoi: Grupi auditimit

Sikundër vërehet në grafikon e mësipërm trendi i realizimit të të ardhurave faktike është në nivel rritës, konkretisht nivel rënës për vitet 2018-2020 me 6,750,615 mijë lekë, në krahasim me periudhën që shërbimi i parkingut mbulohej me koncension/PPP.

## 2.5 Përkufizimet dhe terminologjia


Termtat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **“Nënzonat e destinuara për parkim pa pagesë”** në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda Zonave të administrimit të parkimit përfshijnë:
  - a. **“Parkim për rezidentët”** – parkim i dedikuar vetëm për banorët e një prej 4 zonave të administrimit të parkimit ( ZAP 1,2,3,4)
  - b. **“Parkim i lirë”** - parkim pa roje ose pa sisteme kontrolli të kohëzgjatjes së qëndrimit (pa pagesë)
  - c. **“Parkim i rezervuar për invalid”** -parkim për automjetet e personave me aftësi të kufizuar pa pagesë.
- **“Nënzonat e destinuara për parkim me pagesë”** në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
  - a. **“Vendparkim me pagesë”** – parkim me sistem tarifimi me kohëzgjatje të përcaktuar sipas Zonave të tarifimit.
  - b. **“Vendparkim i rezervuar”** - Parkim i dedikuar vetëm për subjektet/institucione/person fizik të cilët kanë një kontratë me Tirana Parking për shfrytëzimin e vendparkimit sipas paketës së përzgjedhur ( fasha orare).

- **“Tirana Parking”** është institucion publik, varësi e Bashkisë Tiranë dhe luan rol të posaçëm në menaxhimin e parkimeve në qytetin e Tiranës.
- **“Titujt shtetërorë”** apo **“letrat me vlerë të qeverisë”**, janë instrumente borxhi të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Titujt shtetërorë emetohen në formën e bonove të thesarit dhe obligacioneve, në monedhë kombëtare dhe të huaj.

## 2.6 Skema e analizës së programit

Skema 5: Modeli Input – Output



*Burimi:* Bashkitë Tiranë, TP, dhe Bashkia Korçë  
*Përpunoi:* Grupi i auditimit

## 2.7 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit bashkëpunoi me subjektin nën auditim, me qëllim vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Në këtë fazë është vënë re një koordinim eficient nga ana e subjekteve nën auditim duke reflektuar bashkëpunim me grupin e auditimit dhe vënien në dispozicion të dokumenteve e materialeve të kërkuara brenda afateve ligjore. TP, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Korçë i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese dhe intervistave paraprake, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 154/ 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

## 3. DETAJET E AUDIMIT

### 3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Institucionet dhe organizatat janë vazhdimisht të ekspozuara ndaj faktorëve të mjedisit të jashtëm, të cilët mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në performancën e tyre. Një mjet analitik i cili mundëson identifikimin e faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe ndikimin që mund të kenë këta faktorë në veprimtarinë institucionale, është analiza SWOT.

Analiza SWOT paraqet fuqitë dhe dobësitë e institucionit që janë faktorë “brenda kontrollit menaxherial”, si dhe shanset dhe kërcënimet që janë faktorë “jashtë kontrollit menaxherial” ose të klasifikuara si risqe nga faktorë të brendshëm dhe risqe nga faktorë të jashtëm.

Kur risqet vijnë nga faktorë të brendshëm, institucioni duhet të mbështetet në fuqitë dhe të minimizojë dobësitë, ndërsa kur risqet vijnë nga faktorë të jashtëm institucioni duhet të shfrytëzojë shanset dhe të shmangë kërcënimet.

Tabela 7: Analiza SWOT

	<b>Fuqitë (S)</b>	<b>Dobësitë (W)</b>
Faktorë të brendshëm	<p>Strategjitë dhe Planet Vendore të miratuara;</p> <p>Digjitalizimi i menaxhimit të parkimeve (Bashkia Tiranë)</p> <p>Ngritja dhe funksionimi i Agjencisë Tirana Parking (Bashkia Tiranë).</p> <p>Projekti për rezidentët.</p> <p>Rezultati ekonomik pozitiv.</p> <p>Kontratat e lidhura me bizneset për parkimet me pagesë.</p>	<p>Strategjitë dhe Planet Vendore të miratuara, jo-SMART për menaxhimin e parkimeve.</p> <p>Mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Mangësi në monitorimin e zbatimit të politikave të parkimit.</p> <p>Mangësi në sinjalistikën e zonave të parkimit.</p> <p>Mungesa e metodave alternative të pagesës së shërbimit në rrugë (si p.sh. automatet për biletat)</p> <p>Mosshfrytëzimi i hapësirave të parkimit në rrugë për shkak të zaptimit nga persona të paautorizuar.</p> <p>Vendosja e tarifave të parkimit pa studim të mirëfilltë dhe pa konsultim me palët e interesit.</p> <p>Biletat e parkimit të pa miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Tirana parking)</p>
	<b>Shanset (O)</b>	<b>Kërcënimet (T)</b>

Faktorë të jashtëm	<p>Studime dhe plane të shumta Bashkimit Evropian për menaxhimin e suksesshëm të parkimeve në qytete.</p> <p>Praktika të mira ndërkombëtare për menaxhimin e suksesshëm të parkimeve në qytete,</p> <p>Bashkëpunim i mirë me Policinë Bashkiake për zbatimin e politikave të parkimit.</p> <p>Trajnime dhe Workshop mbi idetë inovatore të parkimit dhe transportit.</p>	<p>Gjendja ekonomike e rënduar e vendit.</p> <p>Ngjarje të jashtëzakonshme, si: tërmeti, pandemia.</p> <p>Trafik i rënduar.</p> <p>Parkimet private me pagesë, me çmime më konkurruese se parkimet publike me pagesë.</p>
--------------------	--	---

*Burimi:* Bashkia Tiranë, Bashkia Korçë dhe Tirana Parking

*Përpunoi:* Grupi i auditimit

Në vijim të analizimit të risqeve për menaxhimin e parkimeve në Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Korçë, nëpërmjet analizës SWOT dhe klasifikimit të tyre në faktorë rrisht të mjedisit të jashtëm dhe të mjedisit të brendshëm, më poshtë është paraqitur klasifikimi i tyre në risk strategjik, financiar, juridik, taktik dhe operacional.

**Skema 6: Klasifikimi i risqeve në risk strategjik, financiar, juridik, taktik, operacional.**

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Plane strategjike dhe operacionale jo-smart	Risk Strategjik	I Lartë
2	Të ardhura më të ulta si rrjedhojë e pandemisë	Risk Financiar	I Lartë
3	Mungesa e analizave në përcaktimin e tarifës së parkimit		I Mesëm
4	Parkimet private me pagesë, me çmime më konkurruese se parkimet publike me pagesë.		I Mesëm
5	Mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.	Risk Rregullator dhe Juridik	I Mesëm
6	Kontrata të hartura dhe të lidhura me operatorët e telefonisë celulare, me mangësi		I Mesëm
7	Biletat e parkimit të pamiratura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve		I Mesëm
8	Mungesa e raporteve të monitorimit të zbatimit të politikave të parkimit	Risk Operacional	I Lartë
9	Mungesa e metodave alternative të pagesës së shërbimit në rrugë.		I Lartë
10	Mangësi në sinjalistikën e zonave të parkimit.		I Mesëm

*Burimi:* Bashkia Tiranë, Bashkia Korçë dhe Tirana Parking

*Përpunoi:* Grupi i auditimit


**3.2 Objektivi i auditimit**

Ky auditim ka si objektiv vlerësimin e performancës së menaxhimit të parkimeve publike me pagesë në qytetin e Tiranës dhe Korçës. Për të vlerësuar ekonomicitetin, auditimi përgjithësisht fokusohet tek inputet, për të vlerësuar eficiencën fokusi vendoset tek inputet e përdorura dhe

outputet e prodhuar, ndërsa për të vlerësuar efektivitetin fokusi vendoset tek rezultatet e arritura në raport me objektivat e synuara.

Duke qenë se, ky auditim do të përqendrohet kryesisht tek rezultatet e arritura në raport me objektivat e synuara, si dhe tek aktivitetet e ndërmarra për zbatimin dhe monitorimin e politikave të parkimeve publike, *fokusi i tij do të jetë tek vlerësimi i efektivitetit dhe eficiencës së menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës dhe Korçës.*

### 3.3 Piramida e pyetjeve audituese:



Burimi: Grupi i auditimit KLSH

#### Pyetja kryesore:

A ka qenë efektiv dhe eficient menaxhimi i parkimeve publike në Bashkitë Tiranë dhe Korçë për periudhën 2018-2020?

#### Nënpyetjet e nivelit të parë:

1.1 A është kryer planifikimi i duhur për menaxhimin e parkimeve publike në qytetet e Tiranës dhe Korçës?

1.2 A kanë rezultuar aktivitetet e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, në arritjen e rezultateve të pritshme nga menaxhimi i parkimeve?

#### Nënpyetjet e nivelit të dytë:

1.1.1 A janë përcaktuar dhe planifikuar objektiva dhe aktivitet SMART, për menaxhimin e parkimeve në qytetet e Tiranës dhe Korçës?

1.2.1 A janë zbatuar në mënyrën efiçente aktivitetet dhe projektet e nevojshme për menaxhimin e parkimeve në të dy qytetet të Tiranës dhe Korçës?

1.2.2. A është monitoruar në mënyrë të vazhduar performanca e menaxhimit të parkimeve në qytetet e Tiranës dhe Korçës?

### **3.4 Fushëveprimi i auditimit**

Sikurse e përcaktuam edhe më lartë, fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i efektivitetit dhe eficiencës së aktiviteve të përcaktuara për menaxhimin e parkimeve publike, nga Bashkia Tiranë dhe më specifikisht Tirana Parking, dhe Bashkia Korçë, në qytetet e Tiranës dhe Korçës, për periudhën 2018-2020. Grupi i auditimi gjatë fazës së hartimit të programit, ka kryer vizita në terren në qytetet e Tiranës dhe Korçës, lidhur me vendet e parkimit dhe sinjalistikën e instaluar, si dhe ka parashikuar kryerjen e inspektimeve më të detajuara gjatë fazës së terrenit në qytete respektive.

### **3.5 Qasja/ metodologjia e auditimit**

Të dhënat që do të mbledhë dhe analizojë grupi i auditimit, do të jenë si të natyrës sasiore, ashtu edhe cilësore. Për rrjedhojë, në këtë auditim do të përdoret një qasje mikse, *pragmatike*, për të bërë një analizë të duhur dhe korrekte të evidencave, duke çuar në gjetje të pakontestueshme dhe në konkluzione e rekomandime të bazuara në to.

Gjithashtu, grupi i auditimit gjykon të arsyeshme përdorimin e qasjes së orientuar *kah procesi* dhe *kah rezultati*, për të vlerësuar *efektivitetin dhe eficiencën e aktiviteve të ndërmarra për menaxhimin e suksesshëm* të parkimit të mjeteve motorike. Kështu, do të vlerësohet performanca e Bashkisë Tiranë, TP-së dhe Bashkisë Korçë në administrimin e parkimeve publike në qytetet përkatëse.

Metodat dhe teknikat audituese që do të përdoren në këtë auditim janë si vijon:

- Mbledhje, shqyrtim dhe analizimi cilësor e sasior i evidencave shkresore gjatë fazës studimore dhe të terrenit;
- Intervista të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar me strukturat përgjegjëse në Bashkitë Tiranë, Korçë dhe TP, për çështjen nën auditim;
- Pyetësorë me publikun;
- Vizita dhe inspektime në terren;
- Kryqëzim i të dhënave për të gjeneruar evidenca të mjaftueshme, të besueshme dhe relevante për çështjen nën auditim;
- Benchmarking me standardet dhe praktikat më të mira; etj.

## **4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE**

**Lidhur me pyetjen kryesore u arrit në këtë mesazh auditimi: “A ka qenë efektiv dhe eficient menaxhimi i parkimeve publike në Bashkitë Tiranë dhe Korçë për periudhën 2018-2020?” mesazhi i auditimit:**

---

Menaxhimi i parkimeve në Bashkinë Tiranë në nivel strategjik vuan nga një planifikim i dobët, i cili nuk është mbështetur në analiza të detajuara, duke mos siguruar kështu ndarjen e strukturave përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve specifike, kostim të aktiviteteve, apo rezultate të pritura vit pas viti në të cilin shtrihet strategjia. Kjo situatë ka shkaktuar që 20% e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik “*Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022*”, të mos jenë zbatuar. Problematika të shumta u konstatuan në bllokimin e posteve të parkimit me pagesë nga ndërtimet që po zhvillohen në qytet, apo uzurpimet arbitrare duke cenuar performancën e procesit. Mungesa e raporteve të monitorimit nuk siguron rezultate solide në drejtim të arritjes së vizionit të Bashkisë për administrimin e parkimeve ç’ka përmban riskun e mungesës së efektivitetit dhe eficiencës së këtij funksioni.

Menaxhimi i parkimeve në qytetin e Korçës nuk ka pasur vëmendjen e duhur nga strukturat drejtuese të Bashkisë, të cilat në mungesë të një vizioni për parkimet që shkon në linjë me vizion holistik për zhvillimin e qytetit, e kanë mbështetur këtë funksione në projekte test. Planifikimi i dobët i projekteve test për parkimet në këtë qytet, ka shkaktuar në 67% e tyre të mos zbatohen, duke mos siguruar përfitimet që rrjedhin nga menaxhimi i duhur i parkimeve si p.sh. përmirësimi i lëvizshmërisë urbane, mbështetje më e madhe për ekonominë lokale, siguri e rritur rrugore, cilësi më e mirë e ajrit, etj. Problematika të shumta u konstatuan me plotësinë, qartësinë dhe saktësinë e sinjalistikës horizontale dhe vertikale të parkimeve në qytetin e Korçës. Nga ana tjetër, sistemi i dobët i monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për parkimet në qytet, nuk ka mundur identifikimin dhe marrjen e masave për përmirësim. Sa më sipër, menaxhimi i parkimeve publike në qytetin e Korçës vuan nga mungesa e efektiviteti dhe eficiencës.

---

**4.1. A ka qenë efektiv dhe eficient menaxhimi i parkimeve publike në Bashkitë Tiranë dhe Korçë për periudhën 2018-2020?**

**4.1.1. A është kryer planifikimi i duhur për menaxhimin e parkimeve publike në qytetet e Tiranës dhe Korçës?**

**4.1.1.1 A janë përcaktuar dhe planifikuar objektiva dhe aktivitetet SMART, për menaxhimin e parkingjeve në qytetet e Tiranës dhe Korçës?**

Menaxhimi i parkimet në qytet është mjaft i rëndësishëm për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të lëvizshmërisë urbane, ç'ka ndikon drejtpërdrejtë zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit. “Menaxhimi i parkimit është një nga shtyllat e planifikimit të lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane (SUMP). Ekziston një nevojë thelbësore për ta shndërruar parkimin nga një punë e thjeshtë operacionale në një qasje planifikimi shumë më strategjike. Është mjaft e rëndësishme që të mbahet parasysh se menaxhimi i parkimit ofron vlerë të shkëlqyer për para. Masat janë me kosto të ulët (shumë shpesh pa kosto të lartë infrastrukture), mund të zbatohen shpejt dhe të gjenerojnë të ardhura për të paguar kostot që rezultojnë nga ato, duke mbështetur gjithashtu marrjen e masave të tjera të tilla si transporti publik dhe ecja për të sjellë ndryshim në sjelljen e udhëtimit.”<sup>9</sup>

Në dokumentin udhëzues mbi zhvillimin e qëndrueshëm të lëvizshmërisë urbane, të publikuar në qershor të vitit 2019 nga Shërbimi Evropian i Informacionit të Transportit Lokal (ELTIS), menaxhimi i parkimit cilësohet si me rëndësi të veçantë për zhvillimin e qytetit. “Menaxhimi i mirë i parkimit ndihmon në lirin e hapësirës publike të vlefshme, duke i bërë qytetet tona më tërheqëse; mbështet ekonominë lokale, zvogëlon trafikun e automjeteve; përmirëson mbingarkesën, sigurinë rrugore dhe ndotja e ajrit; dhe për më tepër gjenerojnë të ardhurat për të investuar në një lëvizje të qëndrueshme dhe urbane përmirësime.”<sup>10</sup> Në kapitujt e parë të këtij auditimit, janë paraqitur edhe arsyet përse është i rëndësishëm menaxhimi i parkimeve në qytet. Menaxhimi i politikave të parkimeve, vlerësohet dhe duhet të trajtohet si pjesë integrale e Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban. Në dokumentin udhëzues të publikuar nga ELTIS (trajtuar më lartë), parashikohet se aktivitetet e parkimit duhet të jenë pjesë e planeve të zhvillimit, sikurse janë aktivitetet për sigurinë rrugore, menaxhimin e trafikut, motivimin e përdorimit të biçikletave

---

<sup>9</sup> Arsye dhe parimet e duhura për menaxhimin e parkimit. Park4SUMP, EU, Civitas, janar 2020

<sup>10</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane, ELTIS, qershor 2019, fq 5.

etj, në funksion të vizionit dhe objektivit strategjik të bashkisë për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit.

Tabela 1: Menaxhimi i parkimeve si pjesë e Planeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Qyteteve

Vizioni										Konsultimi me publikun	Integrim me politika të tjera si, shëndeti, mjedisi, etj
Analiza e problemit											
Vendosja e objektivave, targetat dhe indikatorët											
Masat për çdo “modalitet”											
Çiklizm	Ecje në këmbë	Transporti publik	Siguria në rrugë	Menaxhimi i lëvizshmërisë	Menaxhimi i parkimeve	Aksesueshmëria	Mirëmbajtja	Menaxhimi i trafikut	Internodalitetit	Transporti i mallrave	
Monitorim, vlerësim dhe rishikim											

Burimi: ELTIS<sup>11</sup>

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga sa më sipër konkludohet se, praktikat e mira sugjerojnë menaxhimin aktiv të parkimeve, nëpërmjet planifikimit strategjik, si një revolucion për lëvizshmërinë urbane.<sup>12</sup>

Referuar praktikave të mira<sup>13</sup>, me qëllim planifikimin efektiv dhe të qëndrueshëm të politikave të parkimit, është e nevojshme ndërmarrja e masave të nevojshme nga strukturat përgjegjëse për t'i kthyer përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- ✓ Cili është vizioni për zhvillimin e qytetit dhe si integrohen në të, politikat e parkimit aktuale apo të ardhshme?;
- ✓ Si mund të bëhet qyteti më i arritshëm nga këmbësorët, çiklistët apo transporti publik?;
- ✓ A e mbështet politika aktuale e parkimit ecjen, përdorimin e biçikletave apo transportin publik?;
- ✓ Cilat grupe të synuara janë më shumë/më pak të mirëpritur të udhëtojnë me makinë në qytet?;
- ✓ Ku dhe për cilin target grup dëshirohet të krijohet ofertë parkimi me cilësi të lartë?;
- ✓ Sa duhet të kushtojë politika e parkimit në qytetin tim?;
- ✓ Sa të ardhura mund të përfitohen nga menaxhimi i parkimeve (që mund të përdoret për të financuar aktivitete të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit)?; etj.

Në vijim grupi i auditimi ka shqyrtuar dokumentat strategjike të Bashkisë Tiranë dhe Korçë dhe ka analizuar përfshirjen e politikave të parkimeve në to, me qëllim orientimin e menaxhimit të parkimeve drejtë praktikave më të mira.

Referuar nenit 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, “Titullarët e njësisve publike në fushën e menaxhimit financiar dhe

<sup>11</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane”, Eltis, qershor 2019, fq 13.

<sup>12</sup> Arsye dhe parimet e duhura për menaxhimin e parkimit. Park4SUMP, EU, Civitas, janar 2020.

<sup>13</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane”, Eltis, qershor 2019, fq. 11, referuar Udhëzimit për Flanders (BE) për politikën e qëndrueshme të parkimit (Vademecum Duurzaam Parkeerbeleid), 2007. Dokumenti udhëzues ishte zhvilluar si një Shtojcë aktuale e Dekretit ekzistues të L-SuMPs / legjislacioni i vitit 2003.

kontrollit kanë këto kompetenca kryesore hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave”;

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, njësitë e qeverisjes vendore duhet të kryejnë planifikimin strategjik, si instrumenti më i lartë i planifikimit, me qëllim për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të qyteteve, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në kreun VI “Planifikimi Strategjik” të ligjit të mësipërm, në nenin 32 të tij, përcaktohet se: “1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik të zhvillimit të njësisë përkatëse, i cili miratohet me vendim nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. 2. Plani Strategjik i Zhvillimit: a) përmban politikat për zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shtrihet në një afat kohor jo më pak se 5 vite; b) merr në konsideratë nevojën dhe potencialet e zhvillimit vendor si dhe prioritetet rajonale e kombëtare të zhvillimit strategjik. Ky plan paraqet synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikon veprimet që njësia duhet të ndër marrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse; c) zbatohet nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësisë. 3. Kostot e përlllogaritura në planin strategjik të zhvillimit mbështeten në parashikime realiste të burimeve të financimit për të njëjtën periudhë. 4. Para miratimit në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, projekti i planit strategjik të zhvillimit konsultohet me njësinë përkatëse të koordinimit të strategjive në qeverisjen qendrore, Ministrinë e Financave, komunitetin vendor dhe grupet e interesit, si dhe me njësi të tjera, me të cilat kufizohet territori i saj.”

Në aktet nën ligjore të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 21, datë. 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, përcaktohet se me qëllim planifikimin strategjik dhe kontrollin e tij në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, menaxhimi duhet të kryet sipas objektivave (MsO). “Menaxhimi sipas objektivave (MsO) është procesi i përcaktimit të objektivave brenda organizatës në mënyrë që menaxhimi dhe punonjësit së bashku të bien dakord për objektivat dhe të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë në organizatë, që t’i arrijnë ato”<sup>14</sup>. Parashikohet gjithashtu se, me qëllim menaxhimin sipas objektivave, strategjia e institucionit duhet të ketë objektiva SMART. “Strategjia mund të jetë për një vit ose shumëvjeçare dhe rinovohet çdo vit. Në procesin vjetor të rinovimit të dakordësisë për strategjinë e performancës, duhet të bëhet një krahasim midis planit dhe realizimit, prandaj është e këshillueshme të bihet dakord për treguesit e performancës, masat dhe dimensionet financiare brenda kësaj strategjie për të gjetur prova për progresin në lidhje me arritjen e objektivave. Objektiva SMART<sup>15</sup>:

S – Specifik (objektiva të qartë, përgjegjësi të qarta),

M – I matshëm (mund të matet me shifra),

A – I arritshëm (masat e marra ndikojnë në arritjen e qëllimit),

R – Relevant (objektivi nuk është as shumë i lartë dhe as shumë i ulët),

T – Me afat (ka një kohë të caktuar për arritjen e objektivit).

Hartimi i objektivave SMART me qëllim planifikimin e duhur strategjik sugjerohet gjerësisht edhe në praktikatat e huaja. “Objektivat e politikave me qëllim arritjen e performancës në

<sup>14</sup> Udhëzimi Nr. 21, datë.25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, pika 6.1.3.

<sup>15</sup> Udhëzimi Nr. 21, datë.25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, pika 6.1.3.

*qeverisje, duhet të formulohen duke përdorur teknikat SMART. Ato duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshëm, relevant dhe të lidhura me kohën*<sup>16</sup>.

Përcaktimi i indikatorëve të performancës dhe targetave për secilin prej tyre është i rëndësishëm për të siguruar informacione të krahasueshme lidhur me rezultatet e synuara dhe rezultatet faktike të arritura për çdo aktivitet gjatë periudhës së implementimit të strategjisë, pra për të konkluduar mbi performancën e arritur.

Me qëllim monitorimin e vazhdueshëm dhe identifikimin në kohë të hapësirave për përmirësim, është e nevojshme që treguesit e performancës për çdo aktivitet të përcaktuar në strategji, të maten në bazë vjetore.

Sikurse praktikat e mira sugjerojnë, apo përcaktimet në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, dhe Udhëzimit Nr. 21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve” pika 6.1.3, me qëllim arritjen e objektivave strategjik, ato duhet të detajohen në aktivitetet që duhet të ndërmerren vit pas vitit, për periudhën që shtrihet Strategjia, duhet të përcaktohen objektivat/targetat, indikatorët e performancës, si dhe këto aktivitete duhet të kostohen në mënyrë realiste.

Referuar Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pika 6.1.3, njësitë publike për të ushtruar funksionin e kontrollit duhet që aktivitetet strategjike të markohen me treguesit e performancës dhe objektiva të matshëm/targeta. Kjo do të siguronte monitorimin e zbatimit të strategjisë nëpërmjet krahasimit plan-fakt.<sup>17</sup>

#### ➤ **Bashkia Tiranë**

Bashkia Tiranë në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Kreu VI, neni 15 ka ndërmarrë nismën për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022 (SZHQBT)<sup>18</sup> që është instrumenti më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor. Dokumenti është miratuar me Vendim nr.160 datë 21.12.2018 të Kryetarit të Këshillit Bashkiak të Tiranës. Dokumenti është i publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit të saj, dhe si i tillë konsiderohet version final dhe i gatshëm për implementim gjatë viteve në vijim. Nëpërmjet kësaj strategjie Bashkia Tiranë synon të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit. Zhvillimi i qëndrueshëm nga këndvështrimi i këtij dokumenti është projektuar si një qasje e sistemit aktual vendor drejt rritjes dhe zhvillimit urban dhe rural, duke siguruar një manaxhim të sukseshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqënies së qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.

Në këtë plan strategjik janë përcaktuar vendime përsa i përket: 1. Përcaktimit të vizionit, qëllimit dhe metodologjisë së kësaj strategjie. 2. Hartimit të objektivave afatgjata për arritjen e këtij misioni. 3. Zgjedhjes së strategjive që do të përdoren për arritjen e objektivave të saj, konkretisht:

**Vizioni:** Për pesë vitet e ardhshme të projektoj Tiranën si një qendër të integruar më së miri në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor European, një nyjë intermodale më konkurruese në hapësirën Ballkanike që synon barazinë akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Konsolidimi dhe rigjenerimi urban, rritja e aksesit në arsim, i shoqëruar me një sistem të balancuar të shpërndarjes së transportit publik, me një përdorim më të zgjuar të ekosistemit urban dhe rural për të zhvilluar

<sup>16</sup> “Mirëqeverisja”, Gjykata Supreme e Auditimit, Holandë, fq.13.

<sup>17</sup>Udhëzim Nr. 21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, Pika 6.2.1.

<sup>18</sup> Strategjia për Zhvillimin e Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë, 2018-2022

një ekonomi të gjelbër të qëndrueshme do të jenë prioritetet e ardhshme të angazhimeve të BT-së.

**Qëllimi:** Hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm të gjithë sektorëve nën përgjegjësinë e BT-së. Si motorri ekonomik i vendit<sup>19</sup>, Bashkia Tiranë ka nevojë të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm sa më të balancuar socio-ekonomik, kulturor dhe territorial për të udhëhequr gjithë Shqipërinë në rrugën e saj të integritit Evropian. SZHQBT synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha projektet e BT në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa fusha prioritare.

**Objektivat Strategjike:** Pesë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet SZHQBT, të cilat janë pjesë integrale e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë 2015 – 2030 dhe në koordinim të plotë me të gjithë dokumentat strategjike në nivel qendror dhe vendor. Potencialet dhe problematikat e evidentuara janë ndërthurur dhe kombinuar duke formuluar këto prioritetet:

1. Rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik (Tirana Policentrike);
2. Arsimi për të gjithë;
3. Garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë;
4. Tirana për të gjithë, qytet i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës;
5. Qeverisja e mirë.

Planifikimi strategjik i institucionit (ku është përfshirë edhe agjencia Tirana Parking) është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve (DPSJP) si struktura përgjegjëse për hartimin e këtij dokumenti. Të gjitha drejtoritë e aparatit të BT-së dhe institucionet e varësisë kanë ofruar informacion duke caktuar një person përgjegjës për të bashkëpunuar deri në hartimin e SZHQ.

Në përfundim të procesit të hartimit me, Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB), nr. Prot. 160, datë 21.12.2018, është miratuar SZHQBT.

Për hartimin e SZHQBT 2018-2022, përsa i takon pjesës së parkimeve, rezulton se, është mbajtur korrespondencë me Drejtorin e TP, ku ndër të tjera janë shprehur parashikimet për projektet strategjike për parkimin për 5-vjeçarën e ardhshme, projektet më të afërta dhe një përmbledhje për të mbuluar të gjitha funksionet e Tirana Parking. Si më poshtë vijojnë:

*1- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë , sheshe , mbi dhe nën tokë. Rritja e mënyrave alternative të pagesës së parkimit në sheshe (digitalizimi). Rritja e mënyrave alternative të pagesës së parkimit në rrugë (kalimi i inspektorëve nga vjelës të të ardhurave në kontrollues)*

*2- Rritja e hapësirave publike për administrim parkimi me pagesë, parkimi rezident*

- Ndërtimi i shesheve të reja mbi tokë
- Manaxhimi i parkimeve të reja nëntokësore
- Përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të dedikuara “Vetëm për rezident”, duke i pajisur me sinjalistikën e plotë horizontale (tabelë informuese) dhe vertikale (vijëzime) “ Vetëm për Rezident” Trajtimi në minizona brenda ZAP-ve .

*I njëjti trend parashikohet të mbahet deri në fund të 5-vjeçarit*

*3- Rritja e efikasitetit të institucionit nëpërmjet mirëmenaxhimit të stafit, trajnimeve për platformat e reja të sistemeve të parkimit (menaxhimit e monitorimit të raportimeve mujore, 3-6 mujore dhe vjetore).*

---

<sup>19</sup>Bazuar në SZHQBT 2018-2022.

Në dokumentin strategjik theksohet se: “Puna filloi me mbledhjen e të dhënave nga gjithë strukturat e Bashkisë dhe analizën e situatës aktuale. U evidentuan pikat e forta dhe të dobëta për çdo sektor, të cilat janë përmbledhur shkurtimisht në fund të çdo kapitulli në formën e analizave SWOT. Në bazë të gjetjeve të analizës janë nxjerrë dhe objektivat kryesore të strategjisë për 5-vjeçarin e ardhshëm, të zërthyer në programe, projekte dhe aktivitete të detajuara së bashku me indikatorët përkatës, të cilët do të ndihmojnë në thjeshtimin, por dhe në rritjen e efikasitetit të procesit të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë.”<sup>20</sup> Parkimet publike janë vendosur në SZHQBT 2018-2022 si pjesë e objektivave strategjik, konkretisht:

**Objektivi Strategjik 4. Tirana për të gjithë, qytet i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës.**

**Objektiv specifik 2: Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës (ZBQ).**

Mungesa e hapësirave të parkimit është një nga problemet më serioze me të cilat përballlet Tirana sot. Për këtë qëllim, BT është e angazhuar në disa projekte që do të përmirësojnë situatën e parkimit në qytet. Projektet kanë fokus përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimit me pagesë për zonat e parkimit, manaxhim më të mirë të shesheve të parkimit dhe parkimeve nëntokësore. Një vëmendje e veçantë do ti kushtohet edhe infrastrukturës së parkimeve të rezidentëve.<sup>21</sup>

Në SZHQ të BT-së, është përcaktuar *objektivi Strategjik 4. Tirana për të gjithë, qytet i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe objektivi specifik “Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës (ZBQ)”<sup>22</sup>, i cili i përgjigjet fokusit të këtij auditimit. Për këtë objektiv specifik është parashikuar programi strategjik, 5 projekte, indikatorët lidhur me monitorimin dhe raportin si dhe rezultatet si më poshtë:*

Tabela 7: Aktivitetet, Indikatorët, Afatet dhe Strukturat Përgjegjëse sipas SZHQ 2018-2022.

	Projekte	Indikator	Rezultatet
<b>Objektivi specifik 4</b> <i>Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës (ZBQ)</i>	1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë, sheshe, mbi dhe nën tokë.	1. Kalimi i inspektoreve nga vjelës të të ardhurave në kontrollues	- Reduktim i trafikut dhe rritja e lëvizshmërisë në qytet - Përmirësim i cilësisë së ajrit - Reduktim i parkimit në rrugë për të lehtësuar qarkullimin në arteriet kryesore të qytetit
	2. Diversifikimi i mënyrave të pagesës së parkimit në sheshe	2. Digitalizimii mënyrës së pagesës së parkimit	
	3. Rritja e hapësirave publike për administrim parkimi me pagesë,	3. – Shtimi i 2600 vende parkimi me pagesë - Rreth 35.000 m <sup>2</sup> të dedikuara për parkim	
	4. Ndërtimi I shesheve të reja mbi tokë		
	5. Përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të dedikuara “Vetëm për rezident”	4. Pajisja me sinjalistikën e plotë horizontale në zonat e parkimit për rezident	

Burimi: Bashkia Tiranë, SZHQ 2018-2022.

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>20</sup> SZHQBT, fq 185 [https://tirana.al/uploads/2019/3/20190304142936\\_szhqbt-2018-2022-30-e-miraturar-per-web-finale.pdf](https://tirana.al/uploads/2019/3/20190304142936_szhqbt-2018-2022-30-e-miraturar-per-web-finale.pdf).

<sup>21</sup> Referuar SZHQBT, fq 179

<sup>22</sup> Bashkia Tirabë, Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm 2018-2022, fq. 179.

Referuar SZHQ, sikundër jemi shprehur, strukturat përgjegjëse për këtë objektiv strategjik nuk janë specifikuar. Theksojmë se, termi *nuk janë specifikuar* përdoret pasi mund të ketë projekte të cilat kanë nevojë për bashkëpunim mes Agjencisë dhe Drejtorive të tjera të BT.

Lidhur me vendosjen e targetave operacional nga TP, me qëllim arritjen e Objektivave Strategjik, për pyetjen e drejtuar nga grupi i auditimit nëpërmjet intervistës zyrtare datë 17.05.2021. “Çfarë analizash keni kryer për përcaktimin e targetave vjetor operacional të Institucionit”, TP është përgjigjur “*Targetat vjetore bazohen mbi potencialin e institucionit dhe realizimet e vitit të mëparshëm*”<sup>23</sup>.

Në pyetësorin me datë 24.05.2021, pyetja nr.3 A ka TP objektiva/nën objektiva vjetor të matshëm për të arritur, të deklaruar në dokumentet institucionale? Cilët janë këto target, dhe kur duhet të arrihet? Lutemi vini në dispozicion dokumentin.

Përgjigje: 3.2: Objektivat e Institucioni Tirana Parking janë të përcaktuara qartë në Regjistrin e Riskut i cili hartohet nga grupi i punës, i ngritur nga Titullari i Institucionit çdo fillim viti.

Targetat dhe afati për realizimin e tyre janë të paraqitura në dokumentin e sipërcituar.

Institucioni Tirana Parking harton periodikisht planet dhe analizat vjetore ku vendosen objektivat të matshme të institucionit.

Pyetje 4: Mbi cilat vlerësime është mbështetur vendosja e targetave vjetor? Lutemi vini në dispozicion analizat përkatëse.

Përgjigje: Targetat vjetore bazohen mbi potencialin e institucionit dhe realizimet e vitit të mëparshëm.

Sa më sipër, nuk ka informacion të qartë se si operohet për ti vendosur, çfarë analize kryhet, cilat drejtori marrin pjesë, personat përgjegjës etj.

Tabela 8: Targetat operacional, realizimi dhe afati në TP 2018

Nr	Objektivat Specifike	Komente per realizimin e planit	Afati
2	Pajisja me sinjalistikë të plotë e rrugëve të zonës A, B dhe C prej të cilave: Zona A (11 rrugë) Zona B (10 rrugë) Zona C (1 rrugë)ë cilat janë përcaktuar në VKB nr. 49 datë 11.11.2015	Realizuar	Janar – Dhjetor 2018
3.	Fillimi i tarifimit të 22 rrugëve të reja të plotësuara me sinjalistikën vertikale dhe horizontale: • Zona A (11 rrugë) • Zona B (10 rrugë) • Zona C (1 rrugë)	Realizuar ne Mars te 2018	Janar – Dhjetor 2018
4.	Përfundimi i punimeve të ndërtimit dhe fillimi i administrimit me pagesë i Sheshit të Parkimit “Avni Rustemi” me sistem parkimi Full HD	Realizuar ne shkurt 2018	Shkurt 2018
5	Përfundimi i punimeve të ndërtimit dhe fillimi i Administrimit me Pagesë i Sheshit të Parkimit “Diga e Liqenit ” me sistem parkimi Full HD	Realizuar ne shkurt 2018	Shkurt 2018
6	Punime ndërtimore me qëllim pershatjen e terrenit te terminalit te autobuzave per linjat nderqytetase te Duresit dhe Jugut per vendosjen e sistemit te parkimit.	Realizuar ne gusht 2018	Pergjate vitit 2018
7.	Studimi per plotësim me sinjalistikë vertikale dhe horizontale për tarifim të 15 rrugëve të ndara sipas zonave të tarifimit: • Zona A (2 rrugë) • Zona B (6 rrugë) • Zona C (7 rrugë)	Realizuar	Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2018

<sup>23</sup>Emaili zyrtar, përgjigjur TP dt 24.05.2021

8.	Pajisja e qytetarëve rezident me pullat e rezidentëve në zonat 1, 2, 3, 4 të përcaktuara sipas VKB Nr.49 datë 11.11.2015.	Realizuar	Pergjate vitit 2018
----	---	-----------	---------------------

Tabela 9: Targetat operacional, realizimi dhe afatet TP, 2019

Nr	Objektivat Specifike	Komente per realizimin e planit	Afati
2	Pajisja me sinjalistikë të plotë e 23 rrugëve të zonës A, B dhe C, prej të cilave; - 7 rrugë Zona A - 10 rrugë Zona B - 6 rrugë Zona C të cilat janë përcaktuar në VKB nr. 49 datë 11.11.2015 dhe VKB nr. 36 datë 29.03.2018, si rrugë me sistem tarifimi dhe ravijëzimi i 29 rrugëve ekzistuese me sitem tarifimi.	Realizuar Dhjetor 2019	Shtator – Dhjetor 2019
3	Pajisja me sinjalistikë të plotë "Vetëm për Rezident" e 24 Blloqeve të banimit në zonat administrative 1, 2, 3 dhe 4 të parashikuara	Nuk është realizuar pajisja me sinjalistike për Rezident ne vitin 2019. Pasi procedura per rezlizimin e saj ishte parashikuar ne fund te vitit dhe për shkak te situatës se shpallur fatkeqësi natyrore prejTermetit, te gjitha procedurat te investimeve publike u pezulluan për një afat kohor te pacaktuar dhe për këtë arsye u shty për vitin 2020.	Janar -Dhjetor 2019
4	Rikonstruksioni i Sheshit të parkimit pranë stadiumit "Selman Stermasi"	Realizuar	Shtator 2019
6	Hapja dhe Administrimi i 2 sheshparkimeve nëntokësore të reja (sheshparkimi 7 Xhuxhat dhe sheshparkimi pranë Stadiumit Qemal Stafa)	Realizuar 7 xhuxhat ne GUSHT 2019	Janar-Shtator 2019
7	Shtimi i metodave alternative për kryerjen e pagesës në rrugët me tarifim për përmirësimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë	Nuk është realizuar, është akoma ne studim për zgjedhjen e mënyrave alternative	Janar -Dhjetor 2019

Tabela 10: Targetat operacional, realizimi dhe afatet TP, 2020

Nr.	Objektivat Specifike		Afati
-----	----------------------	--	-------

1.	Implementimi i pagesës alternative ne funksion te shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë me anë të metodave.	Nuk është Realizuar	31.12.2020
2.	Administrimi i rrugëve per 3 Zonat e Tarifimit Fillimi i tarifimit për Zonën C me 7 rrugë për tarifim.	Realizuar Administrimi I 41 rrugë zona A , 19 rrugë Zona B dhe 7 rrugë Zona C.	31.12.2020
3.	Shtimi i blloqeve te reja te përcaktuara për shërbimin e parkimit "Vetëm për Rezident"	Realizuar pajisja me sinjalistike për 25 blloqe për zona të dedikuara "Vetëm për Rezident"	31.12.2020
4.	Bashkëpunim me Drejtorinë e Transportit dhe Trafikut Rrugor për liçensimet e reja. Njoftim i vazhdueshëm i subjekteve Taxi Persona Fizik/Juridik	Realizuar	31.12.2020
5.	Hapja dhe administrimi i shesh parkimit Nëntokësore pranë stadiumit "Qemal Stafa"	Realizuar administrimi I vendparkimeve ne shesh parkimin nëntokësore ne muajin TETOR 2020	31.12.2020
6.	Ndjekja e procedurës se Parkimit te rezervuar	Realizuar	31.12.2020
7.	Kontrolle ne terren për Sinjalistiken	Realizuar	31.12.2020
8.	Mirëmbajtja e Sinjalistikës Horizontale	Realizuar	31.12.2020

Lidhur me vendosjen e tarifave të parkimit, grupi i auditimit kërkoi informacion nëse ka patur një analizë të kryer nga Bashkia Tiranë përpara se të vendoseshin ato<sup>24</sup>, apo nëse e pasqyron ajo që tarifohet vlerën reale të shërbimit të parkimit?<sup>25</sup>.

Nga auditimi i kryer rezulton se, tarifa e parkimit është një tarifë e konfirmuar në të njëjtat nivele me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 3 datë 05.02.2007 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës, (i ndryshuar), që ka qenë në vazhden e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 3 datë 03.03.2003 “Mbi Caktimin e Vend parkimeve Publike me Pagesë në Qytetin e Tiranës”

Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 49 datë 11.11.2015 “Për Miratimin e Kritereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara Për Parkim, si dhe Tarifave të Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës” ka bërë miratimin aktual i cili në tërësinë e vet në ankesin numër tre të tij ruan të njëjtat nivele tarifimi, duke bërë rregullimet sipas fashave orare përkatëse. Niveli i tarifës së parkimit ka ruajtur një nivel të caktuar ndër vite dhe nuk disponojmë analiza për ndryshimin e tij.

pika c) Tarifa e Parkimit te Automjeteve<sup>26</sup>

3. Autoveturat -Shtetërore dhe private

Zona A 100 lekë/orë

<sup>24</sup>Email zyrtar dt 09.03.2021 DPP

<sup>25</sup>Email zyrtar dt 19.03.3021 TP

<sup>26</sup>VKB nr.3, datë 5.2.2007 “ Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e tiranës”

Zona B 40 lekë/orë

Zona C 20 lekë/orë

Për subjektet që kërkojnë parkim të rezervuar pranë institucioneve të tyre publike ose private tarifa përlllogaritet duke shumëzuar vlerën sipas zonës së parkimit me koeficientin 0.7 për rezervim 12 mujor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së parkimit të automjeteve për parkimin e rezervuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës, e cila llogarit detyrimin dhe ndjek pagesat e tarifës së parkimit, pasi subjekti ka marrë lejen përkatëse nga Drejtoria e Transportit në Bashkinë e Tiranës. Agjent i ngarkuar për mbledhjen e tarifës së parkimit të automjeteve për raste të tjera (parkim, orar ditor/jo i rezervuar) është Njësia Bashkiake përkatëse e cila përfiton 10 % të shumës së arkëtuar.

Në relacionin shoqërues “ *Për miratimin e përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga BT*” specifikohet se: “*Mbasi është bërë analiza e situatës, vlerësimi i nevojave dhe mundësitë për organizimin e parkimit, propozohen shqyrtimi dhe miratimi i:*

- *Kritereve për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit (ZAP) dhe;*
- *Kritereve për detajimin e ZAP dhe përcaktimin e nënzonave të destinuara për parkim (NDP); si dhe*
- *Tarifat që do të aplikohen kundrejt ofrimit të shërbimit të parkimit publik me pagesë.”*

Nga auditimi u konstatua se, këto tarifa janë inkorporuar sikundër specifikohen në VKB nr.3 datë 05.02.2007, por pa kryer një studim apo përshtatje me referencat e tregut apo një konsultim me publikun e gjerë si pagues i kësaj tarife. Po ashtu nga auditimi konstatohet se, në pjesën “*Tarifat e shërbimit të parkimit*” paragrafi i fundit specifikon se: *Duke konsideruar zhvillimin social ekonomik të njësisë/ve administrative ku eventualisht do të shtrihet shërbimi dhe kërkesë/ofertës në treg, parashikohet mundësia të ndryshohen tarifat në kufijtë-/+ 30% të tarifës bazë.”*

Në përgjigje të pyetësorëve, lidhur me përqindjen variabël të tarifës së parashikuar, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion ndonjë analizë kosto përfitim për vendosjen e kësaj përqindje.

**Gjetje nr. 1:** Nga dokumenti strategjik, si dhe nga komunikimet me Agjencinë Tirana Parking dhe Drejtoritë e tjera si ajo e Transportit dhe Urbanistikës nuk del qartazi se cila është përgjegjësia specifike e strukturave për aktivitetet e lidhura me objektivin specifik “*Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës*”. Nga analizimi i planeve vjetore të Tirana Parking rezulton se, janë realizuar 4 nga 5 aktivitete gjithsej të parashikuara në planin strategjik për t’u zhvilluar për periudhën 2018-2021. Konkretisht në planin vjetor 2018 të Tirana Parking është realizuar 1 aktivitet dhe në planet vjetor 2019 dhe 2020 të kësaj agjencie rezulton se janë reflektuar 3 aktivitete. Për aktivitetin i cili nuk është realizuar gjatë periudhës nën auditimi nuk është e qartë se cila është struktura përgjegjëse.

#### **Konkluzion:**

Mos përcaktimi i strukturave përgjegjëse në Strategjinë për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranës, ka sjellë mos reflektimin e njërës prej projekteve strategjike në planet vjetore të TP për periudhën 2018-2020, duke lënë të paqartë njësinë përgjegjëse për realizimin e tij.

**Rekomandim nr. 1.1:** Kryetari i Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak të marrin masat e nevojshme që për të gjitha aktivitetet e parashikuar për përmirësimin e situatës së

parkimeve në qytetin e Tiranës, në dokumentin strategjik të Bashkisë, të përcaktohen në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse dhe detyrat specifike të secilës prej tyre.

## **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Gjetje nr. 2:** Në nenin 32, të kreut VI, të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, përcaktohet se: “1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik të zhvillimit të njësisë përkatëse, i cili miratohet me vendim nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në Udhëzimin nr. 21, datë. 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, përcaktohet se me qëllim planifikimin strategjik dhe kontrollin e tij në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, menaxhimi duhet të kryet sipas objektivave SMART<sup>27</sup>. Në këtë pikë paraqitet edhe formati se çfarë duhet të përmbajë një strategji institucionale. Nga krahasimi i parashikimeve të këtij Udhëzimi me planifikimin strategjik të menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

-Nga analizimi i SZHQ 2018-2022 rezulton se, megjithëse është një dokument strategjik, pra afatgjatë, asnjë nga aktivitetet strategjike të vendosura nuk ka të përcaktuar afatin për t’u arritur në vitet në të cilat shtrihet strategjia. Pra nuk është e qartë se ç’pjesë e aktivitetit do të kryhet në çdo vit të strategjisë.

-Në Planin strategjik nuk parashikohen përlogaritje dhe shpërndarje efektive e burimeve financiare si dhe nuk është parashikuar kostimi vit pas viti për aktivitetet.

-Për asnjërin prej aktiviteteve dhe treguesve të performancës të parashikuar në SZHQ 2018-2022 nuk janë përcaktuar rezultate të synuar apo targeta për t’u arritur vit pas viti.

-Nga analiza e të dhënave përgjatë procesit të auditimit, nuk del i qartë informacioni mbi mënyrën e matjes së treguesve të performancës të përcaktuar në planin strategjik.

-Nga analizimi i përgjigjeve të marra prej DPSJP përgjatë pyetësorëve zyrtar, nuk rezulton të jenë kryer analiza apo vlerësime lidhur me rëndësinë dhe përshtshmërinë e indikatorëve të performancës (të përcaktuar për të monitoruar progresin në drejtim të objektivit specifik të strategjisë lidhur me parkimet), apo mundësinë praktike për t’i matur këto tregues.

### ***Konkluzione:***

Mos parashikimi i burimit të financimit, dhe mungesa e kostimit të aktiviteteve dhe projekteve vit pas viti në të cilin shtrihet strategjia, përmban riskun e moszbatimit të tyre, çka do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivit strategjik.

Mos përcaktimi i rezultateve të synuar për asnjë prej aktiviteteve/treguesve të performancës të parashikuar në Strategji nuk krijon mundësinë për të krahasuar (banchmarking) rezultatet e arritura nga implementimi i aktiviteteve me rezultatet e pritshme, çka e bën të pamundur vlerësimin nëse aktivitetet janë përmbushur apo jo. Mungesa e rezultateve të pritshme të matshme (targetave), pas implementimit të 5 projekteve të parashikuara për rritjen e kapacitetit të parkimit në qytetin e Tiranës, nuk siguron rezultate solide mbi të cilat mund të mbështetet monitorimi i vazhdueshëm dhe ndërmarrja në kohë e masave korrigjuese nga strukturat drejtuese.

---

<sup>27</sup> S – Specifik (objektiva të qartë, përgjegjësi të qarta); M – I matshëm (mund të matet me shifra); A – I arritshëm (masat e marra ndikojnë në arritjen e qëllimit); R – Relevant (objektivi nuk është as shumë i lartë dhe as shumë i ulët); T – Me afat (ka një kohë të caktuar për arritjen e objektivit).

**Rekomandim nr. 2.1:** Kryetari i Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, mbështeten në analiza, të ndërmarrë masat e nevojshme që për çdo aktivitet të parashikuar për përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Tiranës, në dokumentin strategjik të Bashkisë të përfshihen sa më poshtë:

- kosto e çdo aktiviteti për çdo vit që shtrihet strategjia, si dhe burimi i financimit;
- afati kohorë për përmbushjen e secilit aktivitet;
- indikatorët SMART të performancës;
- targetat e synuara për të arritur për çdo vit.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Gjetje nr. 3:** Nga auditimi i kryer, për periudhën objekt auditimi, nga dokumentet dhe informacionet e vendosura në dispozicion nuk rezulton të ketë gjurmë të kryerjes së analizave për përcaktimin e targetave operacional në Tirana Parking. Sikundër, asnjë gjurmë mbi mënyrën se si është operuar për hartimin e planeve vjetore, grupit të punës së ngritur, minutave të analizave etj.

**Konkluzion:** Targetat operacionalë të vendosur për vitet 2018-2022 nga TP, janë të hartuar pa patur një analizë institucionale paraprake duke mos siguruar kështu rëndësinë<sup>28</sup> e tyre për të matur arritjen e objektivave operacionale në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik mbi menaxhimin e parkimeve në qytetin e Tiranës.

**Rekomandim nr. 3.1:** Agjencia Tirana Parking në hartimin e planeve vjetore, duhet të marrë masat e nevojshme që targetat e përcaktuar për çdo aktivitet lidhur me parkimet, të jenë të mbështetura në analiza për të siguruar se arritja e tyre do t'i shërbej arritjes së objektivit strategjik.

**Në vijimësi**

**Gjetje nr. 4:** Nga auditimi u konstatua se, tarifat e shërbimit të parkimit me pagesë dhe përcaktimin e përqindjes variabël të tarifës së parashikuar (-/+ 30% të tarifës bazë), nuk janë mbështetur në studime apo analiza.

**Konkluzion:** Në mungesë të analizave argumentuese, tarifa e vendosur përbën riskun që nuk pasqyron vlerën reale për shërbimin e marrë nga qytetarët.

**Rekomandim nr. 4.1:** Bashkia e Tiranës të marrë masat për rishikimin e vlerës së tarifave të parkimit me pagesë duke i mbështetur ato në analiza dhe studime, të cilat argumentojnë vendosjen e tyre në përputhje me shërbimin e ofruar.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

➤ **Bashkia Korçë**

Në zbatim të Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 32, me vendim nr. 9, datë 25.01.2017, më vendim të këshillit bashkiak është miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë.

---

<sup>28</sup> Rëndësia është një nga komponentët e objektivave SMART (trajtuar më lartë, në mënyrë të detajuar)

Në këtë dokument, janë përcaktuar objektivat strategjik të Bashkisë Korçë, në mbështetjet të 5 dimensioneve të zhvillimit të kësaj bashkie. Nga analizimi i dimensioneve strategjike dhe objektiveve strategjike, programeve dhe projekteve të veprimit në funksion të tyre për zhvillimin e Bashkisë Korçë rezulton se, nuk janë parashikuar aktivitete për menaxhimin e parkimeve në qytetin e Korçës. Në këtë dokument strategjik janë planifikuar edhe projekte teste, në të cilat janë parashikuar edhe veprime lidhur me parkimet. *“Projektet test janë propozuar me qëllim që të testojnë veçori të caktuara të zhvillimit nga prioritetet e Bashkisë. Zhvillimi i tyre pritet të promovojë mënyrën e re të drejtimeve prioritete që do të marri bashkia, si nga pikëpamja e investimit ashtu edhe nga pikëpamja e funksionalitetit”*<sup>29</sup> Kryerja e veprimeve lidhur me parkimet, është parashikuar në tre projekte test në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, si më poshtë:

1. Vende të reja parkimi në zonën e Fabrikës së Birrës *“Në mënyrën e re të organizimit, shumë hapësira parkimi do të transformohen, zhvendosen dhe e sistemohen për t’i lënë vend më shumë hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve njerëzore, pa ndërprerë veprimtarinë e përhershme për mirëfunksionimin e fabrikës së birrës. Synimi i këtij projekti konsiston në rikonceptimin e sipërfaqes (një funksionale) të parkimit jashtë zonës në pronësi të “Birra Korçës”. Ky plan propozon realizimin e vend parkimeve të reja anës rrugëve të cilët do të ndahen me anë të një brezi gjelbërimi në grupe me përmasa 10 m me 1.25 m për 4 makina.”*<sup>30</sup>
2. Vende të reja parkimi në sheshin e Voskopojës *“Nga ana e kundërt e Dhomës do të vendoset një hapësirë e re komplekse që do të shërbejë për hapësira ekspozite, rekreative dhe vrojtimi të peizazhit nga sheshi qendror. Hapësira përreth do të rregullohet gjithashtu me 7 vend-parkime të cilat do të vijëzohen në tokë duke përdorur teksturën ekzistuese të shtrimit të sheshit.”*<sup>31</sup>
3. Rregullorja e klasifikimit të rrugëve *“Rregullore e Klasifikimit Rrugëve Urbane do të realizohet pasi problemet e rregullimit të trafikut dhe të parkimit në qytetin Korçës kanë nevojë për një Rregullore të Klasifikimit të Rrugëve Urbane në Qytetin e Korçës”*<sup>32</sup>

Lidhur me dy projektet e para, të përshkruara më lartë, rezulton se nuk ka një informacion të detajuar si do të zhvillohen këto projekte, periudhën kohore në të cilën do të shtrihen dhe rezultatet e pritura.

Ndërsa lidhur me projektin e tretë, *“Rregullorja e klasifikimit të rrugëve”*, në dokumentin strategjik të Bashkisë paraqitet informacioni si më poshtë<sup>33</sup>:

- *“Qëllimi i këtij projekti është klasifikimi i rrjetit rrugor urban, i karakteristikave gjeometrike, funksionin dhe prioritetet e rrjetit rrugorë, në përputhje me prioritet funksionale, administrative dhe organizative, të përcaktuara sipas Kodit rrugorë të Shqipërisë”;*

- *“Ky projekt do të përgatitet nga konsulenti dhe do të plotësohet në vijim nga stafi i Bashkisë Korçë..”;*

- *“Projekti do të shtrihet në kohë dhe kosto e projektit do të jetë 300,000 euro”.*

- *Projekti do të sigurojë: Inventarin e rrjetit rrugor të Korçës, Klasifikimin dhe përcaktimin funksional të çdo rruge, Manualin e parë të rrugëve urbane të qytetit të Korçës.”*

---

<sup>29</sup> Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, 2017, fq. 261.

<sup>30</sup> Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, 2017, fq. 261.

<sup>31</sup> Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, 2017, fq. 262.

<sup>32</sup> Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, 2017, fq. 271.

<sup>33</sup> Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, 2017, fq. 271.

-Mbështetur në praktikat e mira, me qëllim identifikimin e hapave të ndërmarra nga Bashkia Korçë për menaxhimin e qëndrueshëm të parkimit në qytet, nëpërmjet pyetësorit të dërguar nëpërmjet adresës zyrtare të e-mailit më datë 08.03.2021, grupi i auditimit ka përcjellë pyetjet e mëposhtme:

*“A keni zhvilluar studime lidhur me parkingjet në qytetin tuaj, për të identifikuar:*

- *Kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit në vend parkim të automjeteve,*
- *Cilat janë target grupet në qytet për të cilin ofrohen hapësirat e parkimit në qytet dhe ku dhe për kë ofrohet parkimi me cilësi të lartë,*
- *Sa duhet të kushtoj parkimi,*
- *Sa të ardhura mund të mbledhë Bashkia duke menaxhuar parkingjet (me skenar të ndryshëm),*
- *Mënyrën më efektive, eficiente dhe ekonomike për menaxhimin e parkingjeve, etj”<sup>34</sup>*

Në përgjigje të kësaj pyetje, nëpërmjet e-mailit të dërguar më datë 30.03.2021, nuk ka patur përgjigje të detajuar nga subjekti nën auditim. Nëpërmjet këtij e-maili, subjekti është shprehur se studimi i fundit i kryer lidhur me menaxhimin e parkimit në qytet është studimi i fizibilitetit i vitit 2013. *“Bashkia Korçë në bashkëpunim me AZHR (Agjencinë Rajonale të Zhvillimit Korçë) ka realizuar një studim fizibiliteti në vitin 2013, ku është përcaktuar strategjia e veprimit, objektivat dhe mënyra e menaxhimit të parkimeve në qytet. Mbi këtë studim është bazuar menaxhimi aktual i parkimeve me pagesë në qytet”<sup>35</sup>*. Pra, edhe pse, në vitin 2019 sistemi i menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës ka ndryshuar, pasi për periudhën qershor 2014-qershor 2019 (trajtuar më gjerësisht në vijim) ai është menaxhuar nga koncesionari, dhe pas në shtator 2019 është marrë në menaxhim nga Bashkia Korçë, studimi i fundit i kryer mbi parkimet në këtë qytet është i 6 viteve më parë, duke mos pasur kështu një studim koherent për situatën aktuale të parkimeve në qytet.

-Me vendimin nr. 160, datë 25.11.2019, të Këshillit Bashkiak është miratuar projekti për rezidentët në qytetin e Korçës. Me këtë vendim janë miratuar 4 zona të parkimit të rezidentëve, Blloku “Rinia”, Blloku “8 Nëntori”, Rruga “Niko Dodona” dhe zona “Banka”. Kostoja vjetore për rezidentët është 1200 lekë/vit. Nga auditimi, nuk rezulton të jenë dokumentuar analizat e kryera për ndërmarrjen e këtij projekti, më saktësisht përcaktimin e zonave dhe tarifës së parkimit për rezidentë.

-Referuar praktikave të mira, mbledhja, përdorimi dhe analizimi i të dhënave lidhur me parkimet i ofron bërësit të politikave informacion objektiv, i cili ndihmon në vendimmarrje efektive.<sup>36</sup> Me anë të pyetësorit të datë 18.03.2021, dërguar nëpërmjet e-mailit zyrtarë, grupi i auditimit ka drejtuar pyetjen e mëposhtme për Bashkinë Korçë: *“A ka Bashkia një sistem për të mbledhur dhe përditësuar të dhëna lidhur me parkingjet të cilat mund t’i përdor për hartimin apo përditësimin e politikave të parkingut, p.sh. të dhëna për ofertën dhe kërkesën për parking?”<sup>37</sup>* Nëpërmjet e-mailit të datës 30.03.2021, Bashkia Korçë ka përcjellë përgjigjen e saj, e cila nuk ishte drejtpërdrejtë e lidhur me pyetjen e drejtuar nga grupi i auditimit. *“Aktualisht, nuk kemi studiuar apo analizuar zona të tjera për shtrirjen e parkimit me pagesë, por e mendojmë si mundësi për të analizuar dhe zona të tjera, në funksion edhe të lëvizjes së shtuar nga rritja e turizmit në qytet.*

<sup>34</sup> Pyetësori i dërguar nga grupi i auditimit nëpërmjet adresës zyrtare, datë 18.03.2021, pyetja 4.

<sup>35</sup> Përgjigja zyrtare e Bashkisë Korçë, e-maili i datës 30.03.2021, pyetja 1 e pyetësorit të grupit të auditimit i datës 18.03.2021.

<sup>36</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane”, Eltis, qershor 2019, fq. 15.

<sup>37</sup> Pyetësori i dërguar nga grupi i auditimit nëpërmjet adresës zyrtare, datë 18.03.2021, pyetja 5.

*Megjithëse vërejmë se që prej muajit Mars 2020 ka një rënie të realizimeve krahasuar me periudhën e mëparshme si rrjedhojë e pandemisë Covid-19.*”<sup>38</sup>

-Mbështetur në praktikën e mira, të cilat rekomandojnë konsultimin e publikut në hartimin e politikave për menaxhimin e parkimeve në qytet, grupi i auditimit nëpërmjet pyetësorëve zyrtar i ka drejtuar subjektin nën auditim pyetjen e mëposhtme: *“A keni zhvilluar konsultime, takime, fokus grupe, pyetësor, etj. me grupet e interesit me qëllim menaxhimin efektiv dhe eficient të parkingjeve, si p.sh. me rezidentë, vizitor, bizneset, individë me aftësi të kufizuara? Lutem, vini në dispozicion dokumentet mbështetës dhe përfundimet e takimeve*”<sup>39</sup> Në përgjigje të kësaj pyetjeje subjekti ka përcjellë përgjigjen: *“Gjatë funksionimit të parkimeve për rezidentë, nuk jemi hasur me problematika apo kundërshtime të qytetarëve dhe si rrjedhojë nuk ka lindur nevoja e takimeve apo pyetësorëve me grupet e interesit. Gjatë procedurës së buxhetimit me pjesëmarrje, e cila organizohet dhe drejtohet nga Kryetari i Bashkisë Korçë çdo vit, në takim me grupet e interesit biznes dhe banorë, ka rezultuar kërkesa e banorëve për tre zona parkim rezidenti, duke diskutuar dhe vlerën e tarifës vjetore*”<sup>40</sup>. Pra, Bashkia Korçë ka pohuar se për projektin e rezidentëve nuk është konsultuar opinion i publikut, ndërsa për takimet e zhvilluara për buxhetimin, nuk janë vënë në dispozicion dokumentet justifikuese të cilat vërtetojnë konsultimin e publikut lidhur me këtë çështje. Gjithashtu grupi i auditimit ka kryer intervista<sup>41</sup> me biznese dhe qytetarë (duke aplikuar qasjen e përzgjedhjes rastësore) në zonat e parkimit me pagesë dhe në zonat e parkimit me rezidentët në qytetin e Korçës, ku ndër të tjera ka kërkuar të identifikojë nëse ata janë konsultuar lidhur me politikën e parkimit në qytet. Në 30 intervista të realizuar, në çdo rast përgjigja ishte që nuk janë konsultuar ndonjëherë nga Bashkia Korçë lidhur me problematikat e parkimit në qytet.

- Referuar nenit 7, pika IV, të Ligjit Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit, e cila përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: të çdo dokumenti politikash”* rezultoi se, Bashkia Korçë nuk ka ngarkuar në faqen e saj zyrtare dokumentin strategjik të Bashkisë.

- Nga auditimi rezultoi se, me kalimin e menaxhimit të parkimeve nga koncensionari tek Bashkia Korçë (shtator 2019), rregullorja e kësaj bashkie nuk ishte përditësuar me funksionin dhe detyrat e strukturës së re të krijuar në bashki për menaxhimin e parkimeve. Rregullorja e re, e cila përfshinë në të edhe funksionin e parkimeve është përditësuar dhe miratuar gjatë kryerjes së auditimit në këtë bashki, më datë 01.03.2021, me Vendimin nr. 142, datë 01.03.2021, në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për vënien në dispozicionin të rregullores së Bashkisë.

- Nga analizimi i strukturave të miratuara të Bashkisë Korçë, ka rezultuar se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, strukturë kjo me një rol kyç në zhvillimin e politikave të parkimeve, funksionon me 10 punonjës nga 15 punonjës të nevojshëm sipas strukturës së miratuar.

- Nga analizimi i të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve për menaxhimin e parkimeve në Bashkinë Korçë ka rezultuar se gjatë periudhës 2018-2020, sikurse është trajtuar edhe në

<sup>38</sup> Përgjigja zyrtare e Bashkisë Korçë, e-maili i datës 30.03.2021, pyetja 5 e pyetësorit të grupit të auditimit i datës 18.03.2021.

<sup>39</sup> Pyetësori i dërguar nga grupi i auditimit nëpërmjet adresës zyrtare, datë 18.03.2021, pyetja 7.

<sup>40</sup> Përgjigja zyrtare e Bashkisë Korçë, e-maili i datës 30.03.2021, për pyetjen 7 të pyetësorit të datës 18.03.2021

<sup>41</sup> Akti i kostatimit i mbajtur midis grupit të auditimit dhe përfaqësuesve të Bashkisë Korçë, pas vizitës në terren 06.05.2021.

kapitullin “Pesha në Buxhet” të këtij auditimi, rezulton se të ardhurat neto të Bashkisë Korçë, nga menaxhimi i parkimeve kanë pësuar rënie vit pas viti, me një diferencë të lartë në vitin 2020, (68% më pak të ardhura, krahasuar me vitin 2018) si rezultat i gjendjes së krijuar nga Covid-19. Për periudhën nën auditim konstatohet se, kostot kryesore të Bashkisë lidhur me parkingjet kanë qenë për pagat dhe sigurime e punonjësve dhe blerjen e biletave të parkimit. Gjatë kësaj periudhe, nuk rezulton të jenë kryer investime me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të parkimeve në këtë qytet.

Nga auditimi i dokumentit më të lartë strategjik të Bashkisë Korçë, me fokus menaxhimin e parkimeve në qytet, rezultate paraqiten si më poshtë:

**Gjetje nr. 5:** Në dokumentin Strategjik të Bashkisë Korçë miratuar në vitin 2017, nuk është mirë përcaktuar vizioni i Bashkisë lidhur me perspektivën e parkimeve në këtë qytet si dhe nuk janë parashikuar aktivitete të mirëfillta për menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, si pjesë e objektivave dhe dimensioneve strategjike, në funksion të arritjes së vizionit holistik të bashkisë. Në këtë dokument janë parashikuar vetëm 3 projekte test, të cilat priteshin të kishin ndikim në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytet. Gjatë periudhës nën auditim 2018-2020, nuk rezulton të jenë kryer investime me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të parkimeve në këtë qytet. Shpenzimet e bashkisë për zhvillimin e parkimeve në qytet për periudhën shtator 2019- dhjetor 2020 (më përpara është administruar nga koncesionari) kanë qenë për paga/sigurime të punonjësve dhe blerjen e biletave të parkimit.

**Konkluzion:** Ndryshe nga sa praktikat e mira sugjerojnë, në dokumentin më të lartë strategjik të Bashkisë Korçë, nuk është mirë përcaktuar vizioni i Bashkisë lidhur me perspektivën e parkimeve në këtë qytet, si dhe nuk janë planifikuar aktivitete të mirëfillta për menaxhimin e parkimeve, çka përmban riskun se nuk janë siguruar të gjitha përfitimet që rrjedhin prej tij, si p.sh. përmirësimi i lëvizshmërisë urbane, mbështetje më e madhe për ekonominë lokale, siguri e rritur rrugore, cilësi më e mirë e ajrit, etj.

**Rekomandim nr. 5.1:** Titullari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, të ndërmarrin masat e nevojshme për të zbatuar një qasje strategjike në menaxhimin e parkimeve, duke mirë përcaktuar në dokumentin strategjik të bashkisë vizionin dhe aktivitete e nevojshme për menaxhimin e parkimeve, në funksion të arritjes së vizionit holistik për zhvillimin e qytetit të Korçës.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Gjetje nr. 6:** Nga auditimi rezultuan mangësi në planifikimin strategjik të menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës, paraqitur si më poshtë:

-Për aktivitetet e parkimit të parashikuara në të tre projektet test, të cilat priteshin të promovonin mënyrën e re të drejtimeve prioritete që do të merrte bashkia Korçë, nuk është parashikuar periudha kohore në të cilën ato do të shtriheshin.

-Për dy nga tre projektet test në të cilat janë parashikuar veprime lidhur me parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë nuk është bërë kostimi total i secilit projekt. Për të tre projektet, nuk është bërë as kostimi për çdo vit në të cilin do të shtrihet çdo projekt.

-Për të tre projektet test, në dokumentin strategjik të bashkisë, nuk është parashikuar apo deklaruar burimi i financimit të tyre.

-Për dy nga tre projektet test në të cilat ishin parashikuar veprime lidhur me menaxhimin e parkimeve në Bashkinë e Korçës, nuk janë ndarë qartësi detyrat e strukturave përgjegjëse në bashki për realizimin e këtyre projekte, apo të aktorëve të tjerë të përfshirë në to.

-Për të tre projektet test në të cilat janë parashikuar veprime lidhur me parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, nuk janë parashikuar indikatorët e performancës si dhe nuk janë parashikuar rezultatet e pritura për çdo vit në të cilin do të shtrihet secili prej projekteve.

**Konkluzion:** Projektet test, të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, prej zbatimit të të cilëve pritej të përmirësoj situatën e parkimeve në këtë qytet, vuajnë nga një planifikim i dobët, pasi nuk është parashikuar periudha kohe në të cilën secili prej tyre do të shtrihet, nuk është bërë kostimi total dhe rrjedhimisht as ai i përvitshëm, nuk janë përcaktuar qartë detyrat e secilit aktorë të përfshirë në proces, nuk është parashikuar burimi i financimit, indikatorët e performancës dhe targetat e pritshëm. Kjo situatë nuk siguron zbatimin efektiv, eficient dhe ekonomik të këtyre projekteve, duke rrisur arritjen e rezultateve të pritshëm në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Korçës nga implementimi i tyre.

**Rekomandim nr. 6.1:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Korçë, në cilësinë e hartuesit të dokumentit strategjik të kësaj bashkie, mbështetur në analiza dhe studime, të ndërmarrë masat e nevojshme që të siguroj që për çdo aktivitet dhe projektet të parashikuara për menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, të përmbushen sa më poshtë dhe në vijim të përfshihen në dokumentin strategjik të Bashkisë:

- të jetë qartësisht e përcaktuar periudhën në të cilën do të realizohet secili prej projekteve;
- projektet të jenë të kostuar për çdo vit në të cilin do të shtrihen, dhe në total;
- financimi i tyre të jetë i siguar dhe të deklarohet burimi i financimit;
- të ketë një ndarje të qartë të detyrave të secilit prej aktorëve të përfshirë në proces;
- të përcaktohen indikatorët e performancës, targetat e pritshëm vit pas viti dhe rezultati në fund.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Gjetje nr. 7:** Referuar praktikave të mira, mbledhja, përdorimi dhe analizimi i të dhënave lidhur me parkimet i ofron bërësit të politikave informacion objektiv, i cili ndihmon në vendimmarrje efektive.<sup>42</sup> Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Korçë nuk ka një sistem të dhënash, si. p.sh. për të identifikuar kërkesën aktuale për vende parkimi, etj. si dhe nuk ka kryer analiza dhe studime që do të ndihmonin për të identifikuar hendeqet në politikat aktuale të menaxhimit të parkimeve, me qëllim vendimmarrjen efektive. Studimi i fundit i kryer mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës është ai i vitit 2013, pra i rreth 8 viteve më parë, dhe pas ndryshimit të mënyrës së menaxhimit në vitin 2019 (kalimi nga koncesionari në menaxhim të Bashkisë Korçë) nuk janë ndërmarrë analiza apo studime të tjera për të identifikuar mangësitë në politikat aktuale, me qëllimin zhvillimin e politikave të qëndrueshme të parkimit për këtë qytet. Pra, çmimet e vendosura për parkimet me pagesë apo projektin e rezidentëve, zonat e parkimit me pagesë ose zonat ku do të aplikohet projekti i rezidentëve, metodat e pagesës së përzgjedhur dhe vetë sistemi i vendosur për menaxhimin e parkimeve, pas marrjes në administrim nga Bashkia Korçë nuk janë mbështetur në studime apo analiza.

<sup>42</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane”, Eltis, qershor 2019, fq. 15.

**Konkluzion:** Për shkak se studimet dhe analizat e fundit të kryera, mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës, janë të rreth 8 viteve më parë, dhe nuk janë përditësuar në vijim, nuk ofrohet siguri nëse vendimet e marra vitet e fundit, si p.sh., ndryshimi i mënyrës së menaxhimit, reduktimi i vend parkimeve, tarifafat e parkimit me pagesë, modaliteti i pagesës, projekti i rezidentëve, tarifafat e këtij të fundit, janë efektive, efecientë dhe ekonomike në drejtim të përmirësimit të situatës së parkimeve në qytet.

**Rekomandim nr. 7.1:** Bashkia Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të ngritur dhe përditësuar një sistem të dhënash dhe/apo të kryejë analiza dhe studime lidhur me situatën e parkimeve në qytet, me qëllim identifikimin e hendeqeve në politikat aktuale dhe ndërmarrjen e vendimeve efektive.

### **Brenda 6-mujorit të dytë 2021 dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 8:** Nga konsultimi i praktikave të mira (trajtuar gjerësisht në raportin e këtij auditimi), rezulton se opinionin e publikut ka një rëndësi të veçantë në menaxhimin efektiv të parkimeve në qytet. Referuar përgjigjeve zyrtare të Bashkisë Korçë, si dhe përgjigjeve të intervistave të zhvilluara nga grupi i auditimit me biznese dhe qytetarë në zonat e parkimit me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët në qytetin e Korçës rezulton se, nuk është marrë mendimi i publikut dhe nuk janë konsultuar me publikun.

**Konkluzion:** Mos konsultimi i vazhduar i opinionit publik lidhur me çështjet e parkimeve në qytetin e Korçës ka shkakuar që mos të identifikohet dhe mos të ndërmerren masat e nevojshme për adresimin e problematikave më të cilët qytetarët hasen në përditshmërinë e tyre lidhur me parkimet, si dhe përmban riskun e rezistencës nga ana e qytetarëve për të zbatuar vendimet e marra, pa u konsultuar fillimisht edhe mendimi i tyre.

**Rekomandim nr. 8.1:** Titullari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak të ndërmarrin masat e nevojshme që të konsultojnë opinionin e publikut në mënyrë periodike lidhur me problematikën dhe përmirësimin e mëtejshëm të parkimit në qytetin e Korçës, dhe ta dokumentojnë atë, veçanërisht përpara ndërmarrjes së vendimeve në lidhje me menaxhimin e parkimeve në qytetin e Korçës.

### **Në vijimësi**

**Gjetje nr. 9:** Në nenin 7, pika IV, të Ligjit Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit, përcaktohet se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: të çdo dokumenti politikash”*. Nga analizimi i faqes web të Bashkisë Korçë rezulton se në këtë faqe nuk është ngarkuar dokumenti më i fundi strategjik i Bashkisë. Në këtë faqe, gjendet një dokument me titullin Strategjia për Zhvillim e Bashkisë Korçë, i cili nuk është i miratuar dhe përmbajtja e tij nuk përkon me Strategjinë e miratuar të Bashkisë Korçë.

**Konkluzion:** Mospublikimi në faqen web të institucionit, i dokumentit më të lartë strategjik të Bashkisë Korçë nuk siguron transparencë për publikun dhe palët e interesit mbi politikat, prioritet, apo aktivitetet e ndërmarrja në përgjithësi nga kjo bashkë, dhe në veçanti për ato të lidhur me parkimet.

**Rekomandim nr. 9.1:** Bashkia Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të publikuar në faqen web të saj, dokumentet e politikave të kësaj bashkie, me qëllim sigurimin e transparencës me publikun dhe palët e interesit.

**Brenda vitit 2021**

**Gjetje nr. 10:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, strukturë me një rol kyç në zhvillimin e politikave të parkimit në Bashkinë Korçë, ka funksionuar me një staf të reduktuar për të gjithë periudhën nën auditim. Nga 15 punonjës të nevojshëm referuar strukturës së miratuar, kjo drejtori ka funksionuar me 10 punonjës. Më hollësisht, në Sektorin e Planifikimit mungojnë përgjegjësi i sektorit dhe një specialist projektues, në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit mungojnë dy specialiste, ndërsa në Sektorin e Administrimit e Regjistrimit të Territorit mungon një specialist. Ndryshimet në strukturën e menaxhimit të parkimeve që ndodhën në shtator të vitit 2019<sup>43</sup>, nuk ishte të reflektuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Korçë deri në mars të vitit 2021.

**Konkluzion:** Funksionimi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkisë Korçë, me 33% më pak staf se ai i nevojshëm, për të gjithë periudhën nën auditim, ka cenuar cilësinë e planifikimit strategjik të aktiviteve në fushën e parkimeve.

**Rekomandim nr. 10.1:** Titullari i Bashkisë Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të plotësuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit me stafin e nevojshëm sipas strukturës së miratuar, me qëllim shmangien e riskut të cënimit të cilësisë së punës që kjo drejtori kryen.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Rekomandim nr. 10.2:** Bashkia Korçë të marrë masat e nevojshme, që në çdo rast tjetër të ndryshimeve në strukturën e institucionit, të kryhen menjëherë reflektimet e nevojshme në Rregulloren e Brendshme të saj.

**Në vijimësi**

*1.2 A kanë rezultuar aktivitetet e ndërmarrë nga strukturat përgjegjëse, në arritjen e rezultateve të pritshme nga menaxhimi i parkingjeve?*

*1.2.1. A janë zbatuar në mënyrën efiçente aktivitetet dhe projektet e nevojshme për menaxhimin e parkimeve në të qytetin e Tiranës dhe Korçës?*

➤ **Bashkia Tiranë**

Referuar Rregullores së Brendshme të Bashkisë Tiranë, kreu V, neni 42.2 DPSJP, pika 6 *Detyra e kësaj strukture janë:*

Ndjek zbatimin e strategjive, politikave dhe planet e fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi;

Lidhur me parkimet, sikundër është përmendur edhe më lartë, në SZHQ janë vendosur 5 projekte për tu realizuar, si më poshtë vijojnë:

---

<sup>43</sup> Me kalimin e menaxhimit të parkimeve nga koncesionari tek Bashkia Korçë në këtë të fundit u ngrit një strukturë për administrimin e parkimeve në qytetin e Korçës.

1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë, sheshe, mbi dhe nëntokë.

2. Diversifikimi i mënyrave të pagesës së parkimit në sheshe

3. Rritja e hapësirave publike për administrim parkimi me pagesë,

4. Ndërtimi i shesheve të reja mbi tokë

5. Përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të dedikuara “Vetëm për rezident”

Këto vite postet e parkimit me pagesë apo të lira janë zvogëluar në numër, kjo për arsye të politikave të Bashkisë Tiranë, duke i dhënë më shumë hapësirë korsive të biçikletave, apo edhe rasteve të ndërtimit të lulishteve apo zgjerim trotuari.

Konkretisht në vitin 2019 i janë hequr 333 vende parkimi në zonën A si më poshtë vijon:

Nr	Rrugët	Zona	Vende parkimi të hequr/ BLU	Vende parkimi të hequra/ BARDHA	Pjesërisht/ Plotësisht	Motivacioni
1	Zogu I	A	100	33	Plotësisht	Ndryshim destinacioni
2	Hoxha Tahsin	A	51	40	Plotësisht	Korsi biçiklete
3	Tafaj	A	16	13	Plotësisht	Korsi biçiklete
4	4 Dëshmorët	A	30	44	Plotësisht	Korsi biçiklete
	<b>Total</b>	<b>A</b>	<b>203</b>	<b>130</b>		

Në vitin 2020 i janë hequr 310 vende parkimi në zonën A si më poshtë vijon:

Nr	Rrugët	Zona	Vende parkimi të hequr/ BLU	Vende parkimi të hequra/ BARDHA	Vend parkime me rezervim	Pjesërisht/ Plotësisht	Motivacioni
1	Suljeman Delvina	A	29	5	1	Pjesërisht	Zgjerim trotuari
2	Myslym Shyri	A	94	37	8	Plotësisht	Korsi biçikletë
3	Ismail Qemali (Pjesa e Liceut)	A	10	0	9	Plotësisht	Korsi biçikletë
4	Liman Kaba	B	24	10	0	Pjesërisht	Korsi biçikletë
5	Luigj Gurakuqi	A	21	0	1	Pjesërisht	Korsi biçikletë
6	Papa Gjon Pali (pjesa e piramidës)	A	15	2	8	Pjesërisht	Korsi biçikletë
7	Fortuzi	A	4	0	0	Pjesërisht	Korsi biçikletë
8	Sami Frashëri	A	26	6	5	Plotësisht	Lulishte
	<b>Total</b>	<b>A</b>	<b>223</b>	<b>60</b>	<b>27</b>		

Gjithashtu nga auditimi në terren u konstatua se, për vitin 2020-2021 në qytetin e Tiranës për efekt të ndërtimeve të reja janë hequr poste parkimi si më poshtë vijon: “Alb Star” për ndërtim të objektit “Park View Residence” ka kërkuar lirimin e 15 vendeve të parkimit por pa afat, “Arb&Trans 2010” për ndërtim të objektit “Godinë banimit dhe shërbimi” ka marr autorizim për 30 muaj por nuk specifikohet numri i posteve të parkimit, “Star Tek” sh.p.k për rindërtim të Shkollës “Sami Frashëri” specifikon se zë 3 poste parkimi, por nga kontrollet e kryera në terren rezultojë se faktikisht janë hequr 12 poste parkimi dhe është tejkalluar afati 3 mujor, “Palushi” sh.p.k për ndërtim të objektit “ Godinë banimi dhe shërbimi” 5 poste parkimi për 48 muaj.

Sa më sipër, në një qytet ku parkimi në gjendje normale është problem krijimi i këtyre kantierëve rrit edhe më shumë problematikat dhe e bën më të vështirë situatën.

Nga korrespondenca me TP gjatë viteve 2019-2020 u konstatuan bllokime të shpeshta të vendeve të parkimit si rezultat i aktiviteteve sportive dhe ndërtimeve në qytet si më poshtë vijnë:

Viti 2019

Muaji	Problematikat	Data	Ora	Të ardhura të munguara
Janar	Bllokuar per akt. Sportiv 15 vende, <b>gj. B. Shpata Zona A</b>	24.01.2019	10:00-14:00	15 vende*4orë= 60makina potencialisht, 60makina*100lekë/ora= <b>6.000</b>
Shkurt	Bllokuar per akt. Sportiv 5 vende, <b>gj. B. Shpata Zona A</b>	06.02.2019	17:00-20:00	5 vende*3orë= 15makina potencialisht, 15makina*100lekë/ora= <b>1.500</b>
Mars	Bllokuar per akt. Sportiv 33 vende, <b>gj. B. Shpata Zona A</b>	01.03.2019	17:00-20:00	33 vende*3orë= 99makina potencialisht, 99makina*100lekë/ora= 9.900
	Bllokuar per akt. Sportiv 47 vende, <b>gj. B. Shpata Zona A</b>	10.04.2019	14:00-20:00	47 vende*6orë= 282makina potencialisht, 282makina*100lekë/ora= 28.200
	Bllokuar per akt. Sportiv 7 vende, e. Duraku	10.04.2019	14:00-20:00	7 vende*6orë= 42makina potencialisht, 42makina*100lekë/ora= 4.200
	Bllokuar per akt. Sportiv 7 vende, k.parisit	10.04.2019	14:00-20:00	7 vende*6orë= 42makina potencialisht, 42makina*100lekë/ora= 4.200
Qershor	Bllokim 4 vendesh per punime ne terren zhan dark	11.06.2019		
	Bllokim 7 vendesh per punime ne terren p. Gj.pali			
	Bllokim 8 vendesh per punime ne terren m. Matohiti	16.06.2019		
Korrik	Bllokuar per akt. Sportiv 60 vende, gj.b.shpata <b>Zona A</b>	10.07.2019	12:00-19:00	60 vende*7orë= 420makina potencialisht, 420makina*100lekë/ora= 42.000
	Bllokim 13 vendesh per punime ne terren tafaj	11.07.2019		
	Bllokim 4 vendesh per punime ne terren zhan dark	13.07.2019		
	Bllokim 8 vendesh per punime ne terren zhan dark	22.07.2019		
	Bllokim 5vendesh per punime nga eurondertim per a.k.sh	01.02.2019		
	Bllokim 5vendesh per punime nga eurondertim per Kryeministrinë	23.07.2019	3 muaj	
	Bllokuar per akt. Sportiv 30 vende, gj.b.shpata <b>Zona A</b>	25.07.2019		30 vende*11.5orë= 345makina potencialisht, 345makina*100lekë/ora= 34.500
Gusht	Bllokuar per akt. Sportiv 25 vende, gj.b.shpata <b>Zona A</b>	27.08.2019	16:00-20:00	25 vende*4orë= 100makina potencialisht, 100makina*100lekë/ora= 10.000
	Bllokim 7 vendesh per punime ne terren i.qemali nga oshee	22.08.2019		

<b>Shtator</b>	Bllokim 41 vendesh per punime ne terren kavajes	26.09.2019		
<b>Tetor</b>	Bllokim vendesh per punime ne terren asfalti, kavajes	08.10.2019		
	Bllokim 4 vendesh per punime ne terren p. Gj.pali nga ukt	09.10.2019		
	Bllokuar per akt. Sportiv 46 vende, gj.b.shpata,komun,e.duraku <b>Zona A</b>	24.10.2019	15:00-17:30	46 vende*2.5orë= 115makina potencialisht, 115makina*100lekë/ora= 11.500
<b>Dhjetor</b>	Bllokuar 48 vende l. Kaba per koncert bamiresie <b>Zona B</b>	20.12.2019	18:00-20:00	48 vende*2orë= 96makina potencialisht, 96makina*40lekë/ora= 3.840
<b>Total Nga Aktivitetet Sportive</b>				<b>159.140 lekë</b>

101 vende parkimi bllokuar për efekt të punimeve në terren dhe 323 vende për efekt të aktiviteteve sportive ku nuk është paguar asnjë tarifë ndaj TP.

Për vitin 2019 nga auditimi u konstatuan 10 raste të bllokimit të vendeve të parkimit për arsye të zhvillimit të aktiviteteve sportive, 11 raste për arsye të zhvillimit të punimeve në terren dhe 1 rast për arsye të një koncerti bamirësie.


### **Viti 2020**

<b>Muaji</b>	<b>Problematikat vitit 2020</b>	<b>Data</b>	<b>Ora</b>	<b>Të ardhura të munguara</b>
<b>Mars</b>	Bllokuar për akt. Sportiv 10 vende Gj.B.Shpata <b>Zona A</b>	04.03.2020	16:00-19:00	10 vende*3orë= 30makina potencialisht, 30makina*100lekë/ora = <b>3.000</b>
<b>Maj</b>	Bllokim 10 vendesh per punime ne terren Zhan Dark u.k.t	12.05.2020		
	Bllokim 12 vendesh për punime ne terren Kavaja	12.05.2020		
	Bllokim 7 vendesh per punime ne terren B.Curri	20.05.2020		
<b>Korrik</b>	Bllokim vendesh s. Luarasi per punime ne terren ukt	21.07.2020		
	Bllokuar per akt. Sportiv 20 vende, Th.Germenji <b>Zona A</b>	29.07.2020		20 vende*11.5orë= 230makina potencialisht, 330makina*100lekë/ora = <b>23.000</b>
	Bllokuar per akt. Sportiv 28 vende, l.Gurakuqi <b>Zona A</b>	29.07.2020		28 vende*11.5orë= 322makina potencialisht, 322makina*100lekë/or a= <b>32.200</b>
<b>Gusht</b>	Bllokim vendesh s.luarasi / L.Kaba per punime ne terren ukt	23.07.2020 ka ardh shkresa, punimet fillojnë në gusht		

		me afat të papërcaktuar		
<b>Shtator</b>	Bllokim vendesh s.Luarasi per punime ne terren ukt			
	Bllokim 6 vendesh B.Curri per punime ne terren rest. Fasade	19.09.2020	1 muaj (Ne shkresë 4 në terren 6)	
<b>Totali nga Aktivitetet sportive</b>				<b>58.200</b>

Shënim: Në momentin kur janë punime nga UKT dhe nuk ka të specifikuar numrin e posteve të zëna, është i gjithë segmenti rrugor ku po kryhen punimet. Në momentin kur nuk është specifikuar ora e bllokimit të posteve të parkimit është orari zyrtar i funksionimit të tarifimit, dmth 07:30-20:00.

Janë konstatuar problematika lidhur me vendet e parkimit me pagesë apo të lira për shkak të kantierëve të ndërtimit pothuaj kudo në qytet. Konkretisht vetëm gjatë inspektimit në terren u konstatuan : Rruga “Liman Kaba”, aktualisht bllokuar 4 vende parkimi me tarifim; Rr. ”Tefta Tashko Koço” aktualisht bllokuar 4 vende parkimi me tarifim; Rr.”Mihal Duri” aktualisht bllokuar 4 vende parkimi me tarifim; Rr. ”Astrit Balluku” aktualisht bllokuar 10 vende parkimi të lira; Rr. ”Bardhyl” aktualisht bllokuar 4 vende parkimi të lira; Rruga e “Barrikadave” aktualisht bllokuar 12 vende parkimi me tarifim.



*Burimi:* Vizita në terren, grupi i auditimit

Referuar bazës ligjore si më poshtë vijon, neni 2.4, Aneksi 3 i Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 49 datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruar nga Bashkia e Tiranës” specifikon si më poshtë vijon:

3. Tarifat e shërbimit të parkimit mund të paguhet me para në dorë (cash) dhe/ose përmes SMS-ve apo mënyrave alternative të pagesës të mundësuar nëpërmjet telefonisë celulare.
4. Të ngarkoj Tirana Parking për vjeljen e tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës me para në dorë.

Aktualisht, që nga muaji shtator 2018 parkimi në rrugët e Tiranës paguhet vetëm duke dërguar një sms me targën e automjetit dhe zonën e parkimit. Nëse një individ nuk disponon një numër celulari Shqiptar dhe nuk ka kreditit të mjaftueshëm për të realizuar pagesën, kjo sjell në pamundësinë e realizimit të këtij shërbimi, duke bërë që parkimi të kthehet në një shqetësim për qytetarët.

Sa më sipër, nisur edhe nga numri i lartë i ankesave të qytetarëve, nga ana e Tirana Parking është ndërmarr hapi për të diversifikuar mënyrën e pagesës për parkimin. Në shkresën me nr. 1227/4 datë 17.09.2018 drejtuar Bashkisë Tiranë, u kërkua të shtohet mënyra e pagesës me mënyra alternative. Kjo argumentohej me faktin se, shpesh herë ka patur ankesa verbale, ankesa në numrin zyrtar të telefonit të Institucionit TP, në rrjetet sociale dhe në formë elektronike në imailin zyrtar tiranaparking@tirana.al, nga qytetarë të ndryshëm. Me motivacionin se në rrugët, të cilat janë me sistem tarifimi dhe pagesa kryhet vetëm me anë të platformës SMS payment, duhet të ketë një metodë tjetër alternative për kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit, pasi jo të gjithë qytetarët kanë mundësinë e të paturit kredit të mjaftueshëm në telefon për kryerjen e kësaj pagese apo zotërojnë një numër nga operatorët shqiptar, duke hasur në këtë mënyrë vështirësi për kryerjen e pagesës dhe si rezultat shpesh herë janë penalizuar dhe me masa administrative (gjyba) nga organet kompetente. Në lidhje me sa më sipër, nga ana e Tirana Parking është mbajtur korrespondencë me subjektin “Pay & Go” SHPK.

Propozimi sa më sipër i është dërguar Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 1227/4 datë 17.09.2018, por ende nuk është ndërmarr asnjë nisëm për shtimin e metodës së pagesës. Aktualisht, edhe nga metodat e miratuara përdoret vetëm njëra prej tyre. Kjo me arsyetimin e shmangies së pagesave me lekë në dorë.

Referuar marrëveshjes me “Vodafone Albania”, Neni 6 “*Të drejtat dhe detyrimet e palëve*” pika 6.8 e tij specifikon se: “*Vodafone ka të drejtën të ndërpresë përkohësisht ose për një periudhë kohe të arsyeshme e cila gjithsesi nuk tejkalon 48 orë, ofrimin e shërbimit të pagesës së parkimit me SMS për shkak të kërkesave specifike të rrjetit siç mund të jenë:*

- *mirëmbajtja e rrjetit;*
- *Disponueshmëria e shërbimeve;*
- *Siguria e rrjetit;*
- *Përdorimi efektiv i spektrit të frekuencave;*
- *Mbrojtja e të dhënave personale;*
- *Vendimi i Autoritetit të Kompanive Elektronike dhe Postare (AKEP)”*

Nga auditimi i kryer mbi performancën e shërbimit të kompanive telefonike rezultojë se, për vitet 2019 dhe 2020 ka ndodhur bllokim i sistemit të telefonive disa here në mënyrë të përsëritur (më hollësisht konsulto anekset.) Në kontratën e lidhur me operatorët e tjerë, nuk ka asnjë klauzolë të specifikuar lidhur me ndërprerjet e sinjalit dhe menaxhimin e situatës në rast të ndodhjes së një fenomeni të tillë. Në gjykimin e grupit të auditimit, ky fakt duhet të mbahet në konsideratë në rishikimin e kontratave në të ardhmen.

Nga vizita në terren u konstatuan problematika lidhur me sinjalistikën e parkimit në shumicën e zonave të kontrolluara nga ana e grupit të auditimit, konkretisht sinjalistika horizontale dhe vertikale lidhur me parkimin nuk ishte e plotë, nevojitesh ravijëzim i zonave si për parkim me pagesë ashtu edhe për parkimin pa pagesë.



Burimi: Vizita në terren, grupi i auditimit

➤ ***Sa u takon marrëveshjeve me telefonitë celulare***

Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49 datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuar për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës”, pika 2 e nenit 2.4 të Aneksi 3 specifikon si më poshtë vijon:

.... “2.4 Tarifave të shërbimit të parkimit mund të paguhet me para në dorë (cash) dhe/ose përmes SMS-ve apo mënyrave alternative të pagesës të mundësuar nëpërmjet telefonisë celulare.

- Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë për lidhjen e marrëveshjeve me operatorët e telefonisë celulare, të cilët do të ofrojnë infrastrukturën e telefonisë celulare për administrimin e pagesave të shërbimit publik të parkimit dhe vjeljen e tarifës përkatëse.”

Në zbatim të VKB të sipërcituar janë mbajtur marrëveshjet për ofrimin e infrastrukturës së telefonisë celulare mes kompanive “Vodafone Albania” sh.a, “Telekom Albania”, “Plus Communication” dhe “Albtelecom” me Bashkinë Tiranë (Tirana Parking).

Me shkresën nr 7415/1 prot, datë 23.02.2017 është mbajtur marrëveshja me operatorët “Telekom Albania”, “Plus Communication” dhe “Albtelecome”.

Me shkresën nr.7415/2 prot, datë 23.02.2017 është mbajtur marrëveshja me “Vodafone Albania” sh.a . Referuar marrëveshjes me Vodafone Albania,

Neni 8 “Marrëdhëniet financiare mes Palëve” pika 8.1.5 e tij specifikon se...

*8.1.5 Vlera e komisionit që Vodafone Albania përfiton për ofrimin e infrastrukturës së telefonisë celulare për ndërlidhjen dhe administrimin e pagesave të shërbimit publik të parkimit dhe vjeljen e tarifës përkatëse, është 15% e totalit të tarifës së mbledhur prej tyre, TVSH jo e përfshirë.*

Referuar marrëveshjes me operatorët e tjerë,

Neni 7 “Marrëdhëniet financiare mes Palëve”, pika 7.1 “vjelja e tarifës së parkimit dhe komision”, nënpika 7.1.5 dhe 7.1.6 e tij specifikon se...

*7.1.5 Vlera e komisionit që secili Operator përfiton për ofrimin e infrastrukturës së telefonisë celulare, për administrimin e pagesave të shërbimit publik të parkimit dhe vjeljen e tarifës përkatëse, është e barabartë me 11% e totalit të tarifës së mbledhur prej tyre, TVSH jo e përfshirë.*

7.1.6 Vlera e komisionit që Telekom do të përfitoj për ofrimin dhe mirëmbajtjen e Software është e barabartë me 4% të vlerës totale të tarifës së vjelur nga Operatorët.

Nga auditimi mbi zbatimin e projekteve të parashikuara në SZHQBT u konstatua se:

**Gjetje nr. 1:** Nga 5 projekte të parashikuara për menaxhimin e parkimeve në strategjinë për zhvillimin e qytetit të Tiranës, 1 prej tyre nuk është zbatuar deri më 6 mujorin e parë të vitit 2021, duke çënuar kështu, efektivitetin dhe eficiencën e arritjes së objektivave.

**Konkluzion:** Moszbatimi i të paktën 1 prej 5 projekte të parashikuara në strategji ka cenuar efektivitetin dhe eficiencën e arritjes së objektivave strategjik “Rritja e kapaciteteve të parkimit në qytetin e Tiranës”.

**Rekomandim nr. 1.1:** Titullari i Bashkisë Tiranë në cilësinë e monitoruesit të zbatimit të projekteve, të kryej analizat e nevojshme për të identifikuar arsyet e moszbatimit të projekteve strategjike, me qëllim mospërsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

**Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 2:** Nga ana e subjekteve investitorë për punimet e kryera në fushën e ndërtimit janë prekur zonat e parkimeve me pagesë, ku nga 18 raste të konstatuara gjatë periudhës nën auditim, vetëm 2 subjekte kanë paraqitur dokumentacionin për njoftim të kryerjes së aktivitetit.

**Konkluzion:** Në mungesë të paraqitjes së dokumentacionit nga subjektet private, për të njoftuar kryerjen e punimeve të cilat bllokojnë vendet e parkimit me pagesë, Tirana Parking nuk ka ndijeni për bllokimin e vendeve të parkimit të ciat ajo menaxhon, mosshfrytëzim i të cilave sjellë mungësë në të ardhura për Tirana Parking.

**Rekomandim nr. 2.1:** Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Tirana Parking të analizojnë lejet e ndërtimit, për mos cenimin e të drejtës së qytetarëve për vend parkim, gjatë periudhës së bllokimit të zonave për llogari të investitorëve në fushën e ndërtimit, gjë e cila ndikon në një menaxhim eficient të parkimeve.

**Në vijimësi**

**Rekomandim nr. 2.2:** Drejtoria e Urbanistikës të marr masa të lajmëroj zyrtarisht Agjencinë Tirana Parking për lejet e ndërtimit të dhëna të cilat do të prekin në mënyrë të drejtpërdrejt parkimet me pagesë.

**Në vijimësi**

**Gjetje nr. 3:** Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 49 datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës” pika 2 e nenit 2.4 të Aneksi 3 specifikon si më poshtë vijon:

.... “Tarifat e shërbimit të parkimit mund të paguhen me para në dorë (cash) dhe/ose përmes SMS-ve apo mënyrave alternative të pagesës të mundësuar nëpërmjet telefonisë celulare.”

Pavarësisht përcaktimit në VKB, në qytetin e Tiranës pagesa aktualisht kryhet vetëm me anë të platformës SMS payment, duke mos pasur asnjë metodë tjetër alternative për kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit.

**Konkluzion:** Ekzistenca e vetëm një alternative për të kryer pagesën e parkimit në Tiranë, ajo nëpërmjet sms në telefon, nuk krijon mundësi të barabarta për parkim për të gjithë qytetarët apo vizitorët e Tiranës, duke mos krijuar mundësinë e pagesës në mungesë të kreditit të mjaftueshëm në telefon apo mos pasjes së një numri nga operatorët shqiptar. Në këto rrethana bëhen burim i marrjes së penaliteteve financiare (gjoba).

**Rekomandim nr. 3.1.** Tirana Parking të kryejë studimet dhe analizat e nevojshme për të identifikuar metodat më të përshtatshme të pagesës së parkimit në këtë qytet. Në vijim, të ndërmarrë masat e nevojshme për aplikimin e tyre.

**Mars 2022**

**Gjetje nr. 4:** Nga analizimi i pagesës së parkimit nëpërmjet sms u konstatuan problematikat e mëposhtme:

-Vodafone Albania ka ndërprerë sinjalin në 7 raste për vitin 2019 dhe 6 raste në vitin 2020 (pa përfshirë bllokimin për efekt pandemie), ku të përkthyer në orë pa pagesë në vit janë 23.5 orë për 2019 dhe 41.5 orë për vitin 2020. Telekom ka ndërprerë sinjalin në 10 raste për vitin 2019 dhe 11 raste në vitin 2020, ku të përkthyer në orë pa pagesë në vit janë 30 orë për 2019 dhe 56 orë për vitin 2020. Nisur nga fakti që në një orë mesatarisht parkojnë 390 makina në zonën A, 187 makina në zonën B dhe 28 makina në zonën C, sipas tarifimit respektiv të zonave, 100 lekë/ora, 40 lekë/ora dhe 20 lekë/ora, kjo sjell të ardhura të munguara potenciale për vitin 2019 në 3,938,560 lekë dhe për vitin 2020 në 4,376,740 lekë nga të cilat respektivisht sipas kompanive rezultojnë të ardhura të munguara nga Telekom 4.511.460 lekë dhe nga Vodafone 3.803.840 lekë. Vlerave respektive duhet ti zbritet përqindja e komisionit që kompanitë telefonike mbajnë konkretisht 15%, dhe kjo vlerë shkon konkretisht për vitin 2019 shkon në 3,347,776 lekë dhe për vitin 2020 në 3,720,229 lekë, ose 7,068,005 lekë për periudhën nën auditim. Nga ana e Vodafone Albania nuk ka asnjë plan rezervë apo specifikim konkret lidhur me ndërprerjet e sinjalit, apo se si do të kryhet menaxhimi në rast të përballjes me këtë ndërprerje apo bllokime të tjera të sinjalit, sikundër nuk ka asnjë klauzolë në marrëveshje se kush do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara duke qenë se nga ana ekonomike kjo ndërprerje normalisht përkthehet në mos arkëtim të parave për këtë shërbim të ndërprerë.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ka një analizë kosto/përfitim të kryer nga ana e Bashkisë Tiranë përse i takon tarifës së komisionit të vendosur nga ana e Vodafone Albania dhe as të operatorëve të tjerë.

**Konkluzion:** Nga ana e Bashkisë Tiranë dhe operatoreve telefonik, si palë në marrëveshjet e lidhura për pagesën e parkimit nëpërmjet sms, nuk është parashikuar asnjë klauzolë mbi menaxhimin e situatës në rast të ndërprerjes së sinjalit telefonik, sikundër nuk specifikohet cili do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara në buxhetin e BT, duke shkaktuar që peshën e të ardhurave të munguara ta mbajë buxheti i shtetit.

Vendosja e tarifës që operatorët ekonomik do të përfitojnë për ofrimin e shërbimit të pagimit të parkimeve nëpërmjet telefonit, në mungesë të analizave mbështetëse, nuk siguron *vlerën për para* për shërbimin e marrë nga Tirana Parking.

**Rekomandim nr. 4.1 :** Gjatë rinovimit të kontratave me operatorët telefonikë për pagesat me sms të parkimeve, Bashkia Tiranë të mbajë në konsideratë rastet e ndërprerjes së sinjalit dhe

tarifat e komisionit, për të negociojë kushtet më të përshtatshme për adresimin e këtyre çështjeve me qëllim shmangien e të ardhurave të munguar në buxhetin e Bashkisë dhe shpenzimet pa efektivitet.

### **Me rinovimin e kontratave me operatorët telefonikë**

**Gjetje nr. 5:** Nga vizita në terren u konstatuan problematika lidhur me sinjalistikën e parkimit në shumicën e zonave të kontrolluara nga ana e grupit të auditimit, konkretisht sinjalistika horizontale dhe vertikale lidhur me parkimin nuk ishte e plotë, nevojitesh ravijëzim i zonave si për parkim me pagesë ashtu edhe për parkimin pa pagesë.

**Konkluzion:** Problematikat e shumta të konstatuara nga auditimit, në sinjalistikën e parkimeve në Tiranës, çënojnë e mbarëvajtjes së administrimit të parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 5.1:** Tirana Parking të marrë masat për riparimin e sinjalistikës dhe vijëzimit në zonat të cilat janë evidentuar gjatë kontrollit në terren nga ana e grupit të auditimit si zona me sinjalistikë të dëmtuar, të kryejë kontroll dhe të plotësojë me sinjalistikë vertikale dhe horizontale zonat problematike rast pas rasti.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

#### ➤ **Bashkia Korçë**

Lidhur me zbatimin e 3 projektet test të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, trajtuar më gjerësisht planifikimi i tyre në nënpyetjen audituese “*A janë përcaktuar dhe planifikuar objektiva dhe aktivitet SMART, për menaxhimin e parkingjeve në qytetet e Tiranës dhe Korçës?*”, rezultoi sa më poshtë:

1. Mbi projektin për vende të reja parkimi në zonën e Fabrikës së Birrës, referuar përgjigjes zyrtare të Bashkisë Korçë, ky projekt nuk është realizuar. Pasi, “*investimi i parashikuar brenda territorit, nuk është shprehur asnjë interes për realizimin e tij. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me pronarët e pronave përreth. Në kushtet e mos zhvillimit të kësaj zone, Bashkia nuk mund të parashikojë dhe për më tepër të investojë për realizimin e infrastrukturës.*”<sup>44</sup> Në mungesë të deklarimit të burimit të financimit të këtij projekti në dokumentin strategjik të strategjisë, grupi i auditimit nuk mund të ofrojë siguri të arsyeshme nëse ai është planifikuar të mbështetet me fonde të Bashkisë apo të investitorëve private.
2. Mbi projektin për zona parkimi në sheshin e Voskopojës, ai është realizuar duke krijuar vendparkime pa pagesë.
3. Mbi projektin “Rregullore e Klasifikimit të Rrugëve Urbane”, projekt ky me një rëndësi të veçantë në adresimin e problemeve me trafikun dhe parkimet në qytetin e Korçës, ai nuk është realizuar. Pasi, “*Bashkia Korçë nuk ka siguruar fondet e nevojshme për hartimin e këtij projekti.*”<sup>45</sup>.

Më datë 27.06.2014 Bashkia Korçë ka lidhur kontratën me shoqërinë “Alban 2 Security” me qëllim administrimin e zonave dhe vend parkimeve me pagesë në rrugë në qytetin e Korçës dhe

<sup>44</sup> Përgjigja zyrtare e Bashkisë Korçë, në përgjigje të pyetjes 1 të pyetësorit të dërguar nga grupi i auditimit më datë 05.05.2021.

<sup>45</sup> Përgjigja zyrtare e Bashkisë Korçë, në përgjigje të pyetjes 3 të pyetësorit të dërguar nga grupi i auditimit më datë 05.05.2021.

administrimin e parkimit të rezervuar. Referuar kësaj kontrate ishin katër zona në të cilat do të aplikohet parkimi me pagesë në rrugë, si më poshtë<sup>46</sup>:

- Zona A, sheshi Teatrit “Andon Zako Çajupi” me 96<sup>47</sup> vende parkimi, orari 08:00-16:00;
- Zona B, vend parkim në zonën e pazarit me 136<sup>48</sup> vende parkimi, orari 07:00-15:00;
- Zona C, vend parkim në bulevardin “Republika” me 87 vende parkimi, orari 08:00-16:00;
- Zona D, vend parkim në rrugën “Konferenca e Pezës” me 113 vende parkimi, orari 08:00-16:00.

Rerefuar nenit 5 të kësaj kontrate, tarifa e parkimit do të ishte 50 lekë/ orë dhe tarifa së bashku me orarin duhet të afishoheshin për të qenë të dukshme për publikun. Referuar nenit 4 të kontratës, të ardhurat bruto të kontratës do të ndaheshin 32% për Bashkinë Korçë dhe 68% për shoqërinë private. Sipas pikës 6 të nenit 5 të kontratës, “*Aplikimi i sistemit të pagesave do të fillojë nëpërmjet përdorimit të biletës së parkimit. Gjatë vitit të dytë të kontratës të kryet vendosja e parkimeve, duke i kompletuar zonat me radhë me këto aparatura*”. Në pikën 5 të nenit 7 të kontratës përcaktohet numri minimal i parkimeve si më poshtë:

- Zona A 2 Parkimetra
- Zona B 3 Parkimetra
- Zona C 2 Parkimetra
- Zona D 3 Parkimetra.

Mbështetur në nenin 6 të kontratës të lidhur midis palëve, disa prej të drejtave dhe detyrave kryesore të Bashkisë ishin:

- Të japë çdo informacion dhe dokument apo asistencë tjetër për afrimin e shërbimit me cilësi për publikun;
- Të monitorojë dhe kërkojë informacion të detajuar nga agjenti tatimor për ecurinë e kryerjes së shërbimit;
- Të përcaktojë personat e kontakti dhe të njoftojë me shkrim agjentin për personat e kontaktit që do të ndjekin mbarëvajtjen e shërbimit dhe kryerjen e investimeve dhe punimeve;
- Bashkia Korçë ka të drejtë që nëpërmjet Policisë Bashkiake të marrë masa për dënimin e kundërvënies në lidhje me parkimin me pagesë dhe të ardhurat nga gjobat do të kalojnë totalisht në buxhetin e Bashkisë Korçë. në çdo rast do të mbajë një kontakt të vazhdueshëm me agjentin dhe do të ofrojë bashkëpunimin e saj sa herë kërkohet nga agjenti;
- Përgatitja e biletave do të kryhet nga Bashkia Korçë dhe ato do t'i jepen subjektit prej saj; etj.

Mbështetur në nenin 7 të kësaj kontrate, disa prej të drejtave dhe detyrave kryesore të shoqërisë konçensionare ishin:

- Të respektojë kushtet e vendosura nga Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak Korçë, në lidhje me administrimin e zonave dhe vend parkimeve në të cilat do të aplikohet parkimi me adresë në rrugë në qytetin e Korçës, si dhe administrimin e parkimit të rezervuar;
- Përpara fillimit të kryerjes së shërbimit të kryejë të gjitha punimet për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale të parkimit me pagesë në rrugë dhe të mirëmbajë në

---

<sup>46</sup> Kontrata e lidhur midis Bashkisë Korçë dhe shoqërisë Alban Security, për administrimin e parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, neni 1 dhe neni 3 i kontratës.

<sup>47</sup> Me shtesën e kontratës, të lidhur midis bashkisë dhe shoqërisë Alban Security më datë 30.03.2015, vendparkimet në këtë zonë janë reduktuar në 51 vende parkimi.

<sup>48</sup> Me shtesën e kontratës, të lidhur midis bashkisë dhe shoqërisë Alban Security më datë 30.03.2015, vendparkimet në këtë zonë janë reduktuar në 111 vende parkimi.

vazhdimësi sinjalistikën dhe aparaturat në funksion të këtij aktiviteti gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës;

- Të afishojë pagesën dhe orarin e parkimit në vende të dukshme;
- Aplikimi i sistemit të pagesës të fillojë nëpërmjet përdorimit të biletës së parkimit. Gjatë vitit të dytë të kontratës të kryhet nga agjenti vendosja e parkimeve duke kompletuar zonat me radhë më këto aparatura; etj.

Velfshëmria e kësaj kontrate ishte deri më 26.06.2019.

Nga analizimi i të dhënave të përcjella nga Bashkia Korçë rezultoi se, me përfundimin e afatit të kontratës më datë 26.06.2019, menaxhimi i parkimit me pagesë nga kjo bashki ka nisur më datë 01.09.2016. Pra, për muajt korrik dhe gusht 2019, një prej periudhave me fluksin më të madh të turistëve në qytetin e Korçës, parkimi me pagesë në këtë qytet nuk është menaxhuar, pasi detyrimi i koncesionarit për menaxhimin e tij ka përfunduar në qershor 2019, ndërsa struktura e re e miratuar e Bashkisë Korçë me punonjësit e parkimit të përfshirë në të, është e datës 01.09.2019.

Me marrjen në menaxhim të parkimeve nga Bashkia Korçë, me anë të vendimit nr. 111 datë 03.08.2019 të Këshillit të Bashkisë, vend parkimet me pagesë janë reduktuar si më poshtë:

- Në zonën e pazarit (rruga “Kiço Greço”) në pjesën fundore të tij janë hequr 25 vende parkimi (10 + 15, sipas hartës treguese).
- Në zonën e Katedrales (bulevard “Republika”) në pjesën fundore të tij janë hequr 7 vende parkimi (4 + 3, sipas hartës treguese).
- Në zonën e bulevard “Fan Noli” janë hequr 13 vend parkime në rrugën “Konferenca e Pezës” (10 + 3, sipas hartës treguese). Në rrugën “28 Nëntori” janë hequr 22 vend parkime (14 + 3 + 5, sipas hartës treguese). Në pjesën e sipërme të bulevard “Fan Noli” janë hequr 11 vende parkimi.

Në relacionin bashkëlidhur Vendimit 111, datë 03.08.2019, përcaktohet se “*Si rrjedhë e kryerjes e kryerjes së punimeve për rikonstruksionin e rrugëve në disa nga zonat e parkimit ka një situatë të ndryshme të vendeve të parkimit, ndaj për tu përshtatur me situatën aktuale paraqiten për miratim zonat ku do të zhvillohet parkimi me pagesë në rrugë. Krahasuar me periudhën e kaluar propozohet që të reduktohet shtrirja e vend parkimeve ku do të aplikohet parkimi me pagesë për arsye se disa segmente kanë rezultate jo rentabël*”.

Grupi i auditimit kërkoi vënien në dispozicion të analizave të kryera për heqjen e vendparkimeve të mësipërme, të cilat argumentojnë mungesën e rentabilitetit në segmentet e hequra nga parkimi me pagesë për këtë arsye. Nga subjekti nuk u paraqitën analiza të tilla. Mungesa e dokumenteve apo analizave justifikuese për heqjen e vendparkimeve me pagesë, nuk ofron siguri të arsyeshme mbi efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e kësaj vendimmarrje. P.sh, nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit u identifikua rasti i 4 (katër) vende të parkimit në bulevardin Republika, të cilat janë në një nga zonat më të frekuentuar të qytetit (sikurse shihet edhe në foton ilustruese të marrë nga grupi i auditimit, të 4 postet e parkimit ishin të zëna), të mbuluar nga punëtorët e parkimit me pagesë<sup>49</sup>, të cilat me vendimin nr. 111, datë 03.08.2019 janë hequr nga zonat e parkimit me pagesë. Në gjykimin e grupit të auditimit, mbetet i pa argumentuar përjashtimi i këtyre vendparkimeve nga zona e parkimit me pagesë. Në vijim, kjo zonë edhe pse kishte më tepër se një vit që ishte hequr nga zona e parkimit me pagesë, ajo vijonte të ishte e vijëzuar me blu (vijëzimi me blu nënkupton zonë parkimi me pagesë).

<sup>49</sup> Pasi të dyja anët e rrugës ku shtrihen këto vend parkime janë aktualisht zona të parkimit me pagesë.

Figura 1: 4 poste parkimi të hequra me vendimin nr. 111 datë 03.08.2019, të pa argumentuara



*Burimi:* Vizita në terren, grupi i auditimit

Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit në qytetin e Korçës, rezultatet e të cilave janë paraqitur në procesverbalet e datave 05.03.2021 dhe 06.05.2021 të mbajtura midis grupit të auditimit dhe përfaqësuesve të Bashkisë u konstatua se, në vitin 2021 në vend parkimet me pagesë aplikohet vetëm një modalitet pagese ajo nëpërmjet biletave të lëshuara nga punëtori i parkimit me pagesë. Në vend parkimet me pagesë nuk u gjenden parkimetra. Nga intervistat e kryer me qytetarë dhe biznese në zonat e parkimit me pagesë në qytetin e Korçës nga grupi i auditimit, rezultoi se ekzistenca e vetëm një alternative për të kryer pagesën, ajo nëpërmjet biletave që lëshojnë punonjësit e parkimeve, nuk është në çdo rast efiçente për kohën e qytetarëve. Nga intervistat e kryera me qytetarët, këta të fundit u shprehën se shpesh duhet të presin për të ardhur punonjësi i parkimit për të lëshuar biletën dhe për të marrë pagesën.

Nga kontrolli i sinjalistikës horizontale dhe vertikale në vendparkimet me pagesë rezultuan sa më poshtë:

Tabelat e parkimit me pagesë në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë të plotësuara më çmimin e parkimit me pagesë.<sup>50</sup>

Figura 2: Sinjalistika vertikale, jo e plotë.




*Burimi:* Vizita në terren, grupi i auditimit

Në shumicën e rasteve sinjalistika horizontale ishte e venitur ose e fshirë duke mos siguruar vijëzim të dukshëm.

<sup>50</sup> Akti i kostatimit i mbajtur midis grupit të auditimit dhe përfaqësuesve të Bashkisë Korçë, pas vizitës në terren 06.05.2021.

Figura 3: Sinjalistika horizontale mungon është jo e qartë, ose e gabuar



Burimi: Vizita në terren, grupi i auditimit

Problematika u konstatuan dhe me sinjalistikën vertikale. Në disa raste tabelat e parkimit me pagesë mungonin fare, ose nuk ishin vendosur në vendin e duhur. Kishte raste që tabelat vertikale ishin në vende jo lehtësisht të dukshme për publikun, p.sh. ishin të mbuluara nga pemët, ilustruar më fotot e mëposhtme.

Figura 4 : Sinjalistika vertikale mungon, jo e saktë, ose jo e lehtësisht e dukshme.



Burimi: Vizita në terren, grupi i auditimit

Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit rezultoi se këto zona në qytetin e Korçës nuk janë të vijëzuara.

*Figura 5: Mungesa e vijëzimit në postet e parkimit, në zonën e parkimit për rezidentët*



*Burimi:* Vizita në terren, grupi i auditimit

**Gjetje nr. 6:** Nga auditimi rezultoi se, nga 3 projekte test të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë mbi menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, 2 dy prej tyre nuk janë realizuar, për shkak të mungesës së fondeve.

**Konkluzion:** Mangësitë e konstatuara në planifikimin<sup>51</sup> e projekteve test për parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, kanë shkaktuar që 67% e tyre të mos realizohen, si rezultat i mungesës së fondeve, duke cenuar efektivitetin e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës.

**Rekomandim nr. 6.1:** Titullari i Bashkisë Korçë, të ndërmarrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe analizuar faktorët të cilët kanë shkaktuar moszbatimin e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë. Në përfundim të analizës të ndërmarr masat e nevojshme me qëllim mos përsëritjen e kësaj situate në të ardhmen.

*Dhjetor 2021*

**Gjetje nr. 7:** Nga auditimi rezultoi se aktualisht në Bashkinë Korçë aplikohet vetëm një mënyrë pagese për parkimin, ajo nëpërmjet lëshimit të biletës dhe mbledhjes së pagesës nga punonjësi i bashkisë. Në zonat e parkimit me pagesë nuk u gjetën parkimetra, si një mënyrë alternative për të kryer pagesën. Referuar intervistave që grupi i auditimit realizoi me qytetarët dhe bizneset rezultoi se, mungesave e metodave alternative të pagesës së parkimit është një ndër

<sup>51</sup> Për më shumë, konsultoni gjetjet në nënpyetjen audituese 1.1.1.

problematikat kryesore të lidhura me parkimet në këtë qytet. Kryerja e pagesës me *cash* (para në dorë) përmban risk të lartë për abuzime si nga ana e qytetarit edhe nga punonjësi i Bashkisë.

**Konkluzion:** Mungesa e metodave alternative të pagesës së parkimit në qytetin e Korçës, përmban riskun e cenimit të ekonomicitet dhe eficiencës të procesit. Si rezultat se, punonjësit e parkimit kanë një numër të konsiderueshëm postesh parkimi në administrim, krijohen vonesa në procesin e dhënies së biletës dhe marrjes së pagesë, (veçanërisht në periudhat e fluksit të turistëve), të cilat cenojnë eficiencën e kohës së qytetarëve, duke shkaktuar largimin e tyre drejt parkimeve private ose penalizimin e tyre me anë të gjobave, në rastin kur ata nuk presin punonjësin e parkimit të bashkisë për të paguar.

**Rekomandim nr. 7.1:** Bashkia Korçë të kryej studimet dhe analizat e nevojshme për të identifikuar alternativat më të mira të pagesës së parkimit në këtë qytet. Në vijim, të ndërmarrë masat e nevojshme për aplikimin e tyre.

**Mars 2022**

**Gjetje nr. 8:** Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit së bashku me përfaqësuesit e Bashkisë Korçë u konstatuan raste të mungesës së sinjalistikës vertikale, sinjalistike vertikale jo e plotë, jo e saktë ose jo e dukshme. Gjithashtu u konstatua, mungesë e sinjalistikë horizontale, sinjalistikë horizontale e fshirë, jo e saktë ose dy vijëzim. Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit rezultoi se zona e parkimit për rezidentët në qytetin e Korçës nuk është e vijëzuar, makinat ishin të parkuara jo në postet e parkimit (pasi ato nuk janë të vijëzuara), duke penguar hyrjen dhe daljen e automjeteve nga kjo zonë.

**Konkluzion:** Problematikat e shumta të konstatuara nga auditimit, në sinjalistikën e parkimeve në qytetin e Korçës, si mungesa e plotë e saj, sinjalistikë jo e saktë, jo e qartë, ose jo e plotë bëhen burim i moszbatimit të rregullave të parkimit nga qytetarët duke shkaktuar penalizimin këtyre të fundit me gjoba, si dhe cenojnë e mbarëvajtjes së administrimit të parkimeve në tërësi. Mungesa e vijëzimit të posteve të parkimit në zonat e rezidentëve shkakton parkimin e automjeteve jo në mënyrë të rregullt, duke vështirësuar hyrjen dhe daljen e qytetarëve dhe automjeteve nga këto zona.

**Rekomandim nr. 8.1:** Bashkia Korçë të ndërmarr masat e nevojshme për të siguruar sinjalistikë të plotë, të qartë dhe të saktë horizontale dhe vertikale në vend parkimet me pagesë, si dhe në të gjitha zonat e rezidentëve, me qëllim shmangien e parkimit të automjeteve jo në mënyrë të rregullt.

**Dhjetor 2021**

**Gjetje nr. 9:** Me përfundimin e kontratës së koncensionarit në qershor të vitit 2019, gjatë muajve me fluksin më të lartë të turistëve në qytetin e Korçës, korrik-gusht 2019, parkimet me pagesë në këtë qytet nuk janë menaxhuar. Bashkia ka nisur të administrojë parkimet me pagesë në muajin shtator 2019.

**Konkluzion:** Si rezultat se, Bashkia Korçë nuk ka ndërmarr në kohë masat e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e administrimit të parkimeve me përfundimin e kontratës me Koncesionarin, parkimi në këtë qytet gjatë muajve korrik-gusht 2019 (muaj këto me një fluks

mjaftë të lartë turistësh) nuk është menaxhuar, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, si dhe mungesë në eficientën e procesit.

**Rekomandim nr. 9.1:** Në raste të tjera në vijim të ndryshimit të mënyrës së menaxhimit të parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, Bashkia të marrë të gjitha masat e nevojshme që gjatë këtij ndryshimi, parkimi në qytet mos të mbetet i pa menaxhuar, me qëllim shmangien e të ardhurave të munguara dhe të problematikave me trafikun.

**Në vijimësi.**

**Gjetje nr. 10:** Nga auditimi u konstatuan se në vitin 2019 janë hequr 78<sup>52</sup> vende parkimi me pagesë nga 362 (ose 21%) vende parkimi me pagesë që ishin të tilla që prej vitit 2015. Për heqjen e tyre Bashkia Korçë nuk disponon analiza të kryera, apo dokumente justifikuese që vërtetojnë se kjo vendimmarrje është kosto-eficiente. Nga vizitat në terren u konstatuan 4 vend parkime të hequra nga parkimi me pagesë në një nga zonat më të frekuentuara të qytetit (me një numër të lartë biznesesh private), si dhe lehtësisht të aksesueshme nga punonjësit aktual të parkimit me pagesë, përjashtimi i të cilave nga pagesa, në gjykimin e grupit të auditimit mbetet i paargumentuar.

**Konkluzion:** Zvogëlimi i vend parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, në mungesë të një vizioni të qartë të Bashkisë për të ardhmen e menaxhimit të parkimeve në qytet, dhe mos mbështetja e kësaj vendimmarrje me analiza të detajuara për secilin segment të hequr nga parkimi me pagesë, bëhet burim i vendimmarrjeve arbitrare dhe përmban riskun e mungesës së efektivitetit, eficientës dhe ekonomicitet në administrimin e parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 10.1:** Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë, në çdo rast vendimmarrje për shtimin apo pakësimin e vend parkimeve me pagesë në qytet, të mbështetet në analiza dhe studime të detajuara, me qëllim për të siguruar përmbushjen e vizionit të Bashkisë, për parkimet dhe vizionit të përgjithshëm të Bashkisë për zhvillimin e qytetit.

**Në vijimësi**

**Rekomandim nr. 10.2:** Titullari i Bashkisë të ndërmarrë masat e nevojshme për të analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha vend parkimet e përjashtuara nga pagesa, me Vendimin nr. 111, datë 03.08.2019 të Këshillit Bashkiak. Në përfundim të analizës, në rast identifikimi të segmenteve të përshtatshme dhe rentabël, t'i propozojë Këshillit Bashkiak rikthimin e tyre në poste parkimi me pagesë.

**Dhjetor 2021**

### ***1.2.2. A është monitoruar në mënyrë të vazhduar performanca e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës dhe Korçës?***

Monitorimi ndjek progresin e bërë në drejtim të arritjes së objektivave.<sup>53</sup> “Për të siguruar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e procesit me kalimin e kohës, është thelbësore që të vendosen

<sup>52</sup> Të cilat kryesisht janë vend parkime pa pagesë, ndërsa pjesa tjetër e tyre janë pjesë e rrugës si rezultat i ristrukturimit të rrugëve

<sup>53</sup> Gjykata Evropiane e Auditesve, Objektivat, Monitorimi dhe Indikatorët, 2019, fq. 10

*rregullat e duhura për të monitoruar dhe vlerësuar procesin. Ky hap mbështet autoritetet lokale në zhvillimin e një qasje drejt monitorimit dhe vlerësimi (M&E).<sup>54</sup>*

Sikurse është cituar edhe më lartë, referuar nenit 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*”;

### ➤ **Bashkia Tiranë**

Referuar pikës 3/e dhe ë të nenit 22 “Veprimtaritë e kontrollit” të ligjit 10296 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” *Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:*

*e) procedurat për raportimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e eficiecës dhe të efektivitetit të veprimtarive; ë) procedurat e monitorimit;*

Analiza e grupit të auditimit ka nisur duke trajtuar procesin e monitorimit në vetvete, ku me monitorim do të nënkuptohet procesi dhe procedurat që drejtimi i entitetit nxjerr për t’u siguruar se kontrolli i brendshëm është ndërtuar dhe po punon në të gjithë komponentët e tij sipas objektivave të vendosura.

Bazuar në Rregulloren e Bashkisë Tiranë, kreu V, neni 42.4 Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve ka për mision që:.....*Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve është përgjegjëse për hartimin e planeve strategjike afat-mesme dhe afat-gjata të Bashkisë Tiranë dhe sigurimin e jetësimit të projekteve prioritare, duke përcaktuar hapat e nevojshme që duhen ndërmarrë dhe kalendarit të zhvillimit të projekteve dhe mbikëqyrjen e realizimit të këtyre projekteve hap pas hapi deri në përfundimin e tyre.*

*Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse ku vepron, si dhe për programet,veprimtaritë dhe proceset, të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës.<sup>55</sup>*

*Detyrat:*

1. Koordinohet me strukturat e tjera të Bashkisë, për përcaktimin e objektivave strategjike dhe monitoron realizimin e tyre;

6. Ndjek zbatimin e strategjive, politikave dhe planet e fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi;

7. Koordinon analizën periodike (çdo vit) të indikatorëve socio-ekonomike për të matur impaktin e politikave të ndjekura apo për të propozuar politika të reja;

Nga auditimi i dokumentacionit dhe pas korrespondencës së mbajtur me subjektet e auditimit rezultojë se, përsa i takon procesit të monitorimit, nga ana e Tirana Parking shprehin se, Monitorimi i Strategjisë se Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë kryhet nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe jetësimit të Prioriteteve, Bashkia Tiranë<sup>56</sup>.

Sipas DPSJP argumentohet se, Sektori i Jetësimit të Prioriteteve, pjesë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve, është struktura që kryen monitorimin e SZHQBT-së. Procesi i monitorimit kryhet një herë në vit, ku nëpërmjet komunikimit zyrtar

<sup>54</sup> Urban adaptation support tool, <https://climate-adapt.eea.europa.eu/knowledge/tools/urban-ast/step-6-1>.

<sup>55</sup> [file:///C:/Users/Klsh/Downloads/Rregullore%20p%C3%ABr%20organizimin%20dhe%20funksionimin%20Bashkia%20Tiran%C3%AB%202019%20Revised%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Klsh/Downloads/Rregullore%20p%C3%ABr%20organizimin%20dhe%20funksionimin%20Bashkia%20Tiran%C3%AB%202019%20Revised%20(1).pdf)

<sup>56</sup>Email zyrtar dt 24.05.2021 drguar nga J.Fezgaj

(shkresa) me të gjitha strukturat që zbatojnë projekte/aktivitete të përfshira në SZHQBT (në rastin konkret Tirana Parking) ju kërkohet informacion mbi indikatorët (matësit) e përcaktuar në këtë dokument. Strukturat dërgojnë indikatorët e matur nga vetë ata, të cilat mblidhen dhe përpunohen nga DPSJP.

Nga auditimi rezultoi se, mungonte një raport monitorimi, qoftë i përgjithshëm apo specifik mbi secilin projekt. Si përfundim nga të dy strukturat, si DPSJP dhe nga ana e Agjencisë, nuk ka gjetur zbatim ligji i menaxhimit financiar dhe kontrollit sa i takon procesit të monitorimit. Ndërsa sa i përket monitorimit të objektivave operacionale nuk ka asnjë gjurmë të dokumentimit të kryerjes së procesit.

-Nga auditimi u konstatua se, gjobat e vendosura nga për problematika parkimi për periudhën objekt auditimi janë si më poshtë:

(Në lekë)

Vite	Numri gjobave të vendosura	Vlera	Totali i të ardhurave të parkimit të automjeteve (Tirana Parking)	Pesha e gjobave ndaj totalit të të ardhurave të TP	Totali i të ardhurave të Bashkisë Tiranë
2018	74,191	102,283,000	458,774,632	23%	13,540,110,513
2019	72,378	80,524,000	473,387,488	17%	14,388,627,462
2020	82,133	82,242,000	403,694,860	20%	14,534,420,053

Burimi: TP, përpunuar GA

Nga auditimi konstatohet se, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 9808 datë datë 24.09.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998” neni 2 pika 1c konkretisht ....1. Në pikën 1 shtohet shkronja "c" si më poshtë: "c) policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7, me përjashtim të pikës 12 të tij, nenin 11 pika 1 shkronjat "a" dhe "e", nenin 85, 86, 87, 89, 155 pika 6, 156 pika 1 shkronjat "g" dhe "h", pika 2 shkronjat "d", "e", "g", "h", "i", "j", "k" dhe "l"; specifikon policinë bashkiake si autoritetin përgjegjës për vendosjen e masave administrative për shkeljet administrative të shërbimit të parkimit në rrugë.

Paralelisht është Vendimi i Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 48, datë 11/11/2015 me pikat 1 d) dhe e) i cili ngarkon Agjencinë TP me konstatimin, vendosjen dhe arkëtimin e masave administrative për shkeljet administrative të shërbimit të parkimit në rrugë. Sa më sipër kemi të bëjmë me përplasje mes kompetencave të dy institucioneve të ndryshme, ku agjencia e ka të specifikuar si detyrë të vet institucionale dhe funksionale në bazë të VKB nr. 48, datë 11/11/2015 dhe në bazë të Kodit Rrugor.

U konstatuan raste ku vendet e parkimit me pagesë apo ato të lira ishin zënë prej bizneseve në krah duke hequr mundësitë e qytetarëve për të parkuar. Konkretisht, tek rruga “Abdullah Keta”, në tre vende parkimi për rezident, 2 figurojnë gjithë kohën të zënë me hekur lëvizës për lokalit përballë, në rrugën “Zenel Baboci”, u evidentua si rrugë me një sens dhe me hapësirë të lirë për parkim e cila aktualisht përdoret si e tillë, por me mungesë sinjalistike.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2018 nga TP kishte realizuar të ardhura të konsiderueshme nga biletat e parkimeve në rrugë. Nga ballafaqimi me inspektorët e TP u konstatua se biletat ishin jashtë formatit të parashikuar në ligj, ku nga ana i TP ishte zhvilluar një procedurë prokurimi.

Lidhur me blerje biletash parkimi TP, në vitin 2016, nga titullari i autoritetit kontraktor është ngritur urdhër prokurimi me nr. 670 port., datë 24.05.2016 mbështetur në ligjin nr. 9643, datë

20.11.2006 për “Prokurimin publik” i ndryshuar, kreu III, neni 30, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VII, neni 60.

Loti i dytë: “Blerje blloqe biletash për parkim në rrugë, me fond limit: 4.095.000 (katër milion e nëntëdhjetë e pesëmijë) lek pa tvsh”. Lloji i procedurës së prokurimit të jetë : “Procedurë e hapur”. Ref -40103-05-31.2016. Burimi i financimit nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

Është ngritur njësia e prokurimit me 3 (tre) anëtar Ky urdhër prokurimi është konceptuar nga specialist në drejtorinë juridike e prokurimeve.

Me Urdhrin nr. 671, prot., datë 24.05.2016 të titullarit të TP është ngritur KVO.

Me Urdhrin nr. 1141 prot., datë 08.09.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur komisioni për hedhjen e Formularit të njoftimit të fituesit. Me Urdhrin nr. 1144 prot, datë 13.09.2016 është fitues operatori ekonomik Denis Shakaj me ofertën e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej 2,925,000 lekë pa tvsh dhe me tvsh me vlerë 3.510.000 lekë. Data e lidhjes së kontratës është 16.09.2016.

Me Urdhrin nr. 1224 prot, datë 29.09.2016 është ngritur komisioni për verifikimin e vlerave materiale dhe mbajtjen e proces-verbalit për marrjen në dorëzim të 45.000 blloqe biletash me vlerë 3,510,000 lekë me tvsh, shoqëruar me faturë tatimore shitje me nr.serie 37260688, datë 29.09.2016 dhe nr.fature 502 me nipt K54027403Ë.

E gjithë kjo procedurë prokurimi, për lotin e dytë “Blerje blloqesh biletash për parkim në rrugë, me fond limit 4.095.000 (katër milion e nëntëdhjetë e pesëmijë) lekë pa tvsh”, është në kundërshtim me pikën 2 të VKM-së nr.1497, datë 19.11.2008 ku citohet: *“Letra me vlerë, në kuptim të këtij vendimi, do të vlerësohen pullat fiskale, biletat e transportit rrugor dhe hekurudhor, si dhe diplomat e maturës shtetërore, bileta, procesverbale, akte kontrolli, vendim për kundërvajtjen administrative, procesverbal i konstatimit të kundërvajtjes administrative, akt verifikimi, vendim dënimi, vërtetim transporti, bileta për hyrje në zonat e mbrojtura/parqe kombëtare për invalidë dhe automjete, fatura, raporte mjekësore, receta me rimbursim 100%, receta me rimbursim të pjesshëm, receta pa rimbursim, formularë vizite, formularët e procedurave mjekësore, rekomandime, kartela, libreza shëndetësore të lëshuara nga institucione shtetërore, si dhe dokumente të prodhuara e të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përmbajnë numër serial”.*

Nga dokumentacioni i verifikuar në ATP, rezulton se, të ardhurat nga përdorimi i blloqeve të biletave të sipërpërmendura, janë arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë, vlera 118,713,600 lekë.

Kjo lloj procedure është aplikuar vetëm në vitin 2016, kurse për vitet e tjera Agjencia e Tirana Parking ka kontaktuar dhe lidhur kontrata me shtypshkronjën e letrave me vlerë që ka dhe eskuzivitetin e prodhimit të biletave (parkimit) të pajisura me numra serial sipas VKM nr.1497, datë 19.11.2008.

Nga Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Tirana Parking është nxjerrë Urdhri i brendshëm me nr. 254, datë 15.12.2020 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e magazinës” dhe Urdhri i brendshëm nr. 263, datë 31.12.2020 “Për ngritjen e grupit të komisionit për vlerësimin e aseteve të propozuara për daljen nga përdorimi”.

Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm me nr. 254, datë 15.12.2020 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e magazinës”, është mbajtur procesverbal më datën 28.12.2020 nga ku rezulton: “Gjatë inventarizimit të magazinës vërehet një sasi biletash të parkimit të Zonës A, numri i fijeve të biletave në shumën 1,031,864 të cilave ju ka kaluar afati i përdorimit të tyre dhe gjendja jo në kushte të përshtatshme për përdorim. Biletat që u ka kaluar afati i përdorimit i

përkasin vitit 2016 në vlerën 103,184,400 lekë. Procedura e asgjësimit të këtyre biletave të pa përdorueshme dhe asgjësimi i tyre është bërë gjatë vitit 2021, periudhë jashtë auditimit tonë”.

***Një nga problematikat më të prekura prej qytetarëve është parkimi pranë vendbanimit, të gjithë ndeshemi me mungesën e hapësirave për parkim.***

Nisur nga impakti shumë i lartë social i kësaj çështje që na prek të gjithëve nga ana e grupit të auditimit u ngritën problematikat si më poshtë:

- a) *A sigurohet numri i parkimeve për banorët brenda sipërfaqes së përgjithshme të parcelës apo grup-parcelave për zhvillim, mbi ose nëntokë në të gjithë qytetin e Tiranës?*
- b) *A ka raste kur për realizimin e parkimeve nevojitet shtrirja e tyre mbi tokë dhe ndërthurja e sipërfaqeve të parkimeve me sipërfaqet e gjelbra? Si është operuar në këto raste?*
- c) *A ka raste kur zhvilluesi, për arsye të formës, zgjidhjes apo pozicionit të strukturës në territor, nuk arrin të sigurojë numrin e detyruar të parkimeve në projekt? A ka raste të konstatara të vend-parkimeve të munguara? Çfarë masa janë marr për këto raste?*
- d) *A ka një studim lidhur me numrin e parkimeve që duhet të sigurohet për çdo objekt?*

Nga përgjigjet e instancave përkatëse në Bashkinë Tiranë, konkretisht Drejtoria e Urbanistikës shprehet se Plani i Përgjithshëm Vendor (i ndryshuar) miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), rregullon dhe parashikon numrin e parkimeve për banorët brenda sipërfaqes së zonës për zhvillim duke respektuar kriteret e nenit 57 / pika 9 të Rregullores Vendore.

Nga auditimi rezulton se, baza ligjore mbi të cilën është operuar për numrin e vendeve të parkimit të nevojshme për çdo tip aktiviteti në rend kronologjik pasqyrohet si më poshtë:

1. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 671 datë 29 korrik 2015 (*sot e shfuqizuar si VKM*), në referencë të Neneve 81 dhe 82, si më poshtë vijojnë:

*Neni 81*

***Standardet dhe treguesit e planifikimit për zonat dhe njësitë strukturore të banimit***

1. Standardet e planifikimit për zonat e banimit duhet të aplikohen në njësi dhe/ose zona me prioritet zhvillimi, që kanë përdorim homogjen banimi ose qëllimin kryesor të përdorimit të tokës për banim, sipas kësaj rregulloreje.

2. Standardet e planifikimit ndryshojnë sipas numrit të popullsisë në territore urbane dhe kategorizohen, sipas rastit, për tri grupe kryesore:

- deri në 10,000 banorë;
- mbi 10,000 banorë;
- mbi 100,000 banorë.

3. Standardet e planifikimit në zonat e banimit duhet të sigurojnë kushte jetese të shëndetshme për popullsinë.

4. Standardet minimale të planifikimit për zonat dhe njësitë e banimit përcaktohen për treguesit e mëposhtëm të planifikimit:

a) Sipërfaqen bruto të banimit për banor, e cila përbëhet nga sipërfaqet e banimit të hapësirave të ndenjes dhe çlodhjes, gatimit, fjetjes, nyjave sanitare, të shkallëve dhe ashensorit;

b) hapësirën e gjelbër, sipas kësaj rregulloreje;

c) sipërfaqen për kopshte, çerdhe, shkolla 9-vjeçare, sipas kësaj rregulloreje;

- c) sipërfaqen për struktura me përdorim publik për aktivitete fetare, sociale, shëndetësore, sanitare, administrative, jo në nivel qyteti;
- d) sipërfaqen sportive, sipas kësaj rregulloreje;
- dh) sipërfaqen për parkim publik, sipas kësaj rregulloreje;
- d) sipërfaqen për shërbime tregtare të kufizuara dhe zyra, jo në nivel qyteti.
- Kjo hapësirë mund të jetë në struktura të veçanta ose në strukturën e banimit.

5. Standardet minimale për treguesit sipas pikës 4, të këtij neni, janë:

Qendra banuar	a) Sip bruto banimi	b) Hapësirë e gjelbër	c) Kopsht, cerdhe,	ç) Struktura për përdorim	d) Territor sportiv	dh) Parkim publik	e) Shërbim tregtar i	ë) Gjithsej
	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor	m <sup>2</sup> /banor
Deri 10 000 banorë	25	5	4	2	1.6	6	5	48.6
<b>Mbi 10 000 banorë</b>	25	9	4.5	2	1.6	6	5	53.1
<b>Mbi 100 000 banorë</b>	25	9	4.5	2	1.6	6	5	53.1

6. Në rastet kur disa nga territoret dhe objektet, sipas pikës 5, të këtij neni, i shërbejnë jo vetëm njësisë strukturore të banimit, por të gjithë qendrës së banuar, veç standardeve sipas këtij neni, zbatohen edhe të gjitha standardet dhe rregullat e dhëna në këtë kre.

*Neni 82*

### **Parkimi**

1. Përveç sa është parashikuar në pikën 5, të nenit 81, të kësaj rregulloreje, standardi minimal i parkimit:

a) Për parkimin publik, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 6 m<sup>2</sup>/banor ose 1 vend parkim prej 12 m<sup>2</sup> për çdo 2 banorë.

b) Për hapësirën e parkimit të dedikuar për objekte me përdorim jo banim, është 12 m<sup>2</sup>/përdorues dhe llogaritet mbi bazën e fluksit mesatar deri në maksimal 24-orësh të përdoruesve të objektit.

c) Për parkimin privat për objekte banimi, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, **është 15 m<sup>2</sup>/familje** ose apartament.

ç) Në të gjitha rastet të parashikohen vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.

2. Parkimi mund të jetë privat ose publik dhe format e zgjidhjes janë në rrugë, në sheshe publike, në sipërfaqe mbi ose nën tokë, në struktura me një ose disa nivele dhe në pjesë të objekteve me përdorime të ndryshme.

2. Aktualisht operohet mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 686 datë 22.11.2017, por kjo bazë ligjore nuk ka asnjë pjesë të shprehur mbi normat e projektimit të cilat kanë qenë të shprehura në VKM pararendëse.

3. Referuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, nenit 57 'Parkimet' të kësaj rregullore vendore, miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) "ku është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë (i ndryshuar)", specifikohet se:

*Neni 57*

### *Parkimet*

5. Në rastet kur për realizimin e parkimeve nevojitet shtrirja e tyre mbi tokë dhe ndërthurja e sipërfaqeve të parkimeve me sipërfaqet e gjelbra, atëherë zgjidhja duhet të jetë me pllaka të gjelbra dhe parkimet duhet të përkufizohen me gjelbërim të mesëm dhe të lartë hijezues.

6. Në këto raste, raporti i vend parkimeve të parashikuara nëntokë me ato të parashikuara mbi tokë nuk lejohet të tej-kalojë masën 70% nëntokë me 30% mbi tokë.

7. Në rastet kur zhvilluesi, për arsye të formës, zgjidhjes apo pozicionit të strukturës në territor, nuk arrin të sigurojë numrin e detyruar të parkimeve në projekt, atëherë për çdo vend-parkim të munguar autoritetet vendore do të aplikojnë tarifën/gjobë për mos realizimin e detyrimit të parkimeve sipas vlerës që do të përcaktohet me vendim të veçantë pranë Këshillit Bashkiak.

9. Numri i parkimeve që duhet të sigurohet për çdo objekt, është i lidhur me menaxhimin e trafikut dhe lëvizshmërinë. Mbështetur në studimet për transportin, duhet të mbahen në konsideratë këto normativa:

i. Banim - minimalisht 1 vend parkimi/apartament;

ii. Hotel – minimalisht 1 vend parkimi për çdo 3 dhoma (në këto raste projekti duhet të përshtatet normativave ndërkombëtare për përcaktimin e cilësisë të shërbimit dhe kualifikimit të hotelit sipas standardeve të projektimit dhe planifikimit të shërbimeve në projekt;

iii. Aktivitet tregtar - brenda qendrës: 1 vend parkimi për 100m<sup>2</sup>;

iv. Njësi tregtare periferike - 2 vende parkimi për 100m<sup>2</sup>;

v. Shërbime dhe facilitete - 1 vend parkimi për 100 m<sup>2</sup> sipërfaqe

vi. Shkolla dhe edukim - 1 vend parkimi për çdo klasë;

vii. Në të gjitha rastet të parashikohet vend parkim për personat me aftësi të kufizuara.

11. Sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private *është 25m<sup>2</sup>*

12. Në njësi strukturore të kategorisë Banim, për çdo zhvillim të parashikohet të paktën një vend parkimi për çdo njësi banimi, në respektim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Përgjigjja e D.U

Pika 12 nenit 57 të Rregullores vendore të PPV gjen zbatim në të gjitha rastet e hartimit<sup>57</sup> të Planeve të Detajuara Vendore Faza I dhe II, ku specifikohet me shënim në rregulloren e Fazës I zbatueshmëria e nenit 57 dhe në fletën e zbardhjes së Fazës II, kur përcaktohen kriteret e zhvillimit, citohet kushti i mëposhtëm:

“Numri i vendparkimeve do të saktësohet në çdo rast mbi bazën e sipërfaqeve ndërtimore të propozuara në fazën e aplikimit për leje ndërtimi, sipas kriterit “1 vend parkim për 100 m<sup>2</sup> ndërtim mbi tokë/ për shërbime dhe 1 vend parkim për apartament/ për banim”.

Gjithashtu pas miratimit të Fazës II apo lejes së zhvillimit, në fazën e lejeve të ndërtimit në projektet e hartuara kërkohet zbatueshmëria e këtij kriteri.

Përsa i përket situatës së parkimit në Tiranë, impaktit të qytetarët dhe mendimi i tyre mbi gjendjen aktuale të parkimit, nga ana e grupit të auditimit, duke mbajtur në konsideratë edhe situatën pandemike në të cilën ndodhemi dhe kriteret që duhen respektuar për tu mbrojtur, përgatiti një pyetësor të cilin e shpërndamë në formatin google forms<sup>58</sup> i cili ndodhet në Aneksin bashkangjitur.

**Gjetje nr. 1:** Përsa i takon bazës ligjore, VKM me nr. 686 datë 22.11.2017 nuk ka asnjë nen apo pikë ku të përcaktohen normat e projektimit të cilat duhet të mbahen në konsideratë lidhur me ndërtimet sikundër ishin në VKM nr. 671 datë 29 korrik 2015 (shfuqizuar).

**Konkluzioni:** Një bazë ligjore e paplotë e cila lë hapësirë për interpretim cënon zbatimin e saj l

<sup>57</sup>Email zyrtar dt 27.05.2021 D.Urbanistikes

<sup>58</sup>[https://docs.google.com/forms/d/1vQmSOtJ29MpëPQRbU6HhfjrimëAYf5PgGGMgafRKIxI/edit#response=ACYDBNiGfQ2MSKVbZs1rh-s15EGsYLzfpANnquëz4HNZVktuA\\_44hgPIDt9Sxy7IJMgz8HE](https://docs.google.com/forms/d/1vQmSOtJ29MpëPQRbU6HhfjrimëAYf5PgGGMgafRKIxI/edit#response=ACYDBNiGfQ2MSKVbZs1rh-s15EGsYLzfpANnquëz4HNZVktuA_44hgPIDt9Sxy7IJMgz8HE)

**Rekomandim nr. 1.1:** Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme me qëllim që të kryejë përmirësimin e bazës ligjore, e ku konkretisht Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr.686, datë 22.11.2017, të përditësohet duke mbajtur në konsideratë normat e projektimit mbi ndërtimet e reja.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Gjetje nr. 2:** Në pikën 11 të Nenit 57 të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) përcaktohet se: *“Sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private është 25m<sup>2</sup>”*. Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit u konstatua se, në praktikë nuk gjen zbatim pika 11 nenit 57 Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

#### **Konkluzioni:**

Mesatarisht secila makinë zë afërsisht 6 metra katrorë tokë dhe ‘flota’ e automjeteve në tërësi zë gati 1,500 kilometra katrorë. Pastaj duke marrë parasysh hapësirën minimale të lirë që duhet të lihet rreth çdo automjeti për të siguruar hyrjen dhe manovrimin, kjo zonë bëhet të paktën dyfish.

**Rekomandim nr. 2.1:** Nga ana e Bashkisë Tiranë, të rishikohet sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private prej 25 m<sup>2</sup>, e parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, e cila është e pazbatueshme në praktikë.

#### **Brenda marsit të vitit 2022**

**Gjetje nr. 3:** Në pikën 12 të Nenit 57 të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) **citohet se:** *“ Në njësi strukturore të kategorisë banim, për çdo zhvillim të parashikohet të paktën 1 vend parkimi për çdo njësi banimi..”* Në një qytet si Tirana, ku janë afërsisht 250.000 makina për 852.692 banorë (shifrat për Tiranën referuar vitit 2020), disponohet një total prej 24.000 vende parkimi<sup>59</sup> (duke përfshirë automjetet industriale, autobusët, etj.). Praktikisht për një makinë ka më pak se një vend parkim.

-Përsa i përket parkimit për rezident, nga auditimi rezultojë se, numri i vendeve të parkimit për rezident është më i vogël se numri i rezidentëve të Tiranës (ku përlllogaritjet janë bërë vetëm për një makinë për familje dhe jo më tepër). Sa më sipër nuk mund të plotësohen nevojat për vende parkimi për të gjithë qytetarët e ndaj për këtë arsye nevojitet ndërmarrja e masave për ardhjen në ndihmë të tyre.

**Konkluzion:** Mungesa e vendeve të parkimit të mjaftueshme për automjetet cënon menaxhimin efektiv të parkimeve në qytetet.

**Rekomandimi nr. 3.1:** Tirana Parking në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të analizojë numrin e parkimeve aktuale në qytetin e Tiranës krahasuar me kërkesën për parkim, dhe në vijim të ndërmarrë masa për të siguruar ofertën e nevojshme për vende parkimi në qytet.

---

<sup>59</sup> Referuar të dhënave të vëna në dispozicion grupit të auditimit nga Tirana Parking.

## Brenda marsit të vitit 2022

**Gjetje nr. 4:** Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit u konstatuan të shumta rastet ku edhe ato pak vende që disponohen për rezident, shfrytëzoheshin prej bareve apo bizneseve të ndryshme të zonës.

**Konkluzion:** Monitorimi aktual i vendeve të parkimit për rezidentët nuk ka siguruar shfrytëzimin e këtyre vend parkimeve nga banorët e zonës, duke mos realizuar qëllimin e krijimit të tyre.

**Rekomandimi nr. 4.1:** Policia Bashkiake në Bashkinë Tiranë, të intensifikojë kontrollet në zonat e parkimeve për rezidentet, për të siguruar shmangien e parkimit në këto zona të automjeteve pa pullën e rezidentit të zonës.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**Gjetje nr. 5:** Lidhur me monitorimin e projekteve për parkimet të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë, është operuar në kundërshtim me nenet 8,22 dhe 24 të Ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk është monitoruar zbatimi i tyre dhe nuk janë hartuar dhe miratuar raportet e monitorimit.

**Konkluzion:** Mungesa e monitorimit të projekteve të lidhura me parkimet, të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë Tiranë, nuk ka siguruar identifikimin e problematikave të evidentuara nga grupi i auditimit, si mungesa e strukturave përgjegjëse për secilin aktivitet të parashikuar në strategji (çka ka shkaktuar moszbatimin e një prej 5 projekteve), mungesa e targetave, etj,

**Rekomandim nr. 5.1:** Titullari i Bashkisë Tiranë të ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim monitorimin e Strategjisë së Bashkisë Tiranë dhe veçanërisht projektit të parkimeve, duke hartuar dhe miratuar raportet periodike dhe monitoruar zbatimin e tyre. Në vijim, raportet e monitorimit të publikohen në faqet respektive web.

## Brenda 6-mujorit të parë 2022

**Gjetje nr. 6:** Në pikën d, të Vendimit nr. 48 datë 11.11.2015 përcaktohet se Tirana Parking ka për detyrë funksionale: *“Të konstatojë dhe të vendos gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mos pagesën e tarifës së parkimit”*. Nga ana tjetër, në shkronjën c, të pikës 1, të nenit 12, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr. 9808 datë datë 24.09.2007 *“1. Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: c) Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998” përcaktohet se: policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7..”* Pra, nga sa më sipër rezulton se ka mbivendosje kompetencash mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking sa i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë.

**Konkluzion:** Mbivendosja e kompetencave midis Agjencisë Tirana Parking dhe Policisë Bashkiake për vendosjen e gjobave për shkelje lidhur me parkimet, nuk përcakton në mënyrë të qartë strukturën përgjegjëse, çka mund të shkaktojë edhe mbivendosje të gjobave për të njëjtën shkelje.

**Rekomandim nr. 6.1:** Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Tirana Parking të rishikojnë bazën ligjore për të shmangur mbivendosjen e kompetencave mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking, përse i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë, si dhe të ushtrohet kujdes i veçantë në mënyrë që të mos ketë mbivendosje dhe penalizim më shumë se një herë për të njëjtën shkelje.

**Brenda marsit të vitit 2022**

➤ **Bashkia Korçë**

Sikurse parashikohet edhe në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, përparimi në drejtim të arritjes së objektivave strategjik do të monitorohet. *“Zhvillimi i territorit të Bashkisë Korçë do të kalojë përmes këtyre pesë dimensioneve të mëposhtme të zhvillimit, të cilat në bashkëpunim me drejtimet e zhvillimit do të mundësojnë udhëheqjen dhe monitorimin e përparimit të objektivave strategjike të zhvillimit, programeve dhe projekteve të zhvillimit.”*<sup>60</sup>

Në vijim të sa më sipër, grupi i auditimit nëpërmjet pyetësorit drejtuar subjektit nën auditimit me e-mailin zyrtar të datës 05.05.2021, kërkoi vënien në dispozicion të raporteve të monitorimit të strategjisë për periudhën 2018-2020. Në vijim, Bashkia Korçë i bëri me dije grupit të auditimit që, prej hartimit të dokumentit strategjik, ky i fundit, nuk është monitoruar.

Referuar kontratave të punës nr.766/1 prot., datë 10.09.2019 të lidhura midis Bashkisë Korçë dhe punonjësve të parkimit me pages, sikurse është trajtuar edhe në kapitullin 2 të këtij projekt raporti auditimit, “Subjektet nën auditim”, një ndër detyrat kryesore të punonjësve të parkimit me pagesë është dhënia e biletave të parkimit qytetarëve. Ndërsa, një ndër detyra kryesore të mbikëqyrësit të punonjësve të parkimit me pagesë, është mbikëqyrja e këtyre të fundit mbi kryerjen e detyrave nga ana e tyre. Megjithatë, sistemi aktual i monitorimit të dhënies së biletave punonjësve rezulton se nuk siguron ekonomicitetin dhe eficiencën e procesit në çdo rast. Në 2 nga 2 vizita në terren<sup>61</sup>, të kryera nga grupi i auditimit në zonat e parkimit me pagesë në qytetin e Korçës u konstatuan bileta, orari për të cilat qytetari kishte paguar, kishte mbaruar, dhe me përfundimin e orarit, nuk ishin lëshuar bileta të tjera nga punonjësit e parkimit me pagesë. Më konkretisht, sipas aktkonstatimit të datës 05.03.2021, *“Në zonën e Pazarit të Vjetër u konstatua një biletë, orari për të cilin qytetari kishte paguar, kishte përfunduar, dhe nuk ishin prerë bileta të tjera në vijim të qëndrimit të automjetit në atë post parkimi me pagesë. Më saktësisht, orari kishte përfunduar në orën 10:15, ndërsa grupi i auditimit kreu kontrollin në orën 12:15, pra dy orë pasi orari kishte përfunduar, çka do të thotë që për këtë automjet, duhet të ishin prerë edhe dy bileta të tjera deri në orën 12 e 15.”* “Në zonë e parkimit përballë Agjencisë së Autobusëve, u konstatua një tjetër biletë, orari i qëndrimit për të cilin drejtuesi i automjetit kishte paguar, kishte përfunduar, dhe në vijim nuk ishin prerë bileta të tjera. Më konkretisht, orari i qëndrimit, për të cilin drejtuesi i automjetit kishte paguar, kishte përfunduar në orën 10:10. Ndërsa, grupi i auditimit ishte aty në orën 12:20, pra 2 orë e 10 minuta pasi orari për të cilin qytetari kishte paguar, kishte përfunduar, dhe gjatë kësaj kohe duhet të ishin lëshuar minimalisht edhe dy bileta të tjera parkimi”. *“Gjithashtu, u konstatua edhe një tjetër biletë, orari për të cilin qytetari kishte paguar, kishte përfunduar, dhe nuk ishin prerë bileta të tjera në vijim të qëndrimit të automjetit në atë post parkimi me pagesë. Më saktësisht, orari kishte përfunduar në orën 11:50, ndërsa grupi i auditimit kreu kontrollin në orën 12:25, pra rreth 35 minuta pasi orari kishte përfunduar,*

<sup>60</sup> Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, 2017, fq. 212.

<sup>61</sup> Akt konstatimi 1 dhe Akt konstatimi 2, të mbajtur midis grupit të auditimit dhe përfaqësuesve të Bashkisë Korçë, pas vizitave në terren të kryera në datat 05.03.2021 dhe 06.05.2021.

çka do të thotë që për këtë automjet, duhet të ishte prerë edhe një biletë tjetër deri në kohën e kontrollit nga grupi i auditimit.”

Figure 6: Bileta parkimi orari për të cilin ishin lëshuar kishte kaluar dhe nuk ishin lëshuar bileta të tjera në vijim.



Burimi: Vizita në terren 05.03.2021, grupi i auditimit

Sipas akt konstatimit nr. 2, të datës 06.05.2021 “U konstatuan bileta të cilave u kishte kaluar koha për të cilat qytetari kishte paguar dhe nuk ishin prerë bileta të tjera për kohën e pa mbuluar nga biletat e prera fillimisht. Më saktësisht:

- Bileta nr. 297891, ishte paguar për orarin 10:00-11:00, ndërsa grupi i auditimit ishte aty në orën 12:50. Pra, gjatë kësaj kohe duhet të ishin prerë edhe dy bileta të tjera, për këtë automjet, të cilat nuk ishin prerë.
- Bileta nr. 298275, ishte paguar për orarin e qëndrimit 11:00-12:00, ndërsa grupi i auditimit ishte aty në orën 12:50. Pra, gjatë kësaj kohe duhet të ishin prerë edhe një biletë tjetër për këtë automjet, e cila nuk ishin prerë.”

Figure 7: Bileta parkimi orari për të cilin ishin lëshuar kishte kaluar dhe nuk ishin lëshuar bileta të tjera në vijim.



Burimi: Vizita në terren 06.05.2021, grupi i auditimit

Referuar nenit 12 të Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, “Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: policisë së Bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të Bashkisë, të parashikuara në nenin 7”.

Referuar vendimit nr. 160, datë 25.11.2019 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë, pika 2, “Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisjen me kartë rezidenti dhe mos respektim të kushteve dhe sinjalistikës së vendosur në këto zona është Policia Bashkiake”.

Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit, u konstatua një rast, ku në prezencën e grupit të auditimit, me largimin e një automjeti nga një vendparkimi me pagesë, një subjekt privat vendosi tabelën e biznesit të tij në postin e parkimit me pagesë, duke e bllokuar këtë të fundit për llogari të tij.

Figure 8: Tabelë e biznesit privat, në një post parkimi me pagesë



Burimi: Vizita në terren, grupi i auditimi

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e sinjalistikës dhe rregullave në zonat e rezidentëve në qytetin e Korçës, u konstatuan automjete jo të pajisura me kartën e rezidentit.

Figure 9: Automjete të parkuara në zonat e parkimit për rezidentët, të pa pajisur me kartën e rezidentit.



Burimi: Vizita në terren, grupi i auditimi

**Gjetje nr. 7:** Dokumenti më i lartë strategjik i Bashkisë Korçë nuk është monitoruar nga ana Bashkisë Korçë, që prej miratimit të tij në janar të vitit 2017. Pra, për periudhën objekt auditimi 2018-2020, zbatimi i projekteve test të parashikuara në Strategjinë për Zhvillimin e të Territorit të Bashkisë Korçë lidhur me përmirësimin e situatës së parkimeve në këtë bashki, nuk është monitoruar.

**Konkluzion:** Si rezultat që, prej më shumë se 4 vitesh që është në funksion Strategjia për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë zbatimi i saj nuk është monitoruar asnjëherë, nuk është bërë identifikimi i mangësive ose hapësirave për përmirësim në politikat e Bashkisë Korçë për zhvillimin e qytetit dhe veçanërisht atyre për zhvillimin e parkimeve, duke cënuar efektivitetin e kësaj strategjie dhe arritjen e objektivave.

**Rekomandim nr. 7.1:** Titullari i Bashkisë Korçë, të marrë masat për të monitoruar në mënyrë periodike zbatimin e strategjinë 15 vjeçare për zhvillimin e territorit të Bashkisë Korçë. Monitorimi të kryhet nëpërmjet indikatorëve të performancës të parashikuar në strategji. Periodiciteti i monitorimit të deklarohet në Strategjisë për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë (me përditësimin e saj), por jo më pak se një herë në vit. Në përfundim të monitorimeve, të hartohen raportet e monitorimit, të cilat duhet të miratohen dhe publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Gjetje nr. 8:** Në të dy vizitat e kryera nga grupi i auditimit në zonat e parkimit me pagesë në qytetin e Korçës u konstatuan bileta, orari për të cilat drejtuesit e automjeteve kishin paguar, kishte mbaruar, dhe me përfundimin e orarit, nuk ishin lëshuar bileta të tjera nga punonjësit e parkimit me pagesë.

Nga vizitat në terren u konstatua një rast në të cilin, një subjekt privat kishte bllokuar një post parkimi me pagesë, duke vendosur tabelën e biznesit të tij në këtë vend parkim dhe rrjedhimisht duke mos lejuar përdorimin e tij nga qytetarët të cilët nuk do të frekuentonin këtë biznes.

-Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e sinjalistikës dhe rregullave në zonat e parkimit për rezidentët, u konstatuan automjete të parkuara, të pa pajisur me kartën e rezidentit.

**Konkluzion:** Sistemi aktual i monitorimit dhe kontrollit në Bashkinë Korçë është i dobët dhe nuk ka siguruar identifikimin e problematikave kryesore dhe ndërmarrjen në kohë të masave për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor dhe rregullator për parkimet, duke cënuar kështu efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e menaxhimit të parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 8.1:** Titullari i Bashkisë Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe analizuar mangësitë në sistemin aktual të monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë në qytetin e Korçës, dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar efektivitetin e tij.

**Dhjetor 2021**

**Rekomandim nr. 8.2:** Policia Bashkiake në Bashkinë Korçë, të intensifikojë kontrollet në zonat e parkimeve me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët, me qëllim shmangien e shfrytëzimit

të posteve të parkimit me pagesë nga subjektet private dhe shmangien e parkimit në zonat e rezidentëve, të automjeteve pa pullën e rezidentit të zonës.

## Brenda dhjetorit 2021 dhe në vijimësi

### 5. PËRMBLEDHJE

Lidhur me pyetjen kryesore u arrit në këtë mesazh auditimi:

Ky auditim ka si objektiv vlerësimin e performancës së menaxhimit të parkimeve publike me pagesë në qytetin e Tiranës dhe Korçës. Duke qenë se, ky auditim do të përqendrohet kryesisht tek rezultatet e arritura në raport me objektivat e synuara, si dhe tek aktivitetet e ndërmarrja për zbatimin dhe monitorimin e politikave të parkimeve publike, *fokusi i tij do të jetë tek vlerësimi i efektivitetit dhe eficiencës së menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës dhe Korçës.*

Menaxhimi i parkimeve në Bashkinë Tiranë në nivel strategjik vuan nga një planifikim i dobët, i cili nuk është mbështetur në analiza të detajuara, duke mos siguruar kështu ndarjen e strukturave përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve specifike, kostim të aktiviteteve, apo rezultate të pritura vit pas viti në të cilin shtrihet strategjia. Kjo situatë ka shkaktuar që 20% e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik “*Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022*”, të mos jenë zbatuar. Problematika të shumta u konstatuan në bllokimin e posteve të parkimit me pagesë nga ndërtimet që po zhvillohen në qytet, apo uzurpimet arbitrare duke cenuar performancën e procesit. Mungesa e raporteve të monitorimit nuk siguron rezultate solide në drejtim të arritjes së vizionit të Bashkisë për administrimin e parkimeve ç’ka përmban riskun e mungesës së efektivitetit dhe eficiencës së këtij funksioni.

Menaxhimi i parkimeve në qytetin e Korçës nuk ka pasur vëmendjen e duhur nga strukturat drejtuese të Bashkisë, të cilat në mungesë të një vizioni për parkimet që shkon në linjë me vizion holistik për zhvillimin e qytetit, e kanë mbështetur këtë funksione në projekte test. Planifikimi i dobët i projekteve test për parkimet në këtë qytet, ka shkaktuar në 67% e tyre të mos zbatohen, duke mos siguruar përfitimet që rrjedhin nga menaxhimi i duhur i parkimeve si p.sh. përmirësimi i lëvizshmërisë urbane, mbështetje më e madhe për ekonominë lokale, siguri e rritur rrugore, cilësi më e mirë e ajrit, etj. Problematika të shumta u konstatuan me plotësinë, qartësinë dhe saktësinë e sinjalistikës horizontale dhe vertikale të parkimeve në qytetin e Korçës. Nga ana tjetër, sistemi i dobët i monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për parkimet në qytet, nuk ka mundur identifikimin dhe marrjen e masave për përmirësim. Sa më sipër, menaxhimi i parkimeve publike në qytetin e Korçës vuan nga mungesa e efektiviteti dhe eficiencës.

Lidhur me planifikimin e objektivave dhe aktiviteteve SMART për menaxhimin e parkimeve në qytetin e Tiranës, për shkak se në Strategjinë për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranës strukturat përgjegjëse nuk janë përcaktuar rezulton se, të paktën njëri prej projekteve strategjike nuk është reflektuar në planet vjetore të TP për periudhën 2018-2020 dhe rrjedhimisht nuk ka gjetur zbatim. Mosparashikimi i burimit të financimit, dhe mungesa e kostimit të aktiviteteve vit pas viti në të cilin shtrihet strategjia, ndikon negativisht në arritjen e objektivit strategjik. Mungesa e rezultateve të pritshme të matshme (targetave), pas implementimit të 5 projekteve të parashikuara për rritjen e kapacitetit të parkimit në qytetin e Tiranës, nuk siguron rezultate solide mbi të cilat mund të mbështetet monitorimi i vazhdueshëm dhe ndërmarrja në kohë e masave korrigjuese nga strukturat drejtuese. Targetat operacional të vendosur për vitet 2018-2022 nga TP, janë të hartuar pa patur një analizë institucionale paraprake duke mos siguruar kështu

relevancën e tyre për të matur arritjen e objektivave operacionale. Në mungesë të analizave argumentuese, tarifa e vendosur përban riskun që nuk pasqyron vlerën reale për shërbimin e marrë nga qytetarët. Në vijim të konstatimeve, grupi i auditimit dha rekomandime për përmirësim si: të përcaktohen në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse dhe detyrat specifike të secilës prej tyre, për çdo aktivitet të parashikuar në strategji, të kryhet kostimi i aktiviteteve të parashikuara në strategji për çdo vit që shtrihet strategjia, të publikohet burimi i financimit të tyre, të përcaktohen indikatorët e performancës dhe targetat e synuara për çdo vit, si dhe të gjitha të mbështeten në analiza.

Lidhur me zbatimin e aktiviteteve për menaxhimin e parkimeve në qytetin e Tiranës, moszbatimi i të paktën 1 prej 5 projekte të parashikuara në strategji ka cenuar efektivitetin dhe eficiencën e arritjes së objektivave strategjik "Rritja e kapaciteteve të parkimit në qytetin e Tiranës". Bllokimet e vendeve të parkimit për arsye të aktiviteteve sportive, për vitet 2019-2020, duke sjell mos arkëtim të mjeteve monetare, i ka kushtuar buxhetit të Bashkisë Tiranë të ardhura të munguara në vlerën 217.340 lekë të cilës duhet ti zbritet vlera e komisionit për operatorët telefonikë (32.601 lekë). (159.140 lekë për vitin 2019 dhe 58.200 lekë për vitin 2020). Mundësitë jo të barabarta për të gjithë qytetarët apo vizitorët e Tiranës, duke penalizuar për kryerjen e pagesës në mungesë të kreditit të mjaftueshëm në telefon apo mos pranisë së një numri nga operatorët shqiptar janë bërë burim i marrjes së penaliteteve financiare (gjoba).

Nga ana e BT dhe Operatorëve telefonik si palë përbërëse e kësaj marrëveshje, nuk është parashikuar asnjë klauzolë mbi menaxhimin e situatës në rast të ndërprerjes së sinjalit telefonik, sikundër nuk specifikohet asgjë se kush do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara në buxhetin e BT, ç'ka ka shkaktuar që peshën e të ardhurave të munguara ta mbajë buxheti i Bashkisë. Mungesa e sinjalistikës përmban riskun e moszbatimit të rregullave të përcaktuara për parkimet. Në vijim të konstatimeve, grupi i auditimit dha rekomandime për përmirësim si: të kryhen analizat e nevojshme për të identifikuar arsyet e moszbatimit të projekteve strategjike dhe të ndërmerren masat për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, të kryhen studimet dhe analizat e nevojshme për gjetjen e alternativave më lehtësuese për të kryer pagesat e parkimi me pagesë nga ana e drejtuesve të automjeteve, si dhe të merren masa për të kryer riparim të sinjalistikës dhe vijëzimit në zonat e dëmtuara.

Lidhur me monitorimin e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës, u konstatua se mungesa e monitorimit të projekteve të lidhura me parkimet, të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë, ka ulur eficiencën e tyre. Gjithashtu u konstatua se, mbivendosja e kompetencave mes ATP dhe Policisë Bashkiake ka sjellë uljen e transparencës dhe përgjegjshmërisë. Problematika u konstatuan në lidhje më procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të parkimit në vitin 2016, dhe pazbatueshmëri e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë lidhur me sipërfaqen e nevojshme të parkimeve private, etj. Grupi i auditimit rekomandoi: përmirësimin e bazës ligjore, e ku konkretisht Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr.686 datë 22.11.2017 të përditësohet duke mbajtur në konsideratë normat e projektimit mbi ndërtime të reja. Të rishikohet nga PPV sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private prej 25 m<sup>2</sup> e cila është e pazbatueshme në praktikë, hartimin, monitorimin dhe publikimin e raporteve të monitorimit të Strategjisë së Bashkisë Tiranë, rishikimin e bazës ligjore për të shmangur mbivendosjen e kompetencave, mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking, për sa i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë.

Lidhur me objektivat dhe aktivitetet e parkimeve parashikuar në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, ndryshe nga sa praktikatat e mira sugjerojnë, nuk është mirëpërcaktuar vizioni i Bashkisë lidhur me perspektivën e parkimeve në këtë qytet, si dhe nuk janë planifikuar aktivitete të

mirëfillta për menaxhimin e parkimeve, Projektet test, të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, prej zbatimit të të cilëve pritej të përmirësoj situatë e parkimeve në këtë qytet, vuajnë nga një planifikim i dobët, pasi nuk është parashikuar periudha kohe në të cilën secili prej tyre do të shtrihej, nuk është bërë kostimi total dhe rrjedhimisht as ai i përvitshëm, nuk janë përcaktuar qartë detyrat e secilit aktorë të përfshirë në proces, nuk është parashikuar burimi i financimit, indikatorët e performancës dhe targetat e pritshëm. Kjo situatë nuk siguron zbatimin efektiv, eficient dhe ekonomik të këtyre projekteve, duke rrisur arritjen e rezultateve të pritshëm në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Korçës, nga implementimi i tyre. Për shkak se studimet dhe analizat e fundit të kryera, mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës, janë të rreth 8 viteve më parë, nuk ofrohet siguri nëse vendimet e marra vitet e fundit janë efektive, eficiente dhe ekonomike në drejtim të përmirësimit të situatës së parkimeve në qytet. Mungesa e studimeve të përditësuara, si dhe mungesa e një sistemi të dhënash mbi parkimet në qytet, përmban riskun e mos identifikimit të hendeqeve në në politikat aktuale të menaxhimit të parkimeve në këtë bashki. Mos konsultimi i vazhduar i opinionit publik lidhur me çështjet e parkimeve në qytetin e Korçës ka shkaktuar që mos të identifikohet dhe mos të ndërmerren masat e nevojshme për adresimin e problematikave më të cilët qytetarët hasen në përditshmërinë e tyre lidhur me parkimet, si dhe përmban riskun e rezistencës nga ana e qytetarëve për të zbatuar vendimet e marra, pa u konsultuar fillimisht edhe mendimi i tyre. Funksionimi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkisë Korçë, me 33% më pak staf se ai i nevojshëm, për të gjithë periudhën nën auditim, ka cenuar cilësinë e planifikimit strategjik të aktiviteteve në fushën e parkimeve. Në vijim të konstatimeve, grupi i auditimit ka dhënë rekomandimet për përmirësim si, aplikuar një qasje strategjike në menaxhimin e parkimeve, planifikimin e objektivave dhe aktiviteteve SMART, ngritjen dhe përditësimin e një sistemi të dhënash, konsultimin e opinionit të publikut, etj.

Lidhur me zbatimin e aktiviteteve të parkimit në bashkinë Korçë, grupi i auditimit ka konstatuar se mangësitë e konstatuara në planifikimin e projekteve test për parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, kanë shkaktuar që 67% e tyre të mos realizohen, si rezultat i mungesës së fondeve, duke cenuar efektivitetin e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës. Gjatë muajve korrik-gusht 2019 (muaj këto me një fluks mjaft të lartë turistësh) nuk është menaxhuar, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, si dhe mungesë në eficiencën e procesit. Mungesa e metodave alternative të pagesës së parkimit në qytetin e Korçës, përmban riskun e cenimit të ekonomicitet dhe eficiencës të procesit. Pasi si rezultat se, punonjësit e parkimit kanë një numër të konsiderueshëm postesh parkimi në administrim, krijohen vonesa në procesin e dhënies së biletës dhe marrjes së pagesë, (veçanërisht në periudhat e fluksit të turistëve), të cilat cenojnë eficiencën e kohës së qytetarëve, duke shkaktuar largimin e tyre drejt parkimeve private ose penalizimin e tyre me anë të gjobave. Problematikat e shumta në sinjalistikën e parkimeve në qytetin e Korçës, si mungesa e plotë e saj, sinjalistikë jo e saktë, jo e qartë, ose jo e plotë bëhen burim i moszbatimit të rregullave të parkimit nga qytetarët duke shkaktuar penalizimin e këtyre të fundit me gjoba, si dhe cenojnë e mbarëvajtjes së administrimit të parkimeve në tërësi. Zvogëlimi i vend parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, në mungesë të një vizioni të qartë të Bashkisë për të ardhmen e menaxhimit të parkimeve në qytet, dhe mos mbështetja e kësaj vendimmarrje me analiza të detajuara për secilin segment të hequr nga parkimi me pagesë, bëhet burim i vendimmarrjeve arbitrare dhe përmban riskun e mungesës së efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet në administrimin e parkimeve në këtë qytet. Në vijim të konstatimeve, grupi i auditimit ka dhënë rekomandimet për përmirësim si, analizimi i faktorët të cilët kanë shkaktuar moszbatimin e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik të

Bashkisë, kryerjen e studimeve dhe analizave të nevojshme për të identifikuar metodat më të mira të pagesës së parkimit në këtë qytet dhe aplikimin e tyre, ndërmarrjen e masave të nevojshme për të siguruar sinjalistikë të plotë, të qartë dhe të saktë horizontale dhe vertikale të parkimeve, analizimin në mënyrë të detajuar të gjitha vend parkimet e përjashtuara nga pagesa, me Vendimin nr. 111, datë 03.08.2019 të Këshillit Bashkiak, si dhe mbështetjen në analiza dhe studime të detajuara të vendimmarrjeve të Këshillit Bashkiak për shtimin apo pakësimin e vend parkimeve me pagesë në qytet.

Lidhur me monitorimi e performancës së menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës, grupi i auditimit ka konstatuar se, sistemi aktual i monitorimit dhe kontrollit në Bashkinë Korçë është i dobët dhe nuk ka siguruar identifikimin e problematikave kryesore dhe ndërmarrjen në kohë të masave për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor dhe rregullator për parkimet, duke cënuar kështu efektivitetin, eficiencën dhe economicitetin e menaxhimit të parkimeve në këtë qytet. Në vijim të konstatimeve, grupi i auditimit ka dhënë rekomandimet për përmirësim si monitorimi në mënyrë periodike i zbatimit të strategjisë 15 vjeçare për zhvillimin e territorit të Bashkisë Korçë, ndërmarrjen e masave të nevojshme për të identifikuar dhe analizuar mangësitë në sistemin aktual të monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë, intensifikimin e kontrolleve në zonat e parkimeve me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët nga .

## **6.GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIRARKIKE**

Anesti Gjika (P.Grupi)

Megi Kurushi (Anëtare)

Almida Kafija (Anëtare)

